

**HARUN JAHJA**  
(ADNAN OKTAR)

# ARROGANCA E SHEJTANIT

Ata i ka nënshtuar djalli dhe ua  
ka qitur në harresë porositë e  
Allahut. Ata janë shoqëri e  
djallit, e dinë se  
ithtarët e djallit janë më  
të dëshpëruarit.  
(Muxhadele, 58: 19)

الله  
رسول  
محمد

**N**jeriu kryelartë, dmth. ai i cili i jep vetes autoritet të pavarur, dhe në këtë mënyrë shfaq padrejtë arrogancë ndaj Allahut, si dhe ia kthen shpinën fjalëve të Tij, vazhdimisht mbetet i rrezikuar nga dinakëritë e shejtanit. Qëllimi i këtij libri është të paraqes të gjitha aspektet e arrogancës dhe të metat në karakterin e atij që është i kapluar nga kjo sëmundje, dhe të apelojë tek të gjithë ata, tek të cilët shejtani tenton të ndikojë, që të largohen nga ai dhe të pastrojnë veten nga kjo e keqe.

Duke pasur këto synime si qëllim, përgjatë librit, do të flasim për gjendjen shpirtërore njerëzve të shkujesur, sa i përket “arrogancës” si defekt, që është e metë qenësore e tyre.

Shpresojmë se ky libër do të shërbejë si paralajmërim i fuqishëm për gjithë lexuesit tanë, ashtu që t’i shmangen këtij vesi të lig të Iblisit.



## DY FJALË RRETH AUTORIT

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë

shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si genia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ  
رَسُولُ  
مُحَمَّدٍ



# ARROGANCA E SHEJTANIT

Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka qitur në  
harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri  
e djallit, e dinë se ithtarët e djallit janë  
më të dëshpëruarit.

(Muxhadele, 58: 19)

**HARUN JAHJA (ADNAN OKTAR)**



## PËR AUTORIN

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55.000 faqesh me 40.000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizojnë librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preçiz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesit dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

## PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 150 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësinë e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.



The book cover features a background of pink tulips. A decorative gold border with intricate floral patterns is visible on the top, right, and bottom edges. The title is written in large, bold, gold-outlined letters.

# ARROGANCA E SHEJTANIT

**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**

## **GLOBAL PUBLISHING**

Kayisdagi Mah. Degirmen Sok. No: 3  
Ataşehir-Istanbul / TURKEY Phone: (+90 216)  
660 00 59

Printed by: Secil Ofset  
100. Yil Mahallesi MAS-SIT Matbaacilar Sitesi  
4. Cadde No: 77 Bagcilar -Istanbul / Turkey  
Phone: (+90 212) 629 06 15

E-Mail: [info@globalkitap.com](mailto:info@globalkitap.com)  
**<http://globalkitap.com>**

**[www.harunyahya.com/albanian](http://www.harunyahya.com/albanian)**

**[www.harunyahya.com](http://www.harunyahya.com)**

**[www.en.harunyahya.TV](http://www.en.harunyahya.TV)**

# PËRMBAJTJA

HYRJE .....	10
SHKAQET E ARROGANCËS .....	13
PASOJAT E ARROGANCËS NË SHPIRT .....	30
PASOJAT NEGATIVE TË ARROGANCËS NË TRUPIN E NJERIUT .....	37
ARROGANCA E FSHEHUR .....	40
SHEMBUJT E ARROGANCËS NË KURAN .....	45
FARAONI .....	53
KARUNI .....	64
HAMANI.....	66
BABAI I PROFETIT IBRAHIM .....	68
EBU LEHEBI.....	70
PRONARI I VRESHTËS .....	71
KRERËT E POPUJVE.....	73
POPUJT JOBESIMTARË .....	84
MODESTIA E BESIMTARËVE .....	96
A MUNDËT NJË ARROGANT TË JETOJË ENDE SIPAS PARIMEVE FETARE? .....	111
VENDI I ARROGANTËVE NË BOTËN E PËRTEJME .....	122
FATI I TË DEVIJUARVE TË UDHËHEQUR NGA ARROGANTËT .....	130
PËRFUNDIM .....	133
MASHTRIMI EVOLUCIONIT .....	136

# HYRJE



**P**ara se të krijojë profetin Adem a.s., Allahu krijoi engjëjt (melekët) dhe xhinët. Ata lartësonin dhe adhuronin Allahun. Pastaj, Allahu krijoi Ademin a.s, njeriun e parë, dhe urdhëroi engjëjt (melekët) që atij të i përkulen (bëjnë sexhde).

Me nënshtrim të plotë, engjëjt (melekët) iu bindën urdhrit të Allahut dhe u përkulën para Ademit a.s. Megjithatë, njëri prej xhinëve, Iblisi (shejtani) nuk iu bind këtij urdhri. Nuk iu bind, sepse besonte se është më superior se Ademi a.s. Nga kjo arrogancë, pyetjes së Allahut: **“...O Iblis, çka të pengoi ty t’i përlësh atij që Unë vetë e krijova? A bëre kryeneçësi, apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?”** (Sad, 38:75), ai iu përgjigj:

**Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i miri prej tij, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijove nga balta!”** (Sad, 38: 76)

*Iblisi*, i cili mori aq mori guxim sa të mos t’i bindet urdhrit të Allahut, u dënua nga Allahu të jetë në xhehenem përjetë.

Arsyeja pse *Iblisi* kundërshtoi Allahun, ishte për shkak të “arrogancës” së tij, ose me fjalë të tjera, “kryelartësisë” së tij.

Ajo që shkaktoi ndjenjat e kryelartësisë tek *Iblisi* ishte vesi që e kishte lejuar të kultivohet në të: “uni (egoja)”...

Termi i përshtatshëm për fjalën “uni” në gjuhën arabe është (*enanijet*) që rrjedh nga fjala (*ene*). Kjo do të thotë atribuomi i një qenie të ndarë të njeriut brenda tij e cila e ndjen veten të ndarë dhe pavarur nga Allahu, prej së cilës rrjedhin veprat, qëndrimet dhe botëkuptimet.

Nga ana tjetër, arroganca është kryesisht njëra ndër manifestimet e “egos”. Posa dikush në vete krijon një “qëndrim egocentrik”, menjëherë fillon të mburret me cilësitë dhe vlerat që Allahu ia ka dhënë si begati dhe si të tilla, këto vlera bëhen arsye e mendjemadhësisë në pikëpamjet e tij që kanë të meta. Madje edhe i dërguari Muhammedi s.a.a.s ka thënë në hadithin e tij të njohur, “Arroganca do të thotë përqeshja dhe të refuzuarit e së Vërtetës si dhe të nënçmuarit e njerëzve.” (Muslim).

Pa marrë parasysh rrethanat, njeriu i tillë e konsideron veten më superior dhe më me vlerë. Në Kuran thuhet se njeriu i tillë adhuron veten.

Si pasojë, arroganca dhe, e lidhur me të, edhe kryelartësia barazohen me të përshkruarit ortak Allahut si dhe me mosbesimin. Në fakt, ky ves i Iblisit shpjegohet në këtë mënyrë:

**“... Iblisi që ishte kryelartë dhe që u bë prej jobesimtarëve.” (Sad, 38: 74)**

Arroganca e *Iblisit*, e cila u bë e qartë atëherë kur iu urdhërua që të i përkulet Ademit a.s, rezultoi për të, me dënim të përhershëm. Kjo tregon se sa i madh është rreziku nga kjo e keqe nëse mbjellët në zemrën e tyre.

Arroganca është e meta kryesore në karakterin e shejtanit. Prandaj, “arroganca” dhe “kryelartësia”, që vijnë nga shejtani, janë burimi të gjitha të ligave dhe prapështive. Njëjtë sikur miliona njerëz të cilët kanë jetuar në të kaluarën, këto të meta për të cilat shejtani është fajtor, kanë kapluar gjithashtu edhe natyrën qenësore të shumë njerëzve që jetojnë sot, duke i bërë që të kenë sjellje të njëjta të këqija si *Iblisi*.

Njeriu kryelartë, dmth. ai i cili i jep vetes autoritet të pavarur, dhe në këtë mënyrë shfaq padrejtë arrogancë ndaj Allahut, si dhe ia kthen shpinën fjalëve të Tij, vazhdimisht mbetet i rrezikuar nga dinakëritë e shejtanit. Qëllimi i këtij libri është të paraqes të gjitha aspektet e arrogancës dhe të metat në karakterin e atij që është i kapluar nga kjo sëmundje, dhe të apelojë tek të gjithë ata, tek të cilët shejtani tenton të ndikojë, që të largohen nga ai dhe të pastrojnë veten nga kjo e keqe.

Duke pasur këto synime si qëllim, përgjatë librit, do të flasim për gjendjen shpirtërore njerëzve të shkujdesur, sa i përket “arrogancës” si defekt, që është e metë qenësore e tyre.

Shpresojmë se ky libër do të shërbejë si paralajmërim i fuqishëm për gjithë lexuesit tanë, ashtu që t’i shmangen këtij vesi të lig të *Iblisit*.

# SHKAQET E ARROGANCËS



**S**iç thamë edhe më herët, shkakut që dikush i nënshtrohet arrogancës është pikëpamja e tij e gabuar se ai ekziston dhe ndihet i pavarur nga Allahu, dhe se cilësitë e veta i ka fituar me punën e vet. Sidoqoftë, për ta njohur këtë karakter të mjegulluar të kësaj mënyre të menduarit, nuk është e domosdoshme të jetë pjesëtar i ndonjë feje.

Thjeshtë, vetëm duke menduar pak për këtë çështje, do të i bëhet e kuptueshme se nuk ka ardhur në këtë botë me dëshirën e tij, dhe se nuk ka haber se kur do të vdes dhe se vetitë e tij fizike nuk i ka fituar nga puna e vet. Të gjithë këta faktorë duhet ta bëjnë njeriun që të kuptojë se çdo gjë që ka, madje edhe trupin e tij, e ka përkohësisht dhe se në fund edhe trupi do t'i kalbet. Të gjithë këto janë tregues të qartë se njeriu është krijesë e dobët dhe se asgjë nuk posedon, përfshirë këtu edhe gjërat të cilat mendon se i takojnë apo i ka nën kontroll. Mund të përmenden këtu edhe shumë shembuj të ngjashëm, nëse thellohemi pak. Nga kjo pikëpamje, bëhet shumë e qartë se sa e paarsyeshme është arroganca. Megjithatë, shumica e njerëzve nuk ia vënë veshin

aq edhe rolit të tyre në jetë, saqë nuk mund t'i kuptojnë apo janë të prirur t'i harrojnë edhe këto fakte shumë të thjeshta. Për këtë shkak, shumë vështirë është të gjendet sot ndonjë person që nuk është bile sadopak i zhytur në arrogancë.

Sido që të jetë, është krejtësisht e paimagjinueshme për dikë që të bëhet kryelartë nëse është i vetëdijshëm se Allahu është i Plotfuqishëm dhe se Ai krijoi çdo gjë prej asgjëje, që Allahu është Ai i Cili i pajisi njerëzit me cilësitë e tyre dhe iu dha begati, dhe se Allahu është Ai i Cili mund t'i merr të gjitha prapë kur Ai dëshiron, se të gjithë krijesat janë të vdekshme, dhe se i Vetmi është Allahu i Cili do të ekzistojë përgjithmonë. Vetëm ata të cilët nuk i kuptojnë këto fakte dhe harrojnë mangësitë, dobësitë dhe vdekjen e tyre mund të veprojnë asisoj.

Arsyet kryesore që shkaktojnë arrogancë janë të ndryshme; diçka që për dikë duket e parëndësishme, mund të bëhet shkak për arrogancë tek dikush tjetër. Por në përgjithësi, shkaqet që shpienë drejt arrogancës ndaj njerëzve janë kryesisht të njëjta. Këto shkaqe përgjithësisht janë të lidhura me vetitë fizike dhe intelektuale të njerëzve. Shkaqet më të shpeshta janë:

- pushteti dhe pasuria
- bukuria dhe rinia
- pozita, autoriteti dhe respekti
- inteligjenca, mençuria dhe arsimimi

Natyrisht, këtyre shkaqeve mund t'i shtojmë edhe të tjera. Shkaqet tjera që mund të shpien në arrogancë varen nga ambienti në të cilin dikush jeton. Ndonjëherë, personi i cili kërkon shkaqet se pse disa njerëz bëhen kryelartë, lehtë përgjigjen mund ta gjejnë tek vetitë e përmendura më lart.



Shqyrtimi i mëtutjeshëm i vetive të lartpërmendura do të shpijnë në përfundim se të gjitha këto janë veti të përkohshme mbi të cilat njeriu nuk ka kontroll. Të gjitha këto janë vlera të përkohshme, pavarësisht se sa njeriu mund të jetë i bukur, i pasur apo i mençur. Njeriu mund të jetoj mesatarisht 50-80 vjet, ose më së shumti 100 vjet... As njeriu më i pasur, e as gruaja më e bukur nuk kanë privilegjin të gëzojnë jetë më të gjatë në këtë botë. Ai apo ajo më në fund do të përballen me vdekjen, edhe pse është përpjekur që të ikë nga ajo dhe humb të tërën me të cilën ishte mburrur.

Prandaj, duhet mbajtur mend se të gjitha gjërat si pasuria, bukuria dhe shëndeti nuk janë të garantuara në këtë jetë. Është vetëm çështje kohe kur njeriu mund të humb gjithë ato cilësi materiale apo shpirtërore me të cilat aq shumë mburret. Nuk janë të rralla shembujt e njerëzve që përjetojnë humbje të tilla. Kurani zbulon natyrën e vërtetë të jetës në këtë botë, ashtu që ta kemi parasysh:

**Ju njerëz dinie se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues. (Hadid, 57: 20)**

Thamë se këto cilësi të cilat kontribuojnë në krijimin e arrogancës tek njerëzit nuk janë tipare të cilat e bëjnë njeriun më superior. Të gjitha këto janë begati për të cilat njeriu

duhet të jetë mirënjohës ndaj Allahut. Sido që të jetë, në rast se njeriu nuk e vret mendjen se Allahu është Ai i Cili i jep këto begati dhe arsyet pse Ai i jep, ai gjithnjë e më shumë bëhet arrogant dhe fillon të besojë se ai këto veçori i ka, sepse i meriton ato.

Derisa këshillonte besimtarët i dërguari Muhammedi saas, ua tërhoqi vëmendjen për këtë, duke i përkujtuar ata se e gjithë pasuria që njeriu mendon se e ka, mund të zhduket një ditë dhe duhet ta përdorë atë në mënyrë për ta kënaqur Allahun:

*Përfitoni nga pesë gjëra para se të vijnë pesë të tjera; rinisë para pleqërisë, shëndetit para sëmundjes, pasurisë para varfërisë, kohës së lirë para preokupimit dhe jetës para se të vijë vdekja (Hakimi, Bejhekiu, Hadith Sahih)*

Në vijim do të shpalosim natyrën e këtyre cilësive që shkaktojnë arrogancë, dhe të vërtetën lidhur me jetën e kësaj bote, për së cilën njeriu është aq shumë i lidhur.

## **Pushteti dhe pasuria**

Hulumtimet përgjatë historisë tregojnë se pasja e pushtetit dhe pasurisë është karakteristikë e zakonshme e njerëzve kryelartë dhe mendjemëdhenj. Në saje të pushtetit që mbajnë, këta njerëz kanë refuzuar besimin dhe kanë vënë nën thundër njerëzit përreth tyre.

Megjithatë, të gjithë këta njerëz të cilët kanë kultivuar arrogancë për shkak të pasurisë dhe pushtetit të tyre, nuk e kanë mundur të kuptojnë një të vërtetë shumë të rëndësishme: që secili, i pasur apo i varfër do të vdes një ditë dhe do të varroset. Pas vdekjes, paratë dhe pasuria nuk janë më të rëndësishme. Vetëm jeta e amshueshme pas vdekjes

është e vetmja e vërtetë që e pret. Paratë dhe pasurinë e grumbulluara gjatë jetës në këtë botë nuk do t'i sjellin dobi, përveç nëse i ka shpenzuar për çështjen e Allahut. Dikush që mburret me pasurinë e tij dhe mban për vete mendim të lartë, në të vërtetë, harron faktin se është i dobët edhe para një virusi shumë të vogël sa që as nuk mund të shihet me sy të lirë. Edhe dikush i pasur nuk është i sigurt nga një mikrob aq i vogël. Bile, edhe po të kishte gjithë pasurinë e kësaj bote, bile edhe një herë aq, nuk do ta bënte imun ndaj vdekjes.

Edhe pse dikujt mund t'ia merr mendja se ai mund të vazhdojë të mbetet shumë i respektuar me mallrat dhe paratë që i lë prapa në këtë botë, ai do të zhgënjehet në Ditën e Gjykimit. Pasi që, sado që njeriu të jetë i pasur, vetëm pak njerëz do ta mbajnë në mend vetëm 3 deri në 5 vjet pas vdekjes së tij. Edhe pse, në raste të rralla, në mënyrë të veçantë, mund të mbetet në kujtesën e një numri të madh njerëzish, edhe kjo në fund nuk do t'i ndihmonte gjë. Në të vërtetë, derisa ai vuan dënimin për arrogancën e shprehur ndaj Allahut, sa do ta kujtojnë njerëzit, më nuk do të jetë edhe aq e rëndësishme.

Njerëzit e tillë karakterin e tyre e ndërtojnë mbi arrogancë. Mirëpo, karakteri që buron nga fuqia e pasurisë nuk është "karakter" në kuptimin e plotë të fjalës; dhe me humbjen e pasurisë së tij apo takimi i tij me dikë më të pasur sesa vet, do të shkaktojë humbje të vetëbesimit dhe të të ashtuquajturit "karakter". Domethënë, nëse vetëbesimi dhe karakteri i njeriut varet nga faktorë të tillë, atëherë fati i tij do të jetë mungesa e vetëbesimit dhe frustrimit kur ai i humb ato.

Mirëpo, personi që beson Allahun, Krijuesin e të gjitha krijesave dhe të Cilit i mbështetet, ruan karakterin e tij të

fortë, pa marrë parasysh se çfarë t'i ndodhë. Është kështu, se e di se Allahu është burimi i vetëm i fuqisë dhe Allahu është Poseduesi i Përherëshëm dhe Sovran. Prandaj, faktori i vetëm në të cilin besimi i njeriut duhet të varet është besimi në Allahun.

Njeriu që i drejtohet Allahut dhe mbështet besimin e tij në Të për të gjitha çështjet, ndërton një karakter të fortë sepse e di që nuk ka fuqi tjetër pos Atij. Pa vullnetin e Allahut, nuk mund t'i ndodhë asgjë besimtarit. Ndërkaq, kur Allahu vendos për diçka, Ai vetëm thotë, "Bëhu" dhe bëhet. Për njerëzit, të cilët janë të dobët dhe kanë nevojë për Krijuesin, nuk ekziston asgjë më e mrekullueshme se të jenë miq të Allahut. Prandaj, për një besimtar është e pakapshme ta paramendojë veten se bazohet në pasurinë materiale ose ndonjë gjë tjetër të përkohshme. Ai i konsideron këto të mira si begati e dhënë nga Allahut dhe i përdor vetëm në shërbim të Allahut.

**Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë. (Kehf, 18: 46)**

Siç pohohet në vargjet e më lart, për njerëzit kryelartë edhe fëmijët janë një formë e pasurisë, gjithashtu; ata i konsiderojnë si objekte për mburrje. Ata edhe cilësitë e mira të fëmijëve të tyre e konsiderojnë si meritë e tyre, dhe në këtë mënyrë mburren, thua se janë vetë ata, të cilët i kanë dhënë ato cilësi fëmijëve të tyre. Në vend që të kuptojnë se fëmijët e tyre janë begati e dhënë nga Allahu dhe ua ka dhënë për tu kujdesur për ta dhe t'i rrisin dhe edukojnë atë mënyrë që të

fitojnë kënaqësinë e Allahut, përkundrazi, ata i konsiderojnë fëmijët e tyre si mjet për të garuar me të tjerët. Për këtë shkak, çdo gjë që ka të bëjë me fëmijët e tyre si p.sh ushqimi, veshja, shkollimi që ata e ndjekin, profesioni etj. bëhet çështje prestigji për ta.

“Salltaneti”, i cili duhet konsideruar si “sëmundje” shoqërore, nuk përshkruhet vetëm me këtë shembull. Shumica e njerëzve mburren me pozitën e tyre shoqërore, veshjen, veturat, shtëpitë, mallin etj. Për çudi, qëllimi i tyre kryesor është që në këtë formë të luksit të fitojnë respektin e të tjerëve. Për shkak se zgjedhjet e tyre nuk pasqyrojnë atë çka në të vërtetë kanë nevojë për të përmirësuar shëndetin, rahatinë apo shijet. Ata u kushtojnë shumë rëndësi mendimit të të tjerëve. Kjo i shtynë në një rreth vicioz emocional, drejt qëllimeve dhe aspiratave çdo herë e më të mëdha. Por a do të jetë e mjaftueshme kjo aspiratë që t’i shuaj lakmitë e njeriut?

Allahu na njofton në Kuran se lakmia e jobesimtarëve është e pashterrshme. Sa më lakmitar të jetë njeriu, aq më kryelartë dhe kundërshtues bëhet. Në të vërtetë, ajeti i më poshtëm na jep përshkrim të saktë të psikologjisë së jobesimtarit:

**Ti, më le Mua dhe atë që e krijova të vetmuar. Dhe bëra këtë pasuri të madhe. E bëra edhe me djem që i ka me vete. Dhe Unë i lash në disponim të gjitha mundësitë. E ai lakmon që t’i shtoj edhe më tepër. (Mudeththir, 74: 11-15)**

Ashtu siç na shpjegon ajeti më lart, lakmitë janë të pashterrshme, ku çdoherë shtohet dëshira për tepër e më tepër. Çdoherë dëshiron diçka, dhe kur ta arrij, menjëherë

kërkon tjetrën. Njeriu beson se do të jetë i lumtur vetëm atëherë kur realizon dëshirën e tij, por së shpejti ai do të vërejë se realizimi i asaj dëshire që ka menduar se do të ketë përfundim të dëshirueshëm nuk i sjell lumturi të gjatë. Pavarësisht nga ky fakt, megjithatë, i shtyrë nga lakmia, ai grumbullon pasuri dhe vazhdimisht orvatet që të ketë më tepër. Për shembull, pas disa vjet orvatjesh, dikush arrinë ta blejë një banesë. Por pas pak viteve, humb interesi për të dhe fillon të lakmojë shtëpitë e mira. Le të supozojmë se ai ia del mbanë dhe e blen edhe atë; pastaj vetëm pas pesë viteve, ai fillon të ëndërrojë për një shtëpi edhe më të mirë, këtë herë me pishinë dhe kopsht, dhe ky rreth vicioz vazhdon tutje.

Shpesh ne hasim shembuj të ngjashëm edhe në jetën tonë. Vrapimi pas shtëpisë, veturës, vilës, fëmijëve, përfitimeve personale etj., i joshë këta njerëz drejt një spirale të pafund të ngashënimit pas jetës së kësaj bote, dhe i preokupon derisa t'i zë vdekja. Natyrisht, nuk ka asgjë të keqe ky preokupim; plotësisht është e drejtë. Por, e tërë jeta të jetë e drejtuar nga këto ambicie, nuk ka kuptim. Në të vërtetë, disa nga "lojtarët" edhe arrijnë shumë nga dëshirat e tyre në këtë lojë, por shumica dështojnë, dhe takohen me vdekjen para se të shuhet lakmia.

Është e kotë që të konsumohemi me lakmi të tillë, por përkohshmëria e kësaj bote, ose shkurtësia e kësaj jete, nuk janë të vetmet shkaqe për këtë kotësi. Ne po ashtu duhet të kemi në konsideratë edhe këtë gjë: edhe njeriu më i pasur që jeton në një shtëpi shumë të madhe, apo shtëpi të mahnitshme me më shumë dhoma se njerëz, mund të qëndrojë vetëm në një dhomë brenda një kohe të caktuar.

Edhe pse, mund të ketë një gardërobë të shumë të mahnitshme dhe të shtrenjtë, mund të veshë vetëm një komplet tesha për momentin. Edhe nëse i ndërron rrobat për çdo orë, shumë shpejt do të mërzhitet. Nëse edhe i shërbehet pandërprerë ushqim i zgjedhur dhe i shumëllojshëm, atij do t'i shuhet oreksi para se të përfundojë servimin e dytë. Përpjekja për të ngrënë më tepër, madje mund të jetë edhe e dëmshme... Është e qartë se shumica e sjelljeve të njeriut drejtohen nga koprracia e kotë. Sido që të jetë, nga pikëpamja e atij që ka aftësi të dalloj mirë, këto nuk janë gjëra për të cilat duhet të bëhemi ambicioz. Përkundrazi, janë mashtrime në jetën e kësaj bote. Ky fakt, i cili injorohet nga shumica e njerëzve, tregohet në këtë mënyrë në Kuran:

**Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, por te Allahu është e ardhmja më e mirë. (Ali Imran, 3: 14)**

Ekziston edhe një fakt tjetër i rëndësishëm që duhet mbahet në mend; çdo gjë që njeriu posedon në këtë botë ekziston nga Vullneti i Allahut. Me Vullnetin e Allahut, disa njerëz kanë lindur të pasur, derisa të tjerët janë sprovuar me varfëri gjatë jetës së tyre. Sido qoftë, është plotësisht e paarsyeshme për njeriun të bëhet arrogant për shkak të begatitë që Allahu ia dhuron atij. Si njerëz, duhet të kuptojmë se kjo me të vërtetë është çështje e Vullnetit të Allahut; Ai përmirëson gjendjen atyre që do dhe gjithashtu kufizon pasurinë tjerëve. Megjithatë, në të dy rastet, kjo është

një sprovë për njeriun; pasi sprovohet në atë se si do jetë qëndrimi i tij ndaj këtyre begative dhe kufizimeve. Në një varg thuhet:

**Allahu ofron furnizim me bollëk atij që do dhe ia kufizon (atij që do). Po ata (jobesimtarët) janë të gëzuar me jetën e kësaj bote. E jeta e kësaj bote ndaj botës tjetër nuk është tjetër vetëm se një përjetim (i shkurtër). (Rra'd, 13: 26)**

Pasi është kështu, në jetën e kësaj bote, e cila është aq e shkurtë sa hap e mbyll sytë, njeriu duhet t'iu shmangët mashtrimeve të tilla dhe të jetë mirënjohës ndaj begative që iu kanë dhënë, sesa të përdoren si gjëra për tu bërë arrogant ndaj Allahut. Në të vërtetë, Dita e Ringjalljes është një ditë e tmerrshme, kur e tërë pasuria do të zhduket plotësisht. Në atë Ditë, kur nuk do të mbetet asnjë gjurmë njeriu, ai do të thirret të japë llogari për çdo shkelje që ai e ka bërë kundër Allahut.

Në vazhdim të këtij libri, ne do t'iu paraqesim shembuj nga jeta e njerëzve arrogantë, të cilët mburrëshin me pasurinë e tyre, ashtu siç edhe janë të përmendur në Kuran.

## **Bukuria dhe rinia**

Edhe bukuria është njëra nga shkaqet që e bën njeriun të jetë kryelartë. Njerëzit shumë lehtë janë mashtruar nga ngashënjimi i rrufeshëm i kësaj bote. Sido që të jetë, bukuria nuk është cilësi e krijuar nga vetë njeriu. Ajo dhurohet nga Allahu. Gjithashtu ajo është cilësi që mund të humbet në çdo kohë.



Çdo kush e di që për një çast të vetëm mund të humbet bukuria e dikujt. Vërraga në fytyrë, ose të humburit e organit, mund të ndryshoj pamjen e njeriut përgjithmonë, dhe askush nuk është imun nga kjo. Edhe nëse nuk ndodh asnjëra nga këto gjëra të tmerrshme, njeriu duhet të ketë parasysh se është i paaftë të i rezistojë një armiku të pamëshirshëm dhe i pafrenueshëm, e që është pleqëria. Edhe njeriu më i bukur në botë nuk mund ta pengoj procesit të pleqërisë, dhe ngadalë bukuria humbet së pari, duke filluar rrudhat dhe gjurmët e tjera të pleqërisë, dhe zbehet me kalimin e kohës. Njerëzit e famshëm janë shembull i mirë i këtij realiteti. Si ligj i pandryshueshëm i Allahut, këta njerëz, të cilët sot kënaqen në valën e adhurimit të admiruesve, nuk mund ta parandalojnë pleqërinë e tyre gjatë kalimit të jetës së tyre. E gjithë pasuria dhe gjërat që i kanë në dispozicion nuk mund t'i shpëtojnë nga ky fund i paevitueshëm. Këto shembuj na bëjnë të kuptojmë se sa e kotë është për njeriun të bëhet arrogant për shkak të bukurisë dhe rinisë së vet. Madje, do të ndihmoj mjaft nëse do kemi parasysh se çfarë ndodhë me trupin në dhjetë ditët e para pas vdekjes.

Kufoma, kur varroset nën dhé, do t'i nënshtrohet një procesi të shpejtë të kalbjes. Menjëherë pasi kufoma të vendoset në varr, bakteret fillojnë punën. Gazrat të liruara nga këta organizma fryjnë trupin, duke filluar nga abdomeni, duke ndryshuar formën dhe pamjen e tij. Gjaku del nga goja dhe hunda për shkak të shtypjes së gazrave në diafragmë. Transformimin e jashtëm të trupit, e shoqërojnë organet e tij të brendshme, të cilat po ashtu prishen, duke liruar një aromë të neveritshme dhe të padurueshme. Edhe truri do të kalbet.

Eshtrat ndahen nga pejzat dhe skeleti shkatërrohet. Ky proces vazhdon derisa i tërë trupi do të mbetet si një grumbull i thjeshtë eshtrash.

Saktësisht kjo është ajo që do të na ndodhë gjithë neve, edhe pse na vjen vështirë për ta dërguar mendjen në këtë gjë. Ai i cili mendon se atraktiviteti i tij fizik i takon atij, po ashtu duhet të mendojë njëjtë edhe për kufomën e vet të kalbur. Sidoqoftë, kësaj mundohet t'i shmanget edhe personi më i bukur në botë, sepse është absurd që njeriu të mburret dhe të bëhet mendjemadh ndaj Allahut me trupin e vet të kalbur.

Nga ana tjetër, disave u mungon vetëbesimi sepse nuk janë mjaft atraktiv. Në fakt, kjo është një formë tjetër e egoizmit. Personi në fjalë, ia veshë vetes bukurinë ndërsa mungesën e saj e konsideron si mungesë apo e metë. Sa i përket kësaj çështje, rekomandohet sjellja modeste e besimtarëve. Besimtarët janë të kënaqur me atë që Allahu u ka dhuruar, kështu që nuk i konsiderojnë vetitë e tyre fizike si arsye vetë-dyshimi ose arrogance. Ata janë të vetëdijsëm se pronar i vërtetë të trupave të tyre është Allahu, dhe se ata janë vetëm duke u sprovuar me trupat e tyre. Shpirti është ai i cili vlen dhe afërsia e dikujt ndaj Allahut.

Duke qenë mirënjohës ndaj Allahut, i vetëdijsëm se bukuria është dhuratë nga Ai për njeriun, dhe në këtë mënyrë duke qenë modest, është mënyra më shembullore e sjelljes. Ndërkaq, mund të ndodhë që Allahu të i dhurojë dikujt bukuri të brendshme, joshëse dhe tërheqëse në sytë e Tij dhe nuk mburret me atë që ka, duke ditur se Allahu është ai i cili posedon çdo gjë. Prandaj, personi i tillë mund të jetë më i dashur për njerëzit se sa shumë të tjerë me dukje më të mirë fizike.

## Pozita, prestigji dhe respekti

**Dhe mos ec në tokë me mburrje pasi ti as nuk mund ta çash tokën e as nuk mund të arrish lartësinë e maleve. (Isra, 17:37)**

Duke pasur status, dhe prestigjin që ai e sjellë, është një nga ngashënjimet e jetës së kësaj bote. Me siguri është e padobishme dhe e paarsyeshme të qenit kryelartë dhe për tu ndier superior për shkak të pozitës dhe prestigjit që njeriu e ka në këtë jetë. Historia është e stërmëbushur përplot me shembuj të njerëzve të cilët kishin pozitë dhe pushtet të madh, e pastaj që i kishin humbur të dyja për një çast. Me siguri, çdonjëri është i njoftuar me shembuj të tillë. Edhe pse të vetëdijshëm për këta shembuj, ata që e konsiderojnë pozitën dhe prestigjin e tyre si arsye për krenari, thjeshtë nuk janë të mençur, pasi që këto janë vlera të kësaj bote të cilat janë çmuara nga njerëz të caktuar dhe janë gjëra të kësaj bote. Njeriu i kamur, për shembull, në përgjithësi është i respektuar vetëm nga punëtorët tij. Po ashtu, edhe një burrë shteti është i njohur dhe i çmuar vetëm nga banorët e atij shteti. Edhe nëse dikush arrin të fitojë mirënjohjen dhe respektin e të gjithë njerëzve në botë, edhe pse vështirë mund të ndodhë- ky fakt vështirë se do të jetë i pandryshueshëm. E vërteta është se ata të cilët e respektojnë atë janë njerëz të zakonshëm, e kjo nuk është gjë e përjetshme.

E vërteta e pandryshueshme e jetës së kësaj bote është kjo: pa marrë parasysh a është dikush i varfër apo i pasur, i bukur apo i shëmtuar, një ditë do të mbështjellët me qefin të thjeshtë dhe do të vendoset në varr. Çdo gjë që i përket kësaj bote, nuk do t'i sjellë më ndonjë dobi. Ai do të mbetet vetëm si eshtra dhe asgjë tjetër. Në atë moment, statusi, profesioni,

pushteti apo bukuria e dikujt do të humbin tërë kuptimin, dhe njeriu do të pyetet vetëm e vetëm për nënshtrimin e tij ndaj Allahut. Qëndrimi i dikujt në këtë botë dhe bindja e tij e plotë ndaj Zotit të tij, do të jenë kritere vendimtare për pozitën e tij në jetën pas vdekjes. Kurani na informon për të ardhmërinë këtyre njerëzve në jetën pas vdekjes:

**Hiq atyre që e marrin fenë (në vend që ta respektojnë) për lojë e dëfrim dhe i ka mashtruar jeta e kësaj bote. Ti përkujto me të (Kuranin) që të mos bjerë njeriu viktimë e asaj që ka vepruar, e që s'ka mbrojtës as ndërmjetësues për te pos Allahut. Madje ai (njeri) edhe nëse jep, çdo lloj shpagimi nuk i pranohet. Të tillët janë ata që ranë viktimë e asaj që punuan. Ata, për shkak se mohuan, për pije kanë ujë të vluar e dënim të hidhët. (En-am, 6: 70)**

Në esencë, ata të cilët mburren me statusin e tyre dhe e konsiderojnë veten më të lartë se të tjerët, janë ata që vuajnë më së shumti nga pasojat e veprave të tyre. Kjo ndodhë për shkak se çdoherë ndokush është në pozitë më të lartë, afër të cilit njerëzit e tillë ndihen inferiorë, gjë që është një shkaktar i madh i çoroditjes së këtyre njerëzve.

Pikëpamje tjetër e temës për të cilën po e shqyrtojmë e që meriton theksim të veçantë; është se arroganca e tyre nuk sjell kurrfarë dobie në këtë botë. Edhe pse këta njerëz fitojnë ndonjë formë të mirënjohjes nga të tjerët, në të vërtetë, ata janë të padëshirueshëm dhe shoqërimi i tyre është shumë pak i mirëseardhur. Ata të cilët janë modestë, nga ana tjetër, janë ata të cilët e vlerësojnë rëndësinë e karakterit, mençurisë dhe moralit si vlera të vërteta. Ata nuk mburren aspak me cilësitë e tyre. Dhe, duke pasur këtë karakter, ata fitojnë dashurinë, respektin dhe mirënjohjen e të tjerëve.

## Inteligjenca, ndriçimi i mendjes dhe arsimimi

Përveç pasurisë, bukurisë dhe statusit shoqëror të cilat janë shkaqet kryesore të arrogancës, ekziston edhe një faktor tjetër të cilit njerëzit i japin rëndësi shumë të madhe. Ata konsiderojnë se të qenit i diplomuar në ndonjë kolegji prestigjioz, për shembull, është arsye e fortë për kryelartësi.

Sidoqoftë, si edhe të gjitha gjërat tjera në jetë, të ndjekurit e shkollës së tillë po ashtu është pjesë e fatit që Allahu ka paracaktuar. Prandaj, marrja e kësaj si arsye për të qenë kryelartë do të ishte një mburrje e pavend e dikujt.

Në jetën pas vdekjes, njeriu as nuk do të pyetet në cilin fakultet ka diplomuar, as për kualifikimin e tij intelektual. (Patjetër, arsimimi është shumë i rëndësishëm por sigurisht jo diçka që duhet të mburret.) Para Allahut njeriu do të jetë përgjegjës për sinqeritetin, besimin, modestinë dhe adhurimin e tij.

Sidoqoftë, për njerëzit e tillë, që vetes i vejnë qëllim kryesor arritjen e vlerave të përkohshme të kësaj bote, çdo cilësi- e vogël apo e rëndësishme- mund të jetë shkak për arrogancë. Të poseduarit e njohurisë së thellë për një lëndë është cilësi e tillë. Në fakt, edhe pse dikush mund të jetë jashtëzakonisht i aftë në matematikë, ose ka zhvilluar teori të rëndësishme në fushën e fizikës, ekziston vetëm një problem i rëndësishëm që neve duhet ta marrim parasysh; edhe nëse e përdorë gjithë njohurinë e vet, asnjëherë nuk do të mund të ndryshojë as ndonjë ligj të thjeshtë të fizikës ose të krijojë një qelizë të gjallë.

Përveç çështjeve themelore të përmendura më lart, po ashtu ka asi që mburren me cilësitë e tyre të parëndësishme. Për ata, privilegje të zakonshme, si flokët e bukura, veturë e

re, veshjen, njohuri me kompjuter, zë të fuqishëm, shokë të popullarizuar etj., mund të jenë arsye për ta për tu mburrur. Sidoqoftë, ata të cilët janë më të mençur, vazhdimisht janë të vetëdijshëm për banalitetin dhe trivialitetin e kësaj mënyre të thjeshtë e të menduarit.

Të mençurit, pra, peygamberet dhe besimtarët që qëndruan modest gjatë tërë jetës së tyre, japin shembull shumë të mirë për të pasuar. Për shembull, profeti Sulejman përdori gjithë pasurinë dhe pushtetin e tij për çështjen e Allahut. Ngjashëm, Dhulkarnejni, autoritetin e tij mbi popujt e përdori si mjet për t'i shërbyer fesë së Allahut. Po ashtu, profeti Davud ka shfaqur kujdes të madh ndaj urdhrave të Allahut dhe duke iu përmbajtur dhe duke qenë i drejtë.

Përveç këtyre pak njerëzve të zgjedhur, edhe jeta e pasuesve të të dërguarit Muhammed (saas) jep shembull të mirë për muslimanët. Megjithëse shumica e tyre kishin prejardhjen nga familje të mirënjohura të shoqërive ku jetonin, ata aspak nuk nguronin që të anonin kah Allahu dhe i dërguari i Tij, kur ishin të detyruar të zgjedhin në mes të pasurisë, parave, njerëzve rreth tyre dhe fesë së Allahut. Ishte kështu, sepse ata ishin të vetëdijshëm se jeta e kësaj bote është e parëndësishme dhe se vendi i vërtetë për të pushuar është në jetën e përtejme. Me qëllim që të fitojnë kënaqësinë e Allahut, ata iu bashkëngjitën të Dërguarit saas, u shpërngulën kur ishin të detyruar, lanë pas vetes pasuritë dhe pronat, nuk lakmonin shkallën shoqërore apo rangun që kishin, por tërë jetën e tyre ia kushtuan shërbimit në rrugën e Allahut.

Shihet qartë se me cilin karakter është i kënaqur Allahu. Ata të cilët aktualisht mund të jenë në posedim të të mirave siç janë pasuria, bukuria, inteligjenca, prestigji, rinia etj., duhet të mbajnë mend se Allahu është ai i Cili ua ka dhuruar ato të mira dhe se janë në sprovë me ato. Në Ditën e Gjykimit ata do të thirren të japin llogari për secilën nga këto të mira. Allahu në Kuran tregon për psikologjinë e atyre që dështuan të kuptojnë këtë fakt, dhe në këtë mënyrë të bëhen kryelartë ndaj Tij:

**Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme. A mendon ai, se atë nuk mund ta mposhtë askush? (Beled, 90: 5-7)**

Për të mirën e tij, lexuesi duhet të vrasë mendjen mbi karakterin e tij duke e marrë parasysh atë që është shpjeguar në këtë kapitull. Instinkti i njeriut shumë ka prirje për tu mburrur. Inteligjenca, prejardhja, profesioni, shtëpia, vetura, edukata, vetitë fizike të dikujt dhe tipare tjera të ndryshme mund ta shpijnë në mendjemadhësi. Bile, përpos kësaj, dikush i gjen edhe tjera gjëra për tu mburrë. Por, gjëja kryesore është që të mos humbasim rrugën dhe të mashtrohemi nga aspektet sipërfaqësore të kësaj bote. Duhet mbahet mend se arroganca i sjell njeriut vetëm poshtërim në këtë botë dhe botën tjetër.

# PASOJAT E ARROGANCËS NË SHPIRT



**A**rrogantët pa dyshim janë koprracë dhe lakmojnë të jenë prestigjioz.. Ata janë të njohur për ambiciet dhe dëshira për të fituar prestigj. Kudo që të jenë, dëshirojnë të bëhen më supremët, më të veçantët dhe më me autoritet. Ata mbështeten në bukurinë, posedimin, inteligjencën ose statusin, dmth. në gjërat me të cilat mburren. Bile, besojnë se kurrë nuk do t'i humbin këto cilësi ose posedime. Në asnjë moment ata nuk dyshojnë në të menduarit e gabuar të tyre. Edhe pse njerëzit rreth tyre janë të vetëdijsëm për të metat e tyre, ata i besojnë vetes padiskutim. Në të vërtetë, ata kanë shumë dobësi për shkak se nuk mund të kuptojnë këto fakte. Në Kuran kjo e metë mentale është e shpjeguar në këtë mënyrë:

**Ka prej tyre që të dëgjojnë (kur lexon, por formalisht). A mund të bësh të shurdhëtin të dëgjojë, edhe kur ata nuk kuptojnë? Ka prej tyre që të shikon ty (duket se po të shikon). A mund ta udhëzosh ti të verbrin, kur ata nuk shohin (të vërtetën)? (Junus: 10:42-43)**



Sado që arsyet për kryelartësi dallojnë nga njeri tjetri, e që varet nga karakteri i tyre, gjendja shpirtërore e arrogantëve është pothuajse e njëjtë. Në kapitullin e ardhshëm, do t'i shqyrtojmë disa nga cilësitë kryesore që rrjedhin nga kjo gjendje shpirtërore.

### **Ata gjenden në gjendje të sëmurë dhe të çrregullt shpirtërore**

Njeriu normal, i cili ka gjendje shpirtërore të qëndrueshme, është i hapur, i lirë dhe i sigurtë. Ndërsa, njeriu kryelartë vuan nga një gjendje të errët dhe të çrregulluar shpirtërore. Të mashtruar dhe të verbëruar nga krenaria, bota e tij e brendshme është një vend i zyrtë me shqetësim dhe ankth, i gllabëruar nga intrigat dhe mendimet e liga. Gjendja e tillë shpirtërore i raskapitë si dhe bën që të plaken para kohe.

Të dobët në karakter, ata janë të ftohtë dhe keqdashës. Janë të rralla rastet kur në fytyrat e tyre shihen shenja dashamirësie apo dashurie, ose të dëgjohen fjalë inkurajuese nga ta. Në praninë apo shoqërinë e tyre, njeriu nuk ndihet i lirshëm dhe komfort. Burrat mundohen të jenë agresiv dhe gjaknxehtë. Ndërsa femrat, nga ana tjetër, arroganca manifestohet me shqetësim. Kudo që të jenë, edhe problemi më i vogël mund të shkaktojë tension tek ata dhe t'i fusë në ngatërresë.

### **Ata frikohen me të madhe të bëjnë gabime**

Të gjitha veprimet dhe mendimet e atyre që mburren pa masë drejtohen kah të fituarit e kënaqësisë së të tjerëve dhe të bëhen më superiorë. Për këtë arsye, frikësohen shumë të

bëjnë gabime. Për ata, bërja e gabimeve është formë e poshtërimit. Ata kanë besim të plotë në vetvete, por prapëseprapë, vazhdimisht ndihen të shqetësuar në mos bëjnë gabime. Arrogantët me të madhe mundohen t'i shmangen të gjitha llojet e gabimeve; pasi për ta gabimet janë turp. Prandaj, mohojnë edhe mundësinë e tyre për të gabuar. Ata vazhdimisht mundohen për t'iu ikur akuzave të çdo gabimi. Në një ajet, Allahu përshkruan natyrën e këtyre njerëzve:

**A nuk ke kuptuar për ata që vlerësojnë vetveten? Jo, Allahu vlerëson atë që do dhe nuk bën padrejtë asnjë fije. (Nisa' 4: 49)**

Arroganti nënçmon ata që ua zbulojnë gabimet. Ata zmadhojnë gabimet që tjerët i bëjnë, duke shfrytëzuar çdo rast për t'i hedhur në shesh. Ata nuk shfaqin aspak mëshirë ndaj atyre që bëjnë gabime dhe bëhen mospërfillës ndaj tyre. Ata gabimisht pretendojnë se nëse i zbulojnë gabimet e të tjerëve theksohet pagabueshmëria e tyre. Prandaj, askush nuk ndihet rehat në shoqërinë e tyre. Çdo herë, njerëzit e tillë krijojnë atmosferë negative.

Për shkak të këtyre cilësive të pahijshme, arroganti kurrë nuk mund të posedojë sinqeritet në kuptimin e plotë të fjalës. Mbeten të privuar nga kjo cilësi sepse janë të ftohtë, gjithmonë intrigues. Tiparet e tilla pengojnë që të bëhen të sinqertë ndaj të tjerëve, duke qenë shkak që të tjerët të largohen nga ata. Çdoherë frikësohen se sjellja e sinqertë ose të metat natyrore mund të bëhen objekte tallëse ndaj tyre. Në sajë të karakterit të keq, arrogantët zakonisht braktisen nga të tjerët kur humbin pushtetin ose pasurinë. Prapëseprapë, duhet të mbajmë në mend se, edhe në kohëra kur ata

ndiheshin të fuqishëm, në botën e tyre të brendshme janë të vetëm, dhe shumë larg nga morali kuranor.

## Ata nuk mund të durojnë kritikën

Të qenit temë e kritikës është diçka që arrogantit nuk e pëlqen fare. Kur kritikohet, muskujt e fytyrës së tij tensionohen dhe pamja e tij zbehet. I brengosur për dëmtimin e prestigjit të vet, ai llahtariset. Ai supozon se nëse bën gabim, atëherë do të përqeshet ose turpërohet nga tjerët, ashtu si e ka zakon edhe vetë të iu tërheq vërejtjen tjerëve në situata të ngjashme. Ai beson se të qenit temë e kritikës ose qortimit është degradim. Përvetësimi i gjendjes së tillë shpirtërore është i dëmshëm si në aspektin shpirtëror ashtu edhe në atë fizik. Zëri i tyre shteret dhe ngjiret, ata dobësohen dhe dridhen nga tensioni dhe në fytyrë nuk gjen fare shenja të sinqeritetit. Përfundimisht, kurrsesi nuk mund të rehatohen dhe qetësohen.

Ata mbahen si “më të bukurit”, “më të mençurit” dhe si “më të përgatiturit”. Synimet e tilla u bëjnë presion të pandërprerë. Duke e parë veten si të përsosur ose superior, (ose thënë më mirë, mundohen ta paraqesin veten), edhe ngacmimi më i vogël mjafton që të tërbohen. Sido që të jetë, ekziston një pikë që e harrojnë; ata përpiqen të paraqesin veten si të përsosur dhe të pametë, e në disa raste edhe arrijnë atë. Por prapëseprapë, në Ditën e Gjykimit ata do të përballen me të gjitha veprat e tyre të liga, si të vogla ashtu edhe të mëdha. Siç Allahu na informon në Kuran, **“A thua nuk e dinë ata se Allahu e di atë çka e fshehin dhe atë çka e publikojnë? (Bekare, 2:77)**, çdo gjë për ata, i di Allahu i Plotfuqishëm. Por duke harruar Zotin e tyre dhe Ditën e Gjykimit, ata vetëm e mashtrojnë dhe turpërojnë veten.

## Atyre iu pëlqen lavdërimi

Gjendja shpirtërore tipike për arrogantin është i dukshëm si në pamjen ashtu edhe në mënyrën e të folurit të tyre. Të tillët ose lavdërohen haptazi ose vendosin veten në vende lavdëruese. Në anën tjetër, tiparet e mira të të tjerëve i bën ziliqarë. Kjo zili menjëherë shprehet në fytyrën e tyre. Për shkak të kryelartësisë, ata nuk janë të shoqërueshëm. Në parim, ata janë të tendosur dhe të shqetësuar, duke u munduar të paraqiten të qetë dhe ndryshe nga tjerët. Më së tepërmi kënaqen kur lavdërohen vetë ose lavdërohen nga të tjerët.

Përndryshe, besimtarët janë të vetëdijshëm se ata janë vetëm robër të Allahut dhe se vetëm Allahu është i denjë për tu lavdëruar. I dërguari Muhamedi (saas) jep një shembull të modestisë për gjithë muslimanët, sikurse thuhet në hadithin e tij:

*Mos më lavdëroni tepër; pasi që unë jam vetëm rob i Zotit; prandaj më thirrni rob i dhe i dërguar i Allahut. (Buhariu, Muslimi)*

## Arroganca parandalon njeriun për të dashuruar dhe të jetë i dashuruar

Kryelartit e donë veten më së tepërmi dhe për atë arsye ata asnjëherë nuk shijojnë dashuri të vërtetë. Në shumicën e rasteve, ata vetëm mund të bëhen kinse dashurojnë. Ata mendojnë se shfaqja e dashurisë tjerëve, i poshtëron; ata çdoherë dëshirojnë të jenë ata që tu kushtohet kujdes dhe dashuri. Arrogantët mendojnë se është dobësi për të dashur të tjerët si dhe tu shfaqet të tjerëve dashuri.

Për shkak të krenarisë së tyre imponuese, nuk janë të aftë të donë. Kryesisht, dashuria ndaj personit tjetër kërkon që dikush të ketë aftësi t'i dallojë cilësitë që meritojnë të duhen. Prandaj, arroganti ngurron t'i njohë këto cilësi të dobishme tek njerëzit. Në të vërtetë, në sytë e tyre, shohin se vetëm ata meritojnë të duhen. Për këtë shkak, ata xhelozojnë në bukurinë, inteligjencën, virtytin ose pasurinë e të tjerëve. Ndonjëherë, kjo xhelozia arrin në nivel aq të lartë saqë dëshirojnë që edhe tjerët t'i humbin të gjitha të mirat e tyre.

Arsye tjetër pse njerëzit kryelartë janë të paaftë për të shfaqur dashuri është se nuk dijnë të çmojnë cilësitë e mira të të tjerëve. Bile, edhe po nëse i shohin ato cilësi, me qëllim nuk i përmendin. Prania e dikujt me cilësi më të mira se e tyre i bën të shqetësohen. Të shkatërruar nga xhelozia, bëhen keqdashës dhe armiqë.

Në realitet, kryelartët të shqetësuar në shpirt; janë në humbje të madhe. Gjatë gjithë jetës së tyre asnjëherë nuk do të mund të përjetojnë dashuri të vërtetë, ndjenjë e cila është dhuratë e çmuar nga Allahu. Përveç paaftësisë për të dashur, edhe ata nuk dashurohen në kuptimin e plotë të fjalës, edhe pse mund të jenë të bukur ose inteligjentë. Sepse mund të jetë ndonjë interes që të krijojnë marrëdhënie me dikë. Përndryshe, shumica e njerëzve nuk e pëlqejnë shoqërinë e tyre. Është diçka e pakëndshme në karakterin dhe rrethin e tyre. Në mungesë të butësisë, ngrohtësisë, sinqeritetit dhe modestisë në karakterin e tyre, nuk është vështirë të kuptojmë pse njerëzit i largohen nga njerëzit e tillë pavarësisht nga statusi apo privilegji i tyre.

## Ata nuk janë të aftë për t'u kënaqur

Arroganti, gjithashtu, është i paaftë për t'u kënaqur. Ngjarjet dhe vendet ku të tjerët kryesisht kënaqen, nuk i përkasin shijes së tyre. Në rrethana të tilla, ata kërkojnë jo-përsosmërinë tek të tjerët dhe gjatë gjithë kohës orvaten ta shfaqin superioritetin e tyre të supozuar. Ata mundohen të duken 'cool' dhe indiferent si shenjë të superioritetit dhe i duket se është degraduese të jesh i kënaqur.

Megjithatë, vetëm ata vuajnë nga pasojat e prirjes së tillë; edhe nuk mund të shijojnë begatinë e gëzimit, duke qenë vazhdimisht të zhytur në botën e tyre të errët. Për çudi, ata nuk mund të kuptojnë shkakun e shqetësimit të tyre. Sipas tyre, edhe pse kanë tipare të larta, nuk mund të çlirohen nga shqetësimi dhe hidhërimi. Kjo vërteton faktin se ata që janë kryelartë ndaj Allahut nuk janë të aftë për të kuptuar se Allahu është Ai i cili shkakton shqetësime në zemra.

Ajeti i mëposhtëm tregon në detale të këtë lloj arrogancë:

**Dhe kur i thuhet atij: "Kij frikë Allahun!", atë e kap eufori për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (Xhehenemi). (Bekare, 2: 206)**

Allahu bën që këta njerëz të bien në depresion dhe i gropos në poshtërim, për shkak të "kryelartësisë" dhe "harresës" ndaj Tij:

**Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. (En'am, 6: 125)**

Pa dyshim këto janë problemet që u shkaktohen në këtë botë; por, dënimi në botën e pastajme do të jetë edhe më i rëndë.

# PASOJAT NEGATIVE TË ARROGANCËS NË TRUPIN E NJERIUT



**A**rroganca sjell shqetësim të vazhdueshëm. Pas një periudhe të vazhduar kohore, shkakton tension dhe stres në trupin e njeriut. Shqetësimet si: të gabuarit, të qenit i nënshtruar ndaj i kritikave ose nënçmimit, humbja e prestigjit, të fituarit e pëlqimit të të tjerëve, ose të humburit e gjërave me të cilat mburret, e vendosin atë nën një presion ekstrem dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme. Kjo është gjendje e tillë që rezulton me stres. Prandaj, shprehjet në fytyrë dhe disponimi i arrogantit shumë ndryshojnë me ato të njeriut modest.

Njeriu kryelartë, i cili e kalon gjithë jetën nën stres të panevojshëm, në të vërtetë i shkakton dëm trupit të tij. Megjithatë, ai këtë nuk e kupton. I humbur duke ndjekur gjërat për tu dukur superior, vendos veten nën një presion të madh, gjurmët e të cilit mund të shihen qartë në trupin e tij.

Shqetësimi që arrogantit ndien përbrenda, vetvetiu manifestohet fizikisht. Për shembull, flokët humbin

shkëlqimin dhe rriten ngadalë. Lëkura e tyre trashet, bëhet e fortë dhe humb elasticitetin. Tendosja në muskujt e tyre bëhet e dukshme. Duken më të vjetër në krahasim me vitet që kanë, dhe rrudhat fillojnë të paraqiten. Goja u thahet. Sytë humbin gjallërinë dhe mprehtësinë. Nën ndikim e arrogancës, cilësitë e meshkujve paraqiten tek femrat; lëkura e tyre trashet, atyre u paraqiten qimet dhe damarët, dhe eshtrat dallohen në duart e tyre. Lëkura u bëhet e mbylltë. Asnjë aspekt fizik pozitiv nuk u ndihmon arrogantëve për të kundërshtuar humbjen e vazhdueshme të bukurisë.

Pavarësisht nga bukuria fizike, një “defekt” sado i vogël, trondit trupin e arrogantit, si pasojë e krenarisë dhe jomençurisë. Ironike, por besimtari i sinqertë dhe modest ka efekt pozitiv tek njerëzit edhe nëse atij i mungon bukuria fizike.

Nga ana tjetër, kryelarti ka të meta gjatë fjalimit, dhe nuk mund të flasë rrjedhshëm ose sinqerisht. Edhe arsyetimin e ka të çalë. Në vend që të flet qartë ose me vendosmëri, flet me mburrje, në mënyrë që t’i mbulojë të metat e veta ose të fitojë kënaqësinë e të tjerëve. Për këtë shkak, çdo fjalë që shqipton tregon qartë mungesë e mençurisë dhe në këtë mënyrë e shfaq jo-sinqeritetin e vet. Posaçërisht, kur gabimet e tij bëhen krejtësisht të qarta, ose kur i jepet këshilla që nuk i pëlqen, tiparet e lartpërmendura bëhen edhe më të theksuara.

Po ashtu edhe organet e brendshme të njeriut janë të ndjeshme nga efektet negative të arrogancës. Si në rastin e duhanit dhe alkoolit, edhe efektet negative të stresit, si pasojë e arrogancës, bëhen të dukshme pas një periudhe kohore.



Bile edhe specialistët kanë lidhur shumë çrregullime me stresin. Pasojat më të dukshme të stresit janë: dhimbjet në bark, gastriti dhe çrregullime të tjera të sistemit të tretjes.

Duhet të mbajmë në mend se të gjitha efektet e lartpërmendura mund të vërehen vetëm nëse u kushtohet vëmendje. Njerëzit që i kanë këto tipare mund të mohojnë ekzistimin e këtyre simptomave ose mundohen t'i arsyetojnë. Sidoqoftë, krahasimi mes besimtarit, i cili i nënshtrohet Allahut dhe njeriut kryelartë, mund t'i bëjë të dukshme këto dallime fizike dhe shpirtërore. Duke u plakur, dallimet bëhen edhe më të dukshme. Prandaj, njeriu kryelartë më së shumti i shkakton dëm vetes. Nga ana tjetër, besimtarët bëjnë një jetë të lumtur dhe të qetë, pasi që besojnë në Allahun, dhe besojnë në paracaktim apo kader. Natyrisht, shenja të pleqërisë do të shfaqen edhe tek ata, por jo në atë nivel të asaj të shkaktuar nga stresi dhe temperamenti i vrazhdë i arrogantit. Në këtë mënyrë, besimtarët bëjnë një jetë të lumtur, në këtë botë dhe në botën e pastajme...

# ARROGANCA E FSHEHUR



**F**ormë tjetër e arrogancës ose të konsideruarit e vetes superior, është ajo që ne e quajmë arrogancë e fshehur. Në përgjithësi, sjelljet e njerëzve me arrogancë të fshehur dallojnë shumë nga ato të njerëzve kryelartë. Dallimi më domethënës mes këtyre të dyjave është se njeriu kryelartë mund të dallohet lehtë nga pamja e tij e jashtme, kurse është vështirë të dallohet personi me arrogancë të fshehur.

Zakonisht, njerëzit kryelartë zbulojnë arrogancën e tyre duke u lavdëruar hapur. Ndërsa, është edhe grupi i tjetër i arrogantëve që e mbajnë të fshehtë arrogancën e tyre. Njerëzit e tillë i kushtojnë vëmendje të veçantë maskimit të kësaj cilësie të qortueshme. prandaj, pasojnë pyetjet: Pse ata dëshirojnë ta fshehin arrogancën e tyre? Pse mundohen aq shumë?

Ekzistojnë arsye të shumta për këtë. Në të vërtetë, të tillët, që janë më inteligjent se arrogantët, janë shumë të vetëdijshëm se çka është e drejtë dhe çka jo. Për këtë shkak, ata shohin se sjelljet e arrogantit kanë prirje për të dhënë efekte të padëshirueshme dhe shqetësuar të tjerët. Pasi që ata

i kushtojnë rëndësi të tepruar mendimit të të tjerëve, parapëlqejnë ta fshehin arrogancën e tyre dhe kështu fitojnë kënaqësinë e tyre. Ata e dinë se të qenit modest është virtyt dhe prandaj pretendojnë të bëhen të tillë.

Këta besojnë se janë njerëzit “më inteligjentë” dhe “më të drejtët”. Ata bile hyjnizojnë veten. Bërja e gabimeve ose të qenit i paaftë lëndojnë krenarinë e tyre. Për këtë shkak, përpiqen të krijojnë një imazh të përsosur para syve të njerëzve. Ky është shkakun pse nuk dëshirojnë të njihen si kryelartë dhe turpërohen nëse kuptojnë se njerëzit kanë mendim të tillë për ta. Ata frikohen ta humbin kënaqësinë që kanë të tjerët se sa frika ndaj Allahut dhe kërkimi i kënaqësinë së Tij.

E vetmja gjë që i kënaq është përqeshja e të tjerëve. Kjo një formë që të ushqejnë epshtet e tyre. Sidoqoftë, kësaj i kushtojnë kujdes shumë të madh ashtu që të tjerët mos ta vërejnë këtë ligësi.

Mënyra e tyre e fshehjes së arrogancës është mjaft dinake; kryesisht, mundohen ta paraqesin veten si të përkryer. Është qenësore për ata që të njihen si të “virtytshëm”, duke qenë shkak pse kanë për qëllim të paraqiten si “të përkryer” dhe “të pasherr”. Fitimi i kënaqësisë së tjerëve, dhe admirimi nga ta, dhe kështu, arroganca bëhet qëllimi i tyre kryesor.

Njeriu kryelartë mburret vazhdimisht, duke u munduar që tërheq vëmendjen me tiparet e tyre. Megjithatë, njerëzit me arrogancë të fshehur, i shmangen tentimeve të tilla. Intrigat e tyre janë më të rafinuara, ose saktësisht, më të liga. Ata mundohen të krijojnë rrethana të caktuara që shpien deri tek lavdërimi i tyre nga të tjerët.

Lloji i tillë i arrogancës është i rrezikshëm; është i

ngjashëm me ajsbergun (ku rreth 90 përqind e masës së tij gjendet nën ujë). Pasi lehtë dallohen, arrogancën, në kuptimin e plotë të fjalës, lehtë mund të iu shmangesh. Por, është ndryshe me ata të cilët e fshehin arrogancën e tyre. Arroganca e tyre duket e qartë vetëm pas një kohe, duke e bërë më të vështirë qortimin apo të u shpjegohet situata në të cilën gjenden.

Në përgjithësi, kjo gjendje shpirtërore bëhet vetvetiu e njohur pasi dikush pretendon të ketë autoritet apo përgjegjësi, domethënë, në kësi raste, dobësia e tyre e fshehur bëhet e theksuar. Ata i veshin kësaj përgjegjësie veçoritë e tyre superiore, dhe është shumë e vështirë të binden ndryshe. E nëse arrijnë sukses në përmbushjen e detyrave të tyre, ata mburren pa masë.

Ekzistojnë edhe shumë situata të tjera që shkaktojnë nxjerrjen në sipërfaqe të arrogancës së fshehur. Për shembull, me humbjen e prestigjit, personi i cili paraqitet modest nga pamja e jashtme mund të ketë sjellje të papritur; mund të bëhet introvert, i druajtshëm dhe i vrerët. Ky sjellje tregon shenja arrogance. Temperamenti i njeriut modest asnjëherë nuk ndryshon, pa marrë parasysh se çfarë i ndodhë. Njeriu i tillë e di që ekziston një e mirë në çdo gjë që ndodhë, dhe përpiqet që të fitojë kënaqësinë e Allahut pa marrë parasysh rrethanat. E në të kundërtën, bëhet e qartë se personi në fjalë i jep rëndësi të tepruar prestigjit dhe statusit, duke zbuluar arrogancën e tij.

Në anën tjetër, njeriu modest është i pastër nga sjelljet e ngjashme. Ai është i vetëkënaqur dhe pa brenga. Por, meriton të përmendet se modestia e tepruar është gjithashtu formë e arrogancës. Pasi që, aty ku çmohet modestia, personi

i cili ushqehet me arrogancë të fshehur, përpiqet për të fituar pëlqimin dhe të çmuarit nga të tjerët duke u shtirur si modest.

Siç thamë edhe më parë, arroganca e fshehur është e rrezikshme, meqenëse manifestohet në mënyra të papritura. Dhe, përballja me dikë që ka personalitetin e fshehur, mund të jetë tepër tronditëse. Për shembull, kur ballafaqohet me dështim ose kritikë, personi i cili nuk është i njohur si arrogant, mund të humbë durimin dhe të sillt shumë pahijshëm. Për shkak se nëse tjerët marrin vesh për dështimin e tij, lëndohet rëndë krenaria e tij. Mund të jetë edhe se nuk e ka shfaqur arrogancën e tij asnjëherë pasi dëshirat dhe shpresat e tij kurrë nuk janë sfiduar. Sido që të jetë, mendimi se ka humbur tërë prestigjin në sytë e njerëzve, nuk ndien më nevojë për fshehjen e arrogancës dhe ligësisë së tij, që deri në atë moment kanë qenë të fshehura.

Arroganca e fshehur po ashtu mund të paraqitet në formë të imoralitetit. Personi mund të gënjen për të fshehur jo-përsosmërinë e tij, ose mundohet t'i bëjë të ditura dobësitë e të tjerëve, në mënyrë që vet të duket më i mirë. Nëse e meta e tij vërehet, mundohet të shmang të gjitha reagimet e mundshme dhe të mbrojë natyrën e vet të ulët. Për këtë përfundim, fshihet pas metodave të liga, siç janë, fillon të qajë apo duke i bërë të tjerët të shfaqin keqardhje për të.

Arroganti shfaq pakënaqësinë përmes protestës së qetë, bëhet i ftohtë, reagon ashpër apo sillt keq. Prandaj, dikush që përballt me gjestet e tilla lehtë mund ta njoh arrogantin. Por, në rast të arrogancës së fshehur, vështirë mund të dallohet me gjeste të tilla. Njerëzit e tillë, çdoherë shfaqen të gëzuar dhe me sjellje të zakonshme. Normalisht, sjellja e tyre nuk tradhton asnjë fije dinakërinë e tyre. Madje, në disa raste,

ata shtiren modest me aq sukses, saqë arrijnë t'i mashtrojnë të tjerët. Megjithatë, këta njerëz kanë një veçori të theksuar, e ajo është se kanë mendim tepër të mirë për vetveten. Disi besojnë se janë “më të mirët” si në profesionin e tyre ashtu edhe në shkollë, në rrethin e tyre. Bile, mendimi i tillë ka depërtuar thellë në nëndijen e tyre. Siç thamë më herët, kur pranojnë reagime të padëshirueshme, karakteri i tyre i vërtetë del në shesh, befas bëhet edhe luftarak. Duke besuar gabimisht se kanë qenë të nënshtruar ndonjë padrejtësie, përjetojnë gjendje jo të shëndoshë shpirtërore. Kjo prirje është shenjë e dobësisë së tyre. Në thelb, kur ndeshen me diçka të padëshirueshme, arroganca e tyre bëhet evidente dhe fillojnë të përjetojnë një lloj “çmëndurie”.

Ata që fshehin arrogancën e tyre dhe deklarohen si të pastër, për një kohë të shkurtër mund të arrijnë të fshehin krenarinë nga të tjerët, por Allahu me siguri e di dhe e bënë të njohur atë që është e fshehur në zemrat e tyre. Në një ajet thuhet:

**Është e vërtetë se Allahu e di atë që e fshehin dhe atë që e shfaqin haptazi dhe se Ai nuk i do arrogantët. (Nahl, 16: 23)**

Karakteristika më e rëndësishme e përbashkët për të dy grupet është si për arrogantët, si ata me arrogancë të fshehur, i pret fundi i pashmangshëm: xhehenemi. Kurani na informon për fundin e atyre që janë kryelartë, si për ata që e shfaqin haptazi si ata fshehurazi, dhe ata që janë shumë kryelartë për ta adhuruar Allahun. Një nga ajetet në këtë temë është edhe ky :

**Andaj, hyni në dyert e xhehenemit, aty do të jeni përjetë: sa vend i keq është ai i kryelartëve!” (Nahl, 16: 29)**

# SHEMBUJT E ARROGANCËS NË KURAN



## Udhëheqësi i arrogantëve: shejtani

**A**rroganca e shejtanit, për shkak të cilit ka dalë nga mëshira dhe mirësia e Allahut, tregohet në Kuran si mësim për njerëzimin. Siç thamë edhe në parathënien e këtij libri, Allahu krijoi Ademin (as) dhe i urdhëroi engjëjt që të i përkulen atij. Ata iu nënshtruan urdhrin të Allahut, përveç Iblisit, që ishte njëri prej xhinëve. Ai pretendonte të jetë më superior sesa njeriu, dhe shkeli urdhrin e Allahut me arrogancë. Për këtë shkak, ai është privuar nga mirësia e Allahut.

Shkaku që mospërfillja e Iblisit ndaj fjalëve të Allahut tregohet në Kuran, si në vijim:

(Allahu) Tha: “Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?” Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!” (A’raf, 7:12)

Pretendimi i të qenit qenie më e lartë, Iblisi refuzoi që t’i bëj sexhde një njeriu. Sidoqoftë, ky pretendim nuk ka bazë. Ai tentonte për të argumentuar duke thënë se ai ishte i krijuar nga

zjarri, e njeriu nga balta, duke thënë se zjarri është më superior se balta. Me fjalë të tjera, baza e vetme e arrogancës së tij është thjeshtë ndryshimi përbërjes fizike të dy substancave. Megjithatë, pa varësisht nga natyra- si balta ashtu edhe zjarri- dmth si njeriu ashtu edhe Iblisi janë qenie të krijuara nga Allahu. Mos nënshtrimi i Krijuesit të vetëm, në llogari të argumentit të tillë është krejtësisht i pakuptimtë dhe shenjë e madhe mosmirënjohje.

Përveç kësaj, një shqyrtim në bazën e argumentimit të Iblisit do të zbulonte qartë natyrën e gabuar të supozimit të tij. Zjarri mund të jetë më e ndritshme dhe më joshës për syrin, por edhe balta është e pasur me minerale dhe substanca tjera. Ajo përmban të gjitha format e materialeve të çmuara dhe margaritarëve. Veçse me vullnetin e Allahut, dheu as nuk kalbet e as nuk shpërbëhet lehtë. Por, kjo nuk është veti e zjarrit, pasi që mund të fiket për një moment. Përveç kësaj, dheu ka bile edhe një veti superiore, e fikë zjarrin.

Sido që të jetë, pa marrë parasysh shkakun, askush nuk guxon që të vë në pyetje urdhrin e Allahut. Megjithatë, arroganca e tepruar e Iblisit e ka penguar që të kuptojë fuqinë e Allahut, Krijuesin e të gjitha krijesave. Prandaj, ai nuk arriti të kuptoj Allahun siç duhet. Si pasojë, një dallim i parëndësishëm fizik ishte i mjaftueshëm që ta devijoj nga rruga. Ky mashtrim që ka rrjedhur nga arroganca ka shpie të rebelohet kundër Krijuesit të vetes, edhe pse ishte në praninë e Allahut, dhe ishte dikush që kishte dijeni të plotë për bukuritë e xhenetit dhe dënimit të xhehenemit:

**Përkujto kur Ne u thamë engjëjve: “Bëni sexhde Ademit!” (në shenjë përshëndetjeje) e ata i bënë, me përjashtim të Iblisit. Ai tha: “A t’i bëj sexhde atij që e krijove nga balta?” (Isra, 17:61)**



Deklarata e fundit e Iblisit në ajet jep të kuptuar se sa e madhe është arroganca e tij. Lartësimi i njeriut nga Allahu dhe ulja e pozitës së Iblisit e bile edhe kërkesa e Allahut që ai (Iblisi) të i përulet njeriut- zbulon krenarinë e tij të tepruar, që deri atëherë ishte e fshehur. Mungesa e vetëdijes për mendjen e tillë e ka shpie në humbje duke mos vlerësuar drejt Allahun. Si rrjedhojë e kësaj psikologjie, ai është sjellë me jo-ndershmëri dhe fodullëk ndaj Allahut (Allahu sigurisht që është larg kësaj). Përgjigje për këtë sjellje, Allahu e thotë me sa vijon:

**(Zoti) Tha: “O Iblis, çka të pengoi ty t’i përulësh atij që Unë vetë e krijova? A bëre kryeneçësi, apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?” (Sad, 38:75)**

Sjellja e tillë e shejtanit dhe përpjekja e tij për t’u lartësuar dështoi. Allahu e përuli atë si mësim për ata që e pasojnë rrugën e tij të pandershme- duke e larguar nga xheneti:

**(Allahu) Tha: “Dil nga ai (Xheneti), i urryer, i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur Xhehenemin me të gjithë ju. (A’raf, 7:18)**

Siç e bëjnë të qartë këto ajete, gabimi më i madh i shejtanit ishte që të arrihet konkludimi i gabuar dhe vënia e tyre në praktikë. Ky arsyetim i gabuar është njëri ndër vetitë themelore të të gjithë atyre që shkojnë pas gjurmëve të shejtanit dhe bëhen arrogantë të djallosur”. Ndikimet e dëmshme të krenarisë së një personi janë paraqitur në mosbindjen e hapur të shejtanit, dhe atyre që e pasojnë atë, ndaj Krijuesit, Allahut të Plotfuqishëm. Duke vazhduar me pikëpamje të ngushta në gjëra, duke vlerësuar çdo gjë nga perspektiva e vet, bën që dikush të privohet nga mendjehollësia. Pikëpamja e tillë bën që personi të ketë prirje për të marrë dhe interpretuar gjërat gabimisht.

## Ngacmimi i shejtanit

Për shkak të arsytimit të tij të paarsyeshëm, shejtani sheh njeriun si shakatarin kryesor për turpërimin e tij. Prandaj, ai ka pyetur Allahun që për një kohë të caktuar të ketë mundësi që ta largoj nga rruga e drejtë njeriun dhe në këtë mënyrë të i hakmerret. Qëllimi i tij është që të largoj njeriun nga rruga e drejtë, dhe kështu, ta bëj të pabindur ndaj Allahut. Krenaria e tij lëndohet nëse e sheh se njeriu është lartësuar më shumë se ai, ndërsa vetë i poshtëruar. Tregimi për shejtanin paraqitet në Kuran në këtë mënyrë:

**(Allahu) Tha: “Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?”**

**Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!”**

**(Allahu) Tha: “Zbrit nga ai (Xhenneti), nuk të takon të bësh kryelartësi në të, dil jashtë, s’ka dyshim ti je i poshtëruar”.**

**(Iblisi) Tha: “Më afatizo gjer ditën kur ringjallen (njerëzit)!”.**

**(Allahu) Tha: “Ti je i Afatizuar!”**

**(Iblisi) Tha: “Për shkak se më humbe mua, unë do t’u ulem atyre (do t’u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë. Mandej, do t’ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falënderohen (të besojnë)!” (A’raf, 7:12-17)**

Si pasojë e këtij zotimi, Iblisi nisi luftën kundër njeriut. Brenda kohës që i është dhuruar, ai mundohet t’i vë në dispozicion të gjitha mjetet që ta parandalojë njeriun që mos të pasojë rrugën e Allahut, dhe duke i bërë që ta pasojnë atë. Në

të vërtetë, Kurani na informon se shumë e pasojnë shejtanin dhe në këtë mënyrë janë rënë në fund të fundit. Që nga atëherë, Iblisi u ka humbur udhën shumë njerëz dhe i ka vënë në anën e tij. Përveç njerëzve, ai gjithashtu ka bërë pasues edhe në mesin e xhinëve.

Këta xhinë dhe njerëz të cilët e pasojnë Iblisin kanë veti të njëjta si “shejtani”. (fjala shejtan rrjedh nga fjala arabe “shatana” që do të thotë “i larguar”, është atribut i çdo keqbërësi i cili është arrogant ndaj Allahut, dhe në këtë mënyrë i larguar nga mëshira e Tij). Këta xhinë dhe njerëz pasojnë gjurmët e Iblisit, dhe qëllimi i tyre është që t’i largojnë njerëzit nga rruga e drejtë, ashtu siç edhe vetë janë larguar nga rruga për shkak të arrogancës së tyre. Kjo edhe tregohet në Kuran:

**Dhe kështu (sikurse edhe ty) çdo peygamberi i bëmë armiq disa nga njerëzit dhe nga xhinët e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxit njëritjetrin në mashtrime. E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin atë (armiqësi), po ti lëri ata me ato trillime. Dhe që të anojnë (te ato fjalë mashtruese) zemrat e atyre që nuk besojnë botën e ardhshme dhe që të kënaqen e ngarkohen me atë që janë duke u ngarkuar (ty nuk të dëmtojnë asgjë). (En’am, 6: 112-113)**

Arroganca e shejtanit është shenjë e qartë që dallohet tek ata që e kanë humbur rrugën për shkak të tij dhe ekspozohen si ai. Arroganca është sikur vulë apo nënshkrim i shejtanit, dhe vulos ata që e pasojnë. Siç thamë edhe më parë, kjo sëmundje e shejtanit, i cili është dëbuar nga Allahu për shkak të arrogancës së tij, bart me vete rrezikun për vdekje për njeriun. Kjo është për shkak se shejtani, me qëllim që ta afrojë njeriun sa më afër dhe për ta bërë pasues besnik, përpiket në radhë të

parë që të i infektojë njerëzit me arrogancë. Njeriu i kapluar me këtë sëmundje nga arroganca humb ndërgjegjen dhe urtësinë. Arroganca ngurtëson zemrën. Për këtë shkak, ndryshe nga joshja e shejtanit, besimtarët porositen të jenë modestë:

**... Zoti juaj është një Zot, andaj vetëm Atij dorëzohuni, e përgëzo të dëgjueshmit. (Haxh, 22:34)**

Ndikimet e shejtanit mund të shfaqen në forma të ndryshme. Siç dihet, në vend që të angazhohet në atë që Allahu i ka dhuruar, duke iu afruar dhe shfaqur mirënjohjen Atij, shejtani shtiret mendjemadh. Duke mos marr në konsideratë mundësinë që Allahu mund ta zvogëlojë rëndësinë e tij kur të dojë, ai çon kokën kundër urdhrin të Allahut. Në të vërtetë, pasuesit e shejtanit përpiqen që të shfaqin këtë veti në shumë mënyra.. Për shembull, edhe pse dikush mund të bëjë një shërbim të Allahut, ai duhet ta konsiderojë këtë si rast i dhënë nga Zoti për të fituar kënaqësinë e Tij. Përndryshe, duke besuar se mund të arrihet sukses nga përpjeka vetanake, pa urdhrin e Allahut, bile duke u mburrur, është lajthitje. Pasi, atribuomi i vetes për sukses, dhe mburrja me këtë është karakteristikë tipike e shejtanit. Kështu edhe Karuni, i cili besonte se pasuria e tij ishte rezultat i punës së tij, mburrej ... **“Më është dhënë vetëm në saje të dijes sime!”**... (Kasas, 28:78) është një shembull i tipik i të dënuarit ashpër nga Allahu për ligësitë e tij. Profeti Muhamed (saas), gjithashtu, u tha besimtarëve që mos të bëhen mendjemëdhenj:

*Allahu më ka shpallur se duhet të jeni të përulur, askush të mos i mburret jetrit, ose të shtyp tjetrin. (Muslimi)*

Njeriu duhet të mbaj në mend se shejtani i afrohet me dinakëri, pa paralajmërim. Atij nuk i ngutet. Duke përsëritur dhe me këmbëngulje, gradualisht mashtron njerëzit, metode që është dëshmuar e suksesshme për afat të gjatë. Nëse nuk i kushton kujdes kësaj metode dinake të shejtanit, efekti rritet me kohë. Për shembull, nëse dikush përjeton ndonjë sukses të vogël, shejtani menjëherë shikon të përfitoj rastin për ta provokuar. Pëshpëritjet e shejtanit në kokën e tij në fillim nuk duket të jenë arrogancë e mirëfilltë. Personi i tillë, për shembull, nuk thotë haptasi: “Unë jam ai që e kam kryer këtë punë.” Por shejtani aplikon një strategji mashtruese, duke depërtuar gradualisht thellë në zemër. Nëse njeriu nuk mund ta kuptojë se sukcesi i tij nuk i takon askuj tjetër, por vetëm Allahut, me kohë, do të filloj të mbështetet vetëm në aftësitë e tij dhe të mendoj se është i pavarur nga Allahu. Nëse kjo ndjenje shndërrohet në gjendje e përhershme shpirtërore, mendjemadhësia bëhet pjesë e karakterit të tij. I tilli aplikon një ligj të brendshëm dhe bën atë që e konsideron të drejtë, e sheh veten më të mirë dhe më të mençur se kushdo tjetër. Zëri i brendshëm bëhet çdo herë më i zëshëm duke e bërë të duket më superior. Personi i infektuar në këtë mënyrë vuan shpirtërisht. Me kohë, zemra e tij ftohet dhe bëhet çdo herë e më shumë i pandjeshm ndaj argumenteve të Allahut. Në të vërtetë, Kurani tregon se vetëm ata që nuk janë humbur besojnë drejtë në argumentet e Allahut:

**Argumentet tona, i besojnë, në të vërtetë, ata që kur këshillohen me to, bien në fytyra (bëjnë sexhde), që madhërojnë Zotin e tyre në shenjë falënderimi dhe ata nuk bëjnë kryelartësi. (Sexhde, 32:15)**

## Fundi i atyre që pasojnë shejtanin

Shejtani ushtron ndikim të veçantë tek arrogantët. Atyre që u mungon besimi dhe urtësia për të kuptuar fuqinë e Allahut -ata që përbëjnë “shumicën e popullit,” siç referohet në Kuran-pasojnë rrugën e shejtanit, bashkohen me hordhitë e pasuesve të tij. Një ajet thotë:

**Ata i ka nënshtuar djalli dhe ua ka qitur në harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri e djallit, e dinë se ithtarët e djallit janë më të dëshpëruarit. (Muxhadele, 58:19)**

Në botën tjetër, ata që janë në anën e shejtanit, pa dyshim, do të jenë më të poshtëruarit. Ata do të dërgohen në Xhehennem, madje, shejtani edhe do t'i braktisë. Në atë moment, do të kuptojnë se shejtani, ka dhënë premtime boshe, dhe se fjalët e tij ishin vetëm mashtruese. Por, atëherë do të jetë shumë vonë, pasi që zjarri është duke i pritur, dhe është duke u realizuar premtimi i shejtanit:

**E pasi të kryhet çështja (të hyjnë ata të xhenetit dhe të xhehenemit në të, xhehenemlinjve) djalli (u mban ligjëratën e shëmtuar), dhe u thotë: “Vërtet, Allahu iu pat premtuar premtim të vërtetë, e unë ju pata premtuar dhe, qe, nuk zbatova premtimin ndaj jush. Po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’iu detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgjigjët; atëherë, pra mos më qortoni mua, por qortoni veten. Unë nuk mund t’iu shpëtoj juve, e as ju nuk mund të më shpëtoni mua. Unë mohoj shoqërimin tuaj që më bëtë mua më parë (më adhuroat në vend të Zotit)”. S’ka dyshim, jobesimtarët kanë dënim të dhembshëm. (Ibrahim, 14:22)**

# FARAONI



**F** Faraoni është përmendur shpesh në Kuran si një nga ata që u bënë arrogantë ndaj Allahut. Sido që të jetë, nëse faraoni merret vetëm si shembull i veçantë, kjo bëhet për shkak të mosnjohjes së kuptimit më të gjerë të çështjes. Është e rëndësishme të dihet se tregimi i faraonit në Kuran, përveç informacionit për jetën e tij, tregon edhe për “karakterin” e faraonit të njohur në kohën tonë. Të njohur apo jo, historia e ka parë shumë njerëz që kanë karakterin e faraonit. Faktikisht, shumica janë të njohur me këtë karakter. Ata që ishin të njohur për arrogancën e tyre iu ka pëlqyer faraoni. Kurani tregon për faraonin dhe populli i tij me sa vijon:

**Ashtu siç ishte traditë e popullit të faraonit dhe atyre që kishin qenë më parë, që i konsideronin të rreme faktet e Zotit të tyre, e Ne për këto të këqija të tyre i shkatërruam, e popullin e faraonit (edhe faraonin) e fundosëm, por të gjithë këta ishin dëmtues të vetes së tyre. (Enfal, 8:54)**

Tipar i përbashkët i karakterit të faraonit dhe popujve tjerë që u zhdukën para tij është arroganca. Arroganca që

zuri vend në zemrat e tyre i pengoi që ta pranojnë dhe ta dëgjojnë të dërguarit e Allahut. Refuzimi i tyre vetëm i bëri të dënohen si në këtë edhe në botën tjetër. Duke e studiuar më tutje natyrën e arrogancës së faraonit, dhe duke ditur për popujt nga Kurani se janë zhdukur për shkak të arrogancës së tyre, dhe lidhshmëria e tyre me ditët tona, do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë rëndësinë e çështjes. Qëndrimi i faraonit dhe popullit të tij ndaj të dërguarit e Allahut ishte i përbashkët për të gjithë popujt e degjeneruar. Arroganca e tyre arriti deri në atë masë sa që edhe kishin guxuar që të tallen me të dërguarin dhe me librin e Allahut. Kjo tregohet në ajetet e mëposhtme:

**Ne e patëm dërguar Musain me argumentet tona te faraoni dhe rrethi i tij, e ai tha: “Unë jam i dërguari i Zotit të gjithësisë!” E kur u solli ai argumentet Tona, ata u tallën me to. (Zuhruf, 43:46-47)**

Njëri nga tiparet dallues të faraonit ishte, siç është rasti me udhëheqësin e tij, shejtanin, lidhshmërinë e fortë dhe të pandashme me gjërat e kësaj bote. Për shkak të këtij mentaliteti të shtrembëruar, nuk arriti të bëjë një vlerësim racional të ngjarjeve që i ndodhnin, dhe në këtë mënyrë, nuk mundi të kuptojnë superioritetin e Musait. Sipas tij, vlerat e kësaj bote, si pasuria, pushteti, paratë etj., ishin kriteret për identifikimin e superioritetit të dikujt. Ky arsyetim të dobët i faraonit është përshkruar në Kuran si vijon:

**Ndërsa, faraoni thirri popullin e vet e tha: “O popull imi, a nuk është imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?” Pra, unë jam më i mirë se ky qyqar që mëzi flet! Përse nuk i janë vënë atij bylyzykë nga ari, ose të kenë ardhur bashkë me të engjëjt shoqërues? (Zuhruf, 43:51-53)**



Allahu na tërheq vëmendjen nga ajetet e mësipërme për çështjet si më poshtë:

1. Sipas faraonit, përmasa e superioritetit nuk varet nga frika e Allahut, por posedimi i pasurisë dhe bollëkut. Bujaria gjithashtu konsiderohej e rëndësishme.

2. Të mos kuptuarit se vendimi gjendet vetëm tek Allahu, qëndrimi i Musait si i dërguar i Allahut lëndonte krenarinë e tij.

3. Ai përbuzi Musain (as), i dukej i neveritshëm, dhe përmend mënyrën e tij të të folurit, si një shenjë të inferioritetit. Duke u përqendruar në jo-përsosmërinë e njerëzve është i dukshëm sjellje e mendjemadhit.

4. Faraoni mendonte se të dërguarin duhej ta shoqëronin engjëjt, apo posedimi i pasurisë dhe pushtetit, që, sipas tij, ishin simbole të autoritetit.

## **Faraoni u përpoq ta lartësoj veten para Musait (as)**

Një bisedë në mes të Musait (as) dhe faraonit, është cituar në Kuran si vijon:

**Shkoni dhe faraonit thoni: “Ne jemi të dërguar nga Zoti i të gjitha botëve. T’i lejosh beni israilët të vijnë me ne!”**  
**Ai (faraoni) tha: “A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate. Dhe ti e bërë atë punën tënde që e bërë, pra ti je mohues (i të mirave që t’i bëmë). (Musai) Tha: “E bëra atë, atëherë kur isha i pavetëdijshëm. (Shuara, 26: 16-20)**

Në ajetet e mësipërme, një formë tjetër e arrogancës së faraonit është vënë në dukje. Kur është ftuar që të i bindet urdhrave të Allahut, fshihej pas metodave qesharake. Fyerja

ishte njëra prej tyre. Duke i thënë Musait (as) se ai ishte rritur në pallat, faraoni tentoi të përkujton besnikërinë që ia kishte borxh. Madje, u përpoq ta detyroj duke përmendur vrasjen e paqëllimshme të një burri egjiptian, kur nuk ka qenë profet. Kësisoj, në mënyrë qesharake qëllimisht mundohej ta poshtëroj Musain (as) dhe të lartësoj veten para tij dhe njerëzve të tij.

### **Tentimi i faraonit për të vrarë Musa (as) për shkak të arrogancës:**

**Faraoni tha: “Më lini mua ta mbys Musain, e ia le të thërrasë Zotin e vet, pse unë kam frikë se po ua ndryshon fenë tuaj, ose po nxit trazira në vend!” Musai tha: “Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj që të më mbrojë prej çdo kryeneçi, që nuk i beson ditës së përgjegjesisë!” (Gafir, 40:26-27)**

Faraoni ishte aq arrogant saqë, vetëm vrasja e Musait (as) do ta qetësonte. Ky qëndrim ishte gjithashtu edhe revoltë kundër Allahut. I vetëdijshëm për cilësitë e mira të Musait, u bë xheloz, dhe vrasjen e tij e pa si të vetmen mënyrë për të ruajtur autoritetin e tij mbi popullin e Egjiptit. Gjatë ballafaqimit me paturpësitë e faraonit, Musa (as) është përmbajtur në mënyrë të pashembullt, vazhdimisht duke kërkuar strehim tek Allahu.

Ajeti i sipër-përmendur gjithashtu na tërheq vëmendjen tek mosbesimi i faraonit në Ditën e Gjykimit. Mosbesimi në librat e zbritur nga Allahu dhe Ditën e Gjykimit, të shpallur nga të dërguarit e Allahut, është edhe një argument për paturpësinë dhe arrogancën e dikujt. Sido qoftë, arrogantët dënimin më të madh do ta kenë në botën tjetër, si faraoni.

## Pohimi i faraonit se është zot

E faraoni tha: “O Haman, ndërto ma një pirc, e ndoshta do t’i gjejë rrugët. Rrugët e qiejve, e ta shoh Zotin e Musait, pse unë mendoj se ai është rrenës”. Dhe ashtu, faraonit iu dukë e mirë vepra e tij e keqe dhe u shmang prej rrugës së drejtë, kështu që parashikimet e faraonit ishin të asgjësuar. (Gafir, 40:36-37)

E faraoni tha: “O ju pari, unë nuk njoh zot tjetër për ju pos meje...” (Kasas, 28:38)

Atë që faraoni tha në ajetet e mësipërme, duke shtuar edhe mënyrën se si luftonte me Allahun, ilustron mirë pacipësinë e tij. Madje, nuk besonte dhe mohonte se Allahu është i vetmi Zot i tokës dhe qiejve dhe gjithçka që ekziston në mes. Ai mbante mendimin e gabuar, sepse po ta pranonte ekzistencën e Allahut do të anulohet pushteti dhe autoriteti i tij. Kjo ishte arsyeja pse ai u përpoq të kundërshtoj ekzistencën e Allahut. Sidoqoftë, Allahu na informon në suren Gafir, se pikëpamjet e faraonit vetëm se e kanë shpie në vuajtje. Ndonëse, deri atëherë, kur ai do të ndeshet me vuajtje, faraoni mbajti arrogancë e tij dhe pretendimin e tij se është hyjni. Madje detyroi dhe kërcënoi njerëzit e tij, e edhe Musain (as), për t’i bindur me këtë pohim:

**(Faraoni) Tha: “E cili është ai zot i botëve (që ju dërgoi)?”**

**Ai i tha: “Zoti i qiejve dhe i tokës dhe ç’ka ndërmjet tyre, nëse bindeni!”** Ai (faraoni) atyre që ishin përreth, u tha:

**“A nuk e dëgjoni?!”** Ai (Musai) tha: **“Zoti juaj dhe i prindërve tuaj të parë!”** (Faraoni) Tha: **“Vërtet, i dërguari juaj që u është dërguar juve, me siguri është i çmendur!”**

**(Musai) Tha: “Zot i lindjes dhe i perëndimit dhe ç’ka**

**ndërmjet tyre, po që se kuptoni!”.** (Faraoni) Tha: **“Nëse ti**

**beson zot tjetër pos meje, do të gjendesh në mesin e të burgosurve!” (Shu’ara, 26:23-29)**

Këto ajete i bëjnë joserioze pohimet e faraonit si hyjni dhe luftën e tij me Allahun. Faraoni i pari parashtroi pyetjen për Allahun, që kishte qëllim të keq. Arroganca e tij e kishte pushtuar aq shumë sa që ishte i vendosur me çdo kusht ta refuzojë përgjigjen Musait. Ai këmbëngulte në mohimin e fuqisë së Allahut, pavarësisht argumenteve që dëshmonin. mesazhin e Allahut, të transmetuar nga Musai (as), Faraoni iu përgjigj me kërcënimet dhe sharje, ai ishte i zemëruar për të dëgjuar se Allahu është Zoti i të gjithë njerëzve, si në të kaluarën ashtu dhe sot. Kryeneçësia e tij e shpiu atë për të akuzuar të dërguarin si të marrë. Për shkak të mungesës urtësisë, që është një cilësi të veçantë vetëm për besimtarët, ai zihej me Musain (as), por, nuk i binte ndërmend një fakt i rëndësishëm: se Allahu ishte mbrojtës i Musait (as), Poseduesi i vetëm i çdo gjëje, duke përfshirë atë (faraonin), si dhe të gjitha që ai kishte.

### **Arroganca bëri që Faraoni t’i mohojnë mrekullitë**

Pasi së pari dëgjoji për mesazhin e Allahut, të transmetuar nëpërmjet Pejgamberit Musa (as), faraoni i kërkoi të sjellë një mrekulli. Faraoni, i cili besonte në aftësitë e magjistarëve të tij, donte që Musai (as) të përballej me magjistarët, pasi ishte i sigurt në fitoren e tij. Sipas tij, një ballafaqim i suksesshëm do të përforconte autoritetin e tij. Megjithatë, punët e magjistarëve ishin thjesht magji, që para mrekullive të Pejgamberit Musa ishin të pavlefshme. Në këtë mënyrë, faraoni pësoi disfatë. Prandaj, në vend që ta pranoj në heshtje

dhe të udhëzohet në rrugë të drejtë, u bë edhe më mendjemadh.

Duke përjetuar mrekullinë e bërë nga Musai (as), magjistarët përqaftuan besimin dhe filluan të besojnë në Zotin e Musait (as). Prapëseprapë, zgjedhja e tyre nuk ndikoi fare në zemrën e hekurt të faraonit. Përkundrazi, ai vendosi ta përdor forcën:

**E magjistarët u hodhën (u përulën) në sexhde. Dhe thanë: “Ne i besuam Zotit të gjithësisë, Zotit të Musait dhe të Harunit!” E faraoni tha: “I besuat atij (Musait) para se t’iu lejoja unë? Kjo është një dredhi që ju e përgatitët në qytet (Misir) për t’i dëbuar prej tij banorët e tij (kibtët), po më vonë do ta kuptoni (çka do t’iu gjejë). Kam për t’ua prerë duart dhe këmbët tërthorazi, pastaj të gjithë juve do t’iu gozhdoj. (A’raf, 7:120-124)**

### **Mësimi i marrë nga përfundimi i faraonit**

Faraoni ishte një nga njerëzit më të pacipë në histori. Ai pasoi gjurmët e djallit, dhe ishte dënuar me një poshtërim të paparë për atë që bëri. Aq i shëmtuar ishte ky poshtërim sa që, jo vetëm që e humbi dinjitetin para popullit të tij, por u bë mësim për të gjithë njerëzit e të gjitha moshave. Mësimi i marrë nga përfundimi i faraonit është treguar në Kuran si vijon:

**Ne i kapërcyem beni israilët përtej detit, e faraoni dhe ushtria e tij i ndoqi mizorisht dhe armiqësisht derisa e përfshiu atë përmbysja, e ai tha: “Besova se nuk ka Zot tjetër pos Atij që i besuan beni israilët, edhe unë jam nga muslimanët!” Ti tani beson, ndërsa ma parë kundërshtove dhe ishe njëri prej shkatërruesve! Sot po**

**të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje. Vërtet, ekziston një shumicë njerëzish që nuk hulumtojnë argumentet Tona. (Junus 10, 90-92)**

Në çastin e vdekjes, faraoni u pendua, por prapëseprapë, pendimi i tij ishte pa dobi. Ai vazhdoi me arrogancë dhe mohim edhe pse u përball me fakte dhe ishte dëshmitar i një mrekullie të madhe. Ishte mendjemadhësia i tij dhe ndjenja e superioritetit që krijoi një natyrë të tillë dhe ndjente keqardhje vetëm në momentin e vdekjes së tij, edhe pse nuk e shpëtoi.

Këtu, një çështje veçanërisht meriton të përmendet. Arroganca ishte arsyeja kryesore tek mohimi i faraonit. Ai insistonte në refuzim, jo pse ai nuk arriti të sheh ose të kuptojnë shenjat e besimit, por për shkak se lëndonte ndjenjën e tij të krenarisë. Pranimi i sinqeritetit të Musait (as) dhe përqaftimit të besimit nga magjistarët e tij ka qenë një argument i madh për të. Mrekullitë e kryera nga Musa (as) ishin gjithashtu argumente shumë të qarta. Çdokush që përjeton mrekulli të atillë normalisht do të besonte Allahun. Sidoqoftë, faraonit i ka munguar gjykimi të shëndoshë, pasi krenaria e tij e madhe kishte mjegulluar mendjen e tij. Konvertimi i magjistarëve në fenë e Musait nuk bëri që ai të vriste mendjen për gjendjen e jashtëzakonshme me të cilën ishte ndeshur. Tërë ajo që ai mund të mendonte ishte se magjistarët e kishte pranuar besimin e pa iu dhënë ai leje. Aftësia e faraonit për të gjykuar ishte mjegulluar shumë nga krenaria e tij. Për këtë arsye ai këmbënguli në refuzimin, deri sa nuk i erdh vdekja.

Ajo që e shpiu faraonin në mosbesim vlen për çdo

mosbesimtar. Arsyeja e refuzimit të tyre është krenaria e tyre e madhe. Në Kuran, Allahu përshkruan këta njerëz kështu:

**E kur u erdhën argumentet Tona të qarta, ata thanë: “Kjo pa dyshim është magji!” Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se shin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjmadhësi, pra shikoje se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve (Neml, 27:13-14)**

## **Faraoni do t’i udhëheq njerëzit e tij në Ditën e Gjykimit**

Faraoni humbi pasurinë e tij dhe të gjitha begatitë që i kishte gëzuar në këtë botë. Madje, do të dënohet edhe në jetën e pastajme. Ai humbi kopshtet, lumenjtë, pronat e bukura, të lashtat, shkurtimisht, çdo gjë me të cilën ai mburrej. Si ilustron rasti i faraonit, se pa marrë parasysh sa i pasur ose i fuqishëm dikush mund të jetë, Allahu mund t’ia marr pasurinë e tij në çdo çast.

Për dikë me paturpësi dhe arrogancë tillë, dënimi i xhehenemit do të jetë i tmerrshëm. Gjithashtu, edhe ata që i ndjekin krerët që kanë karakter të ngjashëm me të faraonit, si dhe nuk e përkujtojnë Zotin, do të ndëshkohen. Në ditën e kiametit, atyre që i pasuan në gjurmët e faraonit do të sillen me udhëheqësit e tyre para Zotit do të përgjigjen për veprat e bëra në këtë botë. Në të vërtetë, me atë që faraoni dhe pasuesit e tij do të ndeshen në ditën e gjykimit tregohet në Kuran si vijon:

**Ne e patëm dërguar Musain me dispozitat tona dhe me mrekulli konkrete, te faraoni dhe rrethi i tij, e ata iu bindën urdhrin të faraonit, po urdhri i faraonit nuk ishte**

mençuri. Në ditën e kiametit ai (faraoni) i prinë popullit të vet dhe i fut në zjarr. Sa i shëmtuar është ai vend i ofruar. Edhe në këtë botë ata i përcolli mallkimi, e edhe në ditën e kiametit. Sa e keqe është ajo dhuratë e dhuruar. (Hud,11: 96-99)

Siç thamë më parë, do të ishte gabim të supozohet se këto cilësi janë të veçanta për faraonin. Të gjithë duhet të kenë frikë që mos jepen pas kësaj natyre njerëzore, dhe të jetë i syçelë të mos përfundoj në atë mënyrë. Ata me natyrë të tillë duhet të kenë ë mendje fundin e faraonit, dhe me çdo mënyrë duhet shmangur dënimit të ngjashëm.

Ekziston edhe pikë që meriton të përmendet, jo vetëm arroganca e faraonit por të gjitha format e arrogancës, janë të këqija. Për shkak se arroganca pengon diturinë, dhe krenaria mund të arrijë përmasa të rrezikshme pa i vënë re. Para së gjithash, siç e bëjnë të qartë shumë ajete të Kurani, arroganca është cilësi me të cilën Allahu nuk është i kënaqur. Për këtë arsye besimtarët duhet të orvaten që të qëndrojnë larg arrogancës me gjithë forcën e tyre, dhe nuk duhet lejuar që epshi t'i bëj që të mburren. Duhet çdo herë të kemi në mendje se nëse lejohet edhe gabimi më i vogël nga epshi mund të shkaktohet humbje të madhe. Dikush mundet që, pa e ditur, të pasionohet, duke besuar në superioritetin e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tij. Në të vërtetë, faraoni, të cilit i ishte rrënjosur thellë krenaria, u kaplua nga një obsesion i tillë. Kjo tregohet kështu në Kuran:

**... Faraoni tha: "Unë nuk kam mendim tjetër t'ju japë pos atij që ju thashë dhe nuk jam duke ju udhëzuar tjetër pos në rrugën e drejtë!" (Gafir, 40:29)**



Ajetin e cituar më lart shumë mirë ilustron kuptimin e shtrembëruar të faraonit për vetveten. Ai tentonte që popullin e vet ta largoj nga udha e drejtë. Ai ishte aq i sigurt në veten e tij sa që kurrë nuk i shkonte mendja që të dyshonte në këtë.

Kjo tendencë është e zakonshme për të gjithë arrogantët. Kryelartit kanë besim të plotë në vete dhe shpesh janë këmbëngulës dhe refuzojnë mundësinë që tjerët të dinjë më mirë se ata. Sidomos, nuk tolerojnë njerëzit e zgjedhur të Allahut, të pajisur me cilësi të larta. Njerëzit që pretendojnë të jenë shumë të mençur duhet të nxjerrë mësim nga tregimi mbi faraonin. Derisa ka ende kohë, njeriu duhet të ketë në konsideratë pamaturinë e faraonit, dhe të mos shkoj gjurmëve të faraonit, por të kërkon falje prej Allahut.

# KARUNI



**Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: “Mos u kreno aq fortë sepse Allahu nuk i do të shfrenuarit!” (Kasas, 28:76)**

Siç thuhet në ajetin e mësipërm, thesaret dhe statusi që Karuni kishte në Egjipt e bënë atë në njeri arrogant dhe të sillet vrazhdë ndaj popullit të vet. Për ta sprovuar, Allahu e begatoi me pasuri të jashtëzakonshme, siç është rasti me të gjithë arrogantët, dhe ai ishte u prish nga ajo (pasuria). Ai harroi se e gjithë pasuria i takon Allahut, dhe se Ai mund ta marrë kur të dëshiroj, dhe nuk arriti të mësoj se këto i ishin dhënë si sprovë. Për shkak të arrogancës, mendonte se i ishte dhënë për shkak të “diturisë” dhe cilësive të tij të larta:

**Ai (Karuni) tha: “Më është dhënë vetëm në saje të dijes sime!” Po a nuk e di ai se Allahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë asish që ishte edhe më i fuqishëm e më i pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për fajet e tyre. (Kasas, 28:78)**

Ky është një botëkuptim i gabuar i arrogantëve. Edhe pse Allahu i jep njeriut të gjitha që ka, arrogantët mburren me pasurinë e tyre dhe nuk shprehin mirënjohje ndaj Allahut, ose të kërkojnë falje prej Tij. Ata nuk e çajnë kokën bile të mendojnë, bile as për një sekond, se mund ta humbasin gjithë këto begati në një çast të vetëm. Sido që të jetë, siç e kuptojmë nga ky ajet, shumë njerëz, që ishin më të pasur apo më të fuqishëm se Karuni, u zhdukën për shkak të arrogancë së tyre. Si ata të tjerët nga e kaluara, edhe Karuni u dënua në këtë botë. Po të kishte qenë aq i fortë, ashtu siç ai vetë pretendonte, do të shpëtonte veten. Megjithatë, as statusi i tij e as pasuria, as njerëzit që e lakmonin, e as njohura me të cilën ai mburrej, nuk mundën të shpëtonin nga dënimi i Allahut:

**Po Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç Allahut nuk pati që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet. E ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, filluan të thonë: "A nuk shihni se Allahu me të vërtetë i jep begati e komoditet atij që do nga robërit e vet, e edhe ia mungon atë atij që do, e sikur Allahu të mos bënte mëshirë ndaj nesh, do të na sharronte në tokë edhe neve; sa habi, se si jobesimtarët nuk gjejnë shpëtim!" (Kasas, 28: 81-82)**

# HAMANI



**S** iç kuptojmë nga Kurani, Hamani ishte njëri nga njerëzit më të afërt të faraonit, që i bindeshin dhe vepruan në pajtim me metodologjinë e tij. Duke qenë i vrazhdë dhe këmbëngulës, mbajti anën e faraonit dhe mbeti përkrahës besnik i tij. Kur Musa (as) erdhi tek populli i tij për të iu transmetuar porosinë e Allahut, Hamani ishte aty për ta kundërshtuar së bashku me faraonin:

**Ne e kemi pas dërguar Musain me argumente e fakte të qarta, te Faraoni dhe te Hamani e Karuni, e ata i thanë: “Magjistar e gënjeshtar!” Kur ua solli ai të vërtetën nga ana Jonë, ata thanë: “Mbytni djemtë e atyre që i besuan atij, e lini të jetojnë gratë e tyre, por dredhitë e tyre nuk qenë tjetër pos dështim”. (Gafir 40: 23-25)**

Sjellja e pahijshme ndaj Musait (as) u përkrah nga Hamani. Bile, e përkrahte edhe arsyetimin e çuditshëm të faraonit dhe pajtohej me të gjitha mendimet e tij. Ajeti i mëposhtëm tregon, se si faraoni kërkon nga Hamani që të ndërtojë një kullë për të parë të Allahut (natyrisht, Allahu është larg kësaj):

**E faraoni tha: “O ju pari, unë nuk njoh njoh zot tjetër për ju pos meje, andaj ti o Haman, m’i pjek (tullat) nga dheu e më ndërto një kullë të lartë ndoshta do të arrijë ta shoh zotin e Musait, sepse unë mendoj se vërtet ai është gënjeshtar”. (Kasas, 28:38)**

Megjithatë, Hamani, i verbuar nga mendjemadhësia, ishte këmbëngulës dhe refuzonte t’i nënshtrohej Allahut dhe të dërguarit e Tij, dhe pat të njëjtin përfundim si shejtani dhe faraoni. Ai shijoi një përfundim të pashmangshëm i përgatitur për mendjemëdhenjët:

**Edhe Karunin, faronin dhe Hamanin. Atyre Musai u solli fakte por ata treguan mendjemadhësi, ndaj nuk mundën t’i shpëtojnë dënimit. Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet; disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërruam me krismë nga qielli, kurse disa të tjerë i sharrum në tokë dhe disa përmytëm në ujë. Allahu nuk u bëri atyre ndonjë padrejtësi, por ata vetës së tyre i bënë padrejtë. (Ankebut, 29: 39-40)**

# BABAI I PROFETIT IBRAHIM



**B**abai i profetit Ibrahim kishte tipare të përbashkëta me popujt jobesimtarë. Ishte njëri nga ata që u bënë arrogantë ndaj Allahut, dhe këmbëngulte në kundërshtimin ndaj profetit. Mësimet mbi etikën fetare nga djali i tij lëndonin krenarinë e tij. Me fjalë të këndshme dhe të buta profeti Ibrahim transmetonte babait të vet fenë e Allahut dhe kërkoi mënyrat për ta parandaluar nga adhurimi i idhujve. Pavarësisht përpjekjeve të pashoqa të profetit Ibrahim, babai i tij këmbëngulte në injorancën e tij. Ai u largua nga profeti Ibrahim vetëm për shkak se ai besonte Allahun, duke e kërcënuar madje edhe me gurë:

**Përkujtoju në Libër Ibrahimin. Ai vërtet ishte shumë i drejtë dhe pejgamber. Kur babait të vet i tha: “O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e as nuk ke asgjë prej tij? O babai im, mua më është dhënë nga dituria çka ty nuk të është dhënë, andaj më dëgjo se unë të udhëzoj në rrugë të drejtë. O babai im, mos adhuro djallin, sepse djalli është kundërshtar i Mëshiruesit. O babai im, unë kam frikë se do të godet**

**ndonjë dënim prej të Gjithmëshirshmit e do të jesh shok i djallit!" Ai (babai) tha: "A ti, Ibrahim, i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fyeri ndaj zotave të mi), unë do të gurëzoj, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë!" (Merjem, 19: 41-46)**

Këto kërcënime nuk e zbutën Ibrahimin (as); dhe tregoi besnikëri ndaj Allahut, duke mos iu bindur as babait të vet e as popullit të vet që e mohuan peygamberllëkun e tij, dhe i la përfundimisht. Kjo sjellje shembullore të Ibrahim (as) tregohet në Kuran si vijon:

**Vërtet, Ibrahim i ka qenë shembëlltyrë e të mirave, adhurues i Allahut, besimtarë i drejtë dhe nuk ka qenë nga idhujtarët. (Nahl, 16:120)**

**Pastaj, ty të shpallëm: "Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët (as jehudi as i krishterë). (Nahl, 16:123)**

# EBU LEHEBI



**E**bu Lehebi ishte një jobesimtar nga koha e të dërguarit Muhammed (saas) i njohur për arrogancë dhe paturpësi. Kurani tregon se si ai dhe gruaja e tij do të dënohen në Xhehennem për keqbërjet e tyre në këtë botë. Ata do të poshtërohen shumë gjatë dënimit. Bartjen e drurëve, është punë shumë e ligë për ata që lavdërohen me pasurinë dhe kamjen e tyre. Poshtëruese për ta do të jetë gjithashtu edhe litari i përdredhur rreth qafave. Sido që të jetë, Allahu do t'i poshtërojë në mënyrë që ata as që mund ta parashikojnë. Gjendja e tyre në të ardhmen, është si shembull për brezat e më vonëshëm, e tregohet në ajetin si vijon:

**Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar!  
Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! Ai do të  
hyjë në një zjarr të ndezur flakë. E edhe gruaja e tij, ajo që  
barti dru (ferra), E në qafën e saj ajo ka një litar të  
përdredhur. (Mesed, 111:1-5)**



# PRONARI I VRESHTËS



**N**ë suren Kehf, Allahu jep një shembull, të një pronari vreshte, i cili ishte mashtruar me arritjet dhe përparimin e tij. Ky njeri bëhet shembull e asaj arrogance që vjen nga pasuria. Ajetet përkatëse janë më poshtë:

E ti sillu atyre si shembull dy njerëz; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuan me hurma, e në mes atyre dyjave bimë tjera. Të dy kopshtet jepnin frutat e veta pa munguar prej tyre asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedhë një lumë. Ai kishte edhe pasuri tjetër. E ai atij shokut të vet (që ishte besimtar) i tha: - duke iu krenuar atij - "Unë kam pasuri më shumë se ti edhe kam edhe krah më të fortë!" Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetës (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: "Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë!" Dhe nuk besoj se do të ndodhë kijameti, (dita e gjykimit), por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, padyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo. (Kehf, 18:32-36)

Siç përshkruan edhe ajeti, për ta sprovuar, Allahu i dha

pronarit të vreshtës pasuri të bollëshme. Megjithatë, e tërë kjo pasuri vetëm sa e bëri mendjemadh. Në vend që të jetë mirënjohës ndaj Allahut, duke i kërkuar falje prej Tij, dhe për të shpenzuar pasurinë e tij në rrugën e Allahut, foli me krenari dhe gabimisht ia mori mendja se pasuria e tij ishte immune ndaj kohës dhe fatkeqësive.

Ky është shembull i qartë që tregon logjikën e mendjemëdhenjve; edhe pse pronari i vreshtës pretendoi se pasuria e tij ishte e përjetshme, dhe nuk mohoi haptazi ekzistencën e Allahut, dhe duke mos konsideruar mundësinë që pasuria e tij t'i kthehet Allahut. Interesant, pretendonte gabimisht ai nuk do të dënohej, por, në fakt do të shpërblehet nëse me të vërtetë kjo do të ndodhte.

Pretendim i ngjashëm është gjithashtu e zakonshme edhe sot tek mendjemëdhenjtë. Edhe pse nuk e mohojnë haptas e etikën fetare, në zemrat e tyre janë larg nga të paturit frikën e Allahut. Megjithatë, gabimisht supozojnë se ata do disi do të shpëtojnë, edhe në qoftë se “kthehen tek Zoti i tyre.” Shembulli i pronarit të vreshtës, i dhënë në Kuran, tregon qartë se njerëzive të tillë u mungon mençuria. Botëkuptimi i personi të tillë është mjegulluar nga arroganca e tij, dhe pengohet nga të kuptuarit e fuqisë së pafund të Allahut.

Përfundimi i keq që e gjeti pronarin e vreshtës, ashtu si Allahu e tregon në Kuran, është gjithashtu një vërejtje për të pasur kujdes. Ai humbi gjithë pasurinë e tij. Ai edhe tha se “por nëse ...,” por ishte tepër vonë që të jetë i kujdesshëm:

**Dhe vërtet, u shkatërruan frutat e tij, e ai filloi të rrahë shuplakët për atë që kishte shpenzuar në të, e ajo ishte rrënuar në kulmet e saj dhe thoshte: “O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim akë shok!” E nuk pati krah (grup), përveç Allahut të vërtetë që t'i ndihmojë atij dhe nuk mundi ta pengojë.. (Kehf, 18:42-43)**

# KRERËT E POPUJVE



**N** Nga tregimet që Allahu na i jep në Kuran, kuptojmë se ata që mohuan të dërguarit, thellojnë armiqësi ndaj tyre, dhe kundërshtojnë ashpër, janë njerëz të cilët, sipas gjuhës së Kuranit, quhen “krerët e popullit.” Tipari më karakteristik i tyre është arroganca. Një numër i ajeteve zbulojnë këtë fakt:

**Krerët kryelartë nga populli i tij u thanë atyre që ishin më të dobët e që kishin besuar: “A e dini se me të vërtetë Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?” Ata thanë: “Vërtet, ne jemi besimtarë të asaj me çka është dërguar”. Ata kryelartit thanë: “Ne jemi mohues (jobesimtarë) të asaj që ju i besuat”. (A’rafë, 7:75-76)**

**Paria, që ishte kryelartë nga populli i tij, tha: “O Shuajb, ne do të dëbojmë ty dhe së bashku me ty edhe me ata që besuan nga fshati ynë, ose pa tjetër të ktheheni në fenë tonë”. Ai (Shuajbi) tha: “A edhe nëse ne nuk e dëshirojmë atë (kthimin)?” (A’rafë, 7: 88)**

Disa nga këta njerëz u bënë aq arrogantë sa që ata thanë se nuk do të besojnë, derisa të iu shpallet ngjashëm si profetëve:

Dhe ashtu (sikurse në Mekë) në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari, në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetër kë pos veten e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë. E kur u vjen atyre ndonjë argument i prerë (për Muhammedin), ata thonë: “Kursesit nuk e besojmë atë (dërgesën e Muhammedit) derisa të mos na jepet edhe neve ngjajshëm me atë që iu pat dhënë të dërguarve të Allahut”! Më së miri Allahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e vet. Ata që bënë krim do t’i godasë poshtrimi dhe dënimi i fortë te Allahu për shkak se vazhdimisht bënin hile. (En’am, 6:123-124)

Një nga arsyt kryesore prapa këtij mentaliteti është jo-toleranca e tyre ndaj të dërguarve, sepse ishin njerëz të zgjedhur nga Allahu. Ata pretendonin se është degraduese për statusin e tyre, famën, pasurinë dhe nderin për t’i dëgjuar të dërguarit. Për këtë shkak, në të gjitha epokat, qarqet pushtuese të jobesimtarëve kishte parë të dërguarit si kërcënim për rendin e tyre të vendosur, statusin dhe imazhin e tyre në sytë e popullit. Shpallja hyjnore sjellë nga të dërguarit shkaktonte që ata të nxjerrin në pah mburrjen e tyre dhe urrejtjen ndaj të dërguarve.

Në të gjitha epokat historike, “krerët e popujve” janë të referuar si “elitë” e shoqërive. Siç dihet, “elita” është grupi i njerëzve që gëzon status të lartë social ose ekonomik. Siç thamë më herët, tiparet e tilla shkaktojnë mburrje dhe arrogancë tek jobesimtarët që nuk veprojnë me mençuri. Duke pasur pushtet nga kjo mirëqenie dhe status social, ushtrojnë autoritet mbi pjesën tjetër të shoqërisë. Kanë mendim aq të lartë për vete sa që shprehin revoltë ndaj Allahut dhe të dërguarve të Tij. Asnjëherë nuk pranojnë

faktin se epërsia qëndron në afërimin tek Allahu, se sa fuqia ose mirëqenia e tyre. Është kështu, për shkak se, pranimi i kësaj të vërtete mund të anulonte statusin e tyre. Ata janë mendjemëdhenj, tipar që i bën që ta mohojnë Allahun. As nuk e kanë parasysh se, të gjithë njerëzit, të varfër apo të pasur, në fund do të mbështjellët në disa metra qefin, dhe do të mbesin veçse skelet. Pasuritë e tyre të kësaj bote nuk do t'iu bëjnë asnjë dobi në botën tjetër.

Në Kuran, Allahu i njofton besimtarët për vetitë kryesore të këtyre udhëheqësve të popujve, që rrjedhin nga krenaria dhe arroganca- dmth. nga mosbesimi. Në këtë mënyrë, besimtarët e të gjitha moshave i njohin këta njerëz, të cilët kanë prirje për të penguar çështjen e tyre fisnike, dhe kështu, të merren masat e nevojshme për t'u mbrojtur prej tyre. Nga besimtarët pritet që të nxjerrin mësim nga tregimet për ta dhe duhet kenë vëmendje të shtuar që të mos merret ndonjë tipar të ngjashëm i tyre. Askush nuk përjashtohet nga vërejtjet që jepen në Kuran, duke pretenduar të jetë i pavarur; bile besimtarët duhet të vrasin mendjen në domethënien e ajeteve që flasin për jobesimtarët, dhe të përpiqen që t'i largojnë mangësitë karakteristike për jobesimtarët.

Në pjesën e mëposhtme, do të shqyrtohen tiparet kryesore të "elitave" siç tregohet në Kuran.

### **Ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të humbur rrugën popullit të vet**

Paria e popullit nuk lejojnë popullin e tyre që të besojnë në Allahun; e pasi është kështu, ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t'iu humbur rrugën. Përqaftimi i besimit nga njerëzit do të thotë humbja e bazës mbi të cilën ata

ushtrojnë autoritetin e tyre. Para se gjithash, besimi pasqyrohet me shfrytëzimin e kriterëve të kësaj bote për të treguar jo-efekshmërinë e vlerave të rreme. Bile, kështu edhe shoqëria mund të njoh dobësitë e atyre, që ajo i kishte kushtuar rëndësi aq shumë. Përfundimisht, askush nuk do të mbetej për t'i ekzaltuar, e as për t'iu nënshtruar. Është kundër interesave të parisë së popujve humbja e besimit të vartësve të tyre, njerëz që kanë prirje për t'i përbuzur dhe i konsiderojnë si më inferiorë. Dëshirojnë që populli t'i pasojë, pa marrë parasysh pasojat. Për këtë shkak, përdorin çdo metodë, bile edhe kërcënime, nëse nevojitet, për t'i devijuar nga parimet morale dhe mënyrën e jetesës të urdhëruar nga Kurani. Disa nga shembujt lidhur me përpjekjet e tilla të parisë së popujve sigurohen nga Kurani:

**Krerët prej popullit të tij, që nuk besuan, i thanë:  
(Popullit i thanë) Nëse shkoni (pranoni) pas Shuajbit,  
(pas fesë së tij) atëherë ju jeni me siguri të dëshpëruar.  
(A'rafë, 7: 90)**

**E faraoni tha: "I besuat atij (Musait) para se t'ju lejoja unë? Kjo është një dredhi që ju e përgatitët në qytet (Misir) për t'i dëbuar prej tij banorët e tij (kibtët), po më vonë do ta kuptoni (çka do t'ju gjejë). (A'rafë, 7: 123)**

### **Edhe pse e dijnë të vërtetën, e mohojnë**

Çfarë thekson mohimin e krerëve të popujve është arroganca këmbëngulëse, si në rastin e faraonit, dhe jo paaftësia e tyre për të kuptuar. Edhe në qoftë se kuptojnë ekzistencën e Allahut dhe botës tjetër, rezistojnë fuqishëm idenë, duke qenë të pushtuar nga mendjemadhësia. Allahu e

bën të qartë gjendjen e tyre në Kuran: **“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjmadhësi ... (Neml, 27:14)** Siç edhe u tha më parë, pasuria dhe pushtet është arsyeja për mendjemadhësinë e tyre:

**Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga pejgamberët e që pasanikët e tij të mos i thonin: “Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar”. Ata thoshin: “Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e ne nuk do të jemi të ndëshkuar”. Thuaj: “Allahu ia shumon begatinë atij që do, e edhe ia pakëson, por shumica e njerëzve nuk e dinë”. (Sebe’, 34: 34-36)**

Sido që të jetë, pasuria, fëmijët apo kamja nuk kanë dobi për atë që kërkon kënaqësinë e Allahut. Vetëm në qoftë se këto begati i përdor në rrugën e Allahut mund të pres shpërblimin e asaj bote:

**Nuk është as pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar. (Sebe’, 34: 37)**

## **Ndjekin gjurmët e të parëve të tyre**

Ata që të ngazëllesh me pasurinë e paraardhësve të tyre lavdërohen padrejtësisht duke mos iu mbajtur misionit të të dërguarit për të iu shmangur fesë së të parëve të tyre:

**E kur u lexohen atyre ajetet tona të qarta, ata thoshin: “Ky nuk është tjetër vetëm se njeri, i cili dëshiron t’iu shmangë nga ajo që adhuronin prindërit tuaj” (Sebe’, 34: 43)**

Refren tjetër i përbashkët për të arrogantët është se e mbajnë “fenë e gjyshërve”. Atyre u duket se feja e etërve dhe të prindërve të tyre është ajo e drejta. Këtë pa dyshim e thotë vetëm një shpirt kundërshtimi që rrjedh nga arroganca. Duke pretenduar prejardhjen, traditat dhe trashëgiminë kulturore të tyre si më e mira, nuk pranojnë të dërguarin edhe pse është në të gjitha aspektet më i mençur se ata. Ky është gabim i përbashkët për këta njerëz:

**Jo, por ata thanë: “Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fé dhe vazhdojmë gjurmëve të tyre”. Ja pra, Ne nuk kemi dërguar para teje pejgamber në ndonjë vendbanim, që të mos i ketë thënë paria e begatshme e tij: “Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fé dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre”. Ai tha: “A edhe nëse ju kam sjell rrugë më të mirë nga ajo që i gjetët të parët tuaj?” Ata thanë: “Ne nuk i besojmë asaj me çka ju jeni dërguar!” (Zuhruf, 43: 23-24)**

## **Nuk iu përmbahen librit të Allahut**

Arrogantët nuk janë të gatshëm për t’iu përmbajtur librit të Allahut. Dëshira zjarrtë e tyre për të qenë superior ndaj tjerëve pasqyron këtë tendencë. Ata janë aq të sigurt në vetvete saqë kurrë nuk ua merr mendja që mund të jenë në rrugë të gabuar. Gabimisht mbahen se, në qoftë se ka rrugë të drejtë, është ajo që e pasojnë:

**E ata që nuk besuan, atyre që besuan u thanë: “Sikur të ishte ai (Kurani - feja) ndonjë e mirë, ata nuk do ta përqaфонin para nesh!” E derisa nuk drejtohen me të (Kuranin), ata do të thonë: “Ky është trillim i kahershëm”. (Ahkaf, 46: 11)**



## Nuk i dëgjojnë të dërguarit

Allahu ka dërguar popujve të botës profetët të cilët kishin tipare të përsosura morale, ishin inteligjentë dhe mendjehollë. Ishin të zgjedhur nga Allahu dhe ishin të pajisur posaçërisht me urtësi. Një ajet thotë: “Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurve këtë nuk e kupton kush.” (Bekare, 2: 269)

Këta njerëz janë më të mirët në besim, dituri dhe urtësi, dhe besimtarët i çmojnë shumë. Paria e korruptuar e popujve, në anën tjetër, me arrogancë kundërshtojnë të dërguarit, edhe pse janë më të besueshëm dhe të shquar në popull. Bile, ata edhe i fyenin, iu thonin fjalë të këqia kundër nderit të tyre dhe tipareve të tyre të çmuara, madje edhe duke vënë kurthe dhe komplete për vrasjen e tyre. Këto gjëra i bënin nga thellësia e prishur e arrogancës në zemrat e tyre. Kjo krenari i pengonte që të dëgjonin të dërguarit e Allahut dhe bënte që të mohonin të vërtetën:

**A nuk jeni të njohur me lajmin (ndodhinë) e atyre që ishin para jush, si populli i Nuhut, i Adit, i Themudit e edhe i atyre që erdhën pas tyre, që nuk di kush për ta pos Allahut. Atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me argumente, ata i vënin duart e tyre (në shenjë talljeje) në gojë e veta dhe thonin: “Ne e mohojmë atë me çka jeni të dërguar dhe ne dyshojmë shumë në atë që ju na thërrisni”. (Ibrahim, 14: 9)**

Kurani gjithashtu tregon se si këta udhëheqës të popujve u përgjigjen profetëve dhe sa të prishura janë mendimet e tyre kur thirren për në të vërtetën:

E paria e atij populli që nuk besuan thanë: “Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju. Po të dëshironte Allahu do të dërgonte engjëj; ne një gjë të tillë nuk e kemi dëgjuar as nga të parët tanë!” (Mu’minun, 23:24)

Edhe paria nga populli i tij e cila nuk besoi dhe e mohoi jetën tjetër dhe të cilëve Ne u patëm mundësuar rehati e begati në jetën e kësaj bote, thanë: “Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, ha ashtu si hani ju dhe pi ashtu si pini ju!” (Mu’minun, 23: 33)

Krerët e popujve kërkonin nga të dërguarit që të bëjnë mrekulli. Fakti që të dërguarit bënëin atë që Allahu kishte zgjedhur, dhe shkalla e tyre e lartë në urtësi, dituri, moral, mirësi, dhe natyrë shpirtërore, lëndonte krenarinë e tyre. Pasi që nuk ishin të prirur për të pranuar këtë realitet, akuzonin të dërguarit pse janë thjesht njerëz të zakonshëm dhe kërkonin nga ata që të kryenin mrekullira për të vërtetuar të kundërtën. Tiparet e zakonshme të njeriut që profetët kishin si, të ngrënit, të pirët dhe kështu me radhë, i befasonte. Bile, e bënëin edhe si pretekst mosbesimi. Në të vërtetë, edhe kryerja e ndonjë mrekullie nuk do të kishte ndihmuar që këta kokëfortë që të besojnë:

**Ata thanë: “Me çfarëdo argumenti të na vijshë që me te të na magjepsesh (largosh nga feja që kemi), ne nuk do të besojmë ty”. (A’rafë, 7:132)**

Ajo që trazonte parinë e popujve ishte fakti se, pavarësisht nga pushteti, respekti dhe autoriteti që kishin, një njeri, i cili nuk ishte prej tyre, bile edhe që gjykonte sistemin e tyre, ishte pranuar nga pjesa tjetër e shoqërisë, duke përhapur porositë e fesë. Ata e morën këtë gjë

krejtësisht si sulm personal dhe kurrë nuk pranonin pozitën më të lartë të profetëve. Këtë e morën si shkak personal dhe qëndruan në armiqësinë e tyre ndaj të të dërguarit (saas), dhe dëshironin që dikush nga ta të ketë qenë profet. Ata thanë:

**Pastaj thanë: “Përse të mos i ketë zbritur ky Kuran një njeriu të madh nga dy qytete?” (Zuhruf, 43:31)**

Si përgjigje të kësaj dëshire krerëve, Allahu thotë në vijim:

**A thua ata e përcaktojnë mëshirën (pejgamberllëkun) e Zotit tënd... (Zuhruf, 43:32)**

Përmes metodave të ndryshme, përpiqeshin që të dëmtojnë të dërguarit

**Rrethi i parisë nga populli i faraonit tha: “Ky nuk është tjetër pos magjistar i përsosur”. (A’rafë, 7:109)**

**Të parët nga populli i faraonit thanë: “A do të lejosh Musain dhe popullin e tij të bëj përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu?” Ai (faraoni) tha: “Do t’ua mbysim djemtë e do t’i lëmë të gjalla gratë e tyre për shërbim, ne jemi dominues mbi ta”. (A’rafë, 7:127)**

Siç përshekruan qartë ajeti, si faraoni, ashtu dhe paria e popullit të tij silleshin me përbuzje. Në fakt, ata ishin që nxitën dhunë tek faraoni. Duke akuzuar rrejshëm, për magji dhe çoroditje, përpiqeshin që të bëjnë faraonin edhe më të vrazhdë ndaj Musa (as) dhe pasuesve të tij, dhe imponojë metoda edhe më mizore ndaj tyre.

E paria e jobsimtarëve është e njohur për sjelljet e tyre të pacipa ndaj të dërguarëve, të cilët shkatërruan mu në themel regjimet e tyre të rreme. Qëndrimi i pretenduar i tyre ndaj të dërguarëve ishte me të vëretë fyes. Ja disa shembuj më poshtë:

**Paria nga populli i tij tha: “Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur!” (A’rafë, 7:60)**

**Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: “Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtetë rrenacakë!” (A’rafë, 7:66)**

Urtësia ishte vetia më e shquar e të dërguarve që Allahu i dërgoi për njerëzimin. Në të vërtetë, duke njohur Allahun ashtu siç duhet, duke kuptuar qëllimin esencën e fesë, dhe të jetuarit me të, kërkon urtësi. Prandaj, akuzat për “mendjelehtësi”, që jobesimtarët kishin ngritur kundër të dërguarve ishin thjesht nga xhelozia që ndjenin ndaj tyre, dhe dëshirës për të qetësuar komplekset e tyre të superioritetit. Qëllim tjetër ishte edhe për të ndikuar negativisht njerëzit që i pasonin. Duke vepruar në këtë mënyrë, megjithatë, kanë treguar se mendjelehtët e vërtetë janë vetë ata.

### **Në grackat e tyre janë ra vetë**

Siç edhe u diskutua, sjelljet e paturpshme, guximi dhe pacipësia e parisë së jobesimtarëve kanë qënë të pranishme në të gjitha epokat. Sidoqoftë, përfundimi i tyre i përgjigjet ligësisë së tyre; dredhia e thurur nga kjo pari e vrazhdët gjithmonë në fund kthehet kundër tyre. Ligji i pandryshueshëm që Allahu përcaktoi për njerëzimin është përshkruar si më poshtë:

**... nëse u vjen atyre ndonjë pejgamber, do të jenë më të udhëzuarit (më besimtarët) nga njeri i atyre popujve (jahudi ose i krishterë), e kur u erdh atyre pejgamberi,**

atyre nuk u shtoi tjetër vetëm se largim. (Largim) Për shkak të mendjemadhësisë dhe dredhisë së keqe, por dredhia e keqe nuk godit tjetër vetëm ata që kurdisën. Pra ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm gjurmët e të parëve, e në ligjin e Allahut kurrë nuk do të hasësh devijim. (Fatir, 35:42-43)

# POPUJT JOBESIMTARË



**S** iç u tha më parë, paria e pabindur dhe zemërlige e popujve jobesimtarë gjenden në secilën shoqëri gjatë tërë historisë. Duke u bërë arrogantë, refuzuan të dërguarit e Allahut, që ishin dërguar për t'i turrur ata në rrugë të drejtë. Megjithatë, para se të vuajnë dënimin në Xhehennem, kanë përjetuar vuajtje të rënda edhe në këtë botë.

Në këtë pjesë të librit do të shqyrtojmë popuj për të cilët na tregon Kurani, dhe shohim se si iu kishin përgjigjur të dërguarve të tyre përkatës.

## **Populli i Nuhit (as)**

Paria e popullit të Nuhit (as) ishte tepër krenare, siç është rasti me shumë popuj gjatë historisë. Kur Nuhu (as) i ftoi në fenë e Allahut, shumë pak njerëz e pasuan. Megjithatë, Nuhu (as) asnjëherë nuk e humbi shpresën për t'i shpëtuar nga dënimi i botës së përtejme. Por, përkundër të gjitha përpjekjeve, populli i vet i ishte përgjigjur në këtë mënyrë:

**Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: “Ne nuk të shohim**

**ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasojë kush, përveç atyre që janë më të poshtërit e më mendjehelit nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtar!” (Hud,11:27)**

Tek këta njerëz, ku në gjuhën e tyre shfaqej krenaria, fyenin edhe besimtarët që pasonin Nuhin (as). Pasiqë, sipas mendimit të tyre të gabuar, superioriteti varej nga pasuria, kamja, pasardhësit, pozita dhe grada. Këto cilësi i shikonin tek besimtarët që pasonin Nuhin (as). Megjithatë, ata nuk kuptonin shkallën e lartë të fituar kur arrihet afërsia e Allahut dhe morali i lartë:

**Ata thanë: “O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, sillnie pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!” (Hud, 11:32)**

**Populli i Nuhut që ishte para tyre përgënjeshtroi, dhe robin Tonë (Nuhun) e quajti rrenacak dhe thanë: “I marrë!” dhe iu bë kërcënim. (Kamer, 54:9)**

Nuhi (as) kishte duruar këtë sjellje të tmerrshme dhe kryente detyrën e tij duke ftuar në të vërtetën me sinqeritet. Megjithatë, kur u bë e qartë se nuk ishte e mundur që ata të përmirësohen, iu drejtua Allahut për ndihmë:

**Ai tha:“O Zoti im, unë e thirra popullin tim natën e ditën. Por thirrja ime vetëm ua shtoi ikjen. Dhe sa herë që unë i thërritja ata për t’u falur Ti mëkatet, ata i vënin gishtat e tyre në veshë dhe e mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë. Pastaj, unë i kam thirrur ata haptazi. Pastaj unë thirrjen ua drejtoja atyre haptazi, e shumë herë edhe fshehurazi”. (Nuh, 71:5-9)**

Nuhu tha: “Zoti im, ata më kundërshtuan, ata shkuan pas atyre (paskanikëve), të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre vetëm ua shtuan dëshpërimin. Dhe ata (paskanikët) u kurdisën atyre kurthe shumë të mëdha”. Dhe u thanë: Mos braktisni zotat tuaj kurrsesi, mos braktisni Vedda-në, as Suvva-në, e Jeguth-in, Jeukë-n e Nesre-n. Dhe ata i bënë të humbur shumë sish, e Ti zullumqarëve mos u jep tjetër, por vetëm humbje!... E Nuhu tha: “O Zoti im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët! (Nuh, 71: 21-24, 26)

Allahu iu përgjigj lutjes së Nuhut; arroganca dhe refuzimi i tyre i kushtoi me jetë popullit të Nuhut. E në botën tjetër, nga ana tjetër, vuajtjet edhe më të mëdha janë duke i pritur:

**Për shkak të mëkateve të tyre ata u përmbytën dhe menjëherë u futën në zjarr dhe ata, përveç Allahut, nuk gjetën ndihmëtarë. (Nuh, 71: 25)**

## **Populli i Adit**

Allahu dërgoi Hudin, si i dërguari i Tij për popullin e Adit. Ai i thirri në rrugën e Allahut, por ata iu përgjigjën me fyerje. Arroganca e popullit të Adit tregohet në Kuran si vijon:

**Sa i përket Adit, ata pa pasur kurrfarë të drejte, u treguan mendjemëdhenj ndaj banorëve në tokë dhe thanë: “Kush ka fuqi më të fortë se ne?” A nuk e ditën ata se Allahu, i cili i krijoi ka fuqi më të fortë se ata?! Ata mohuan argumentet tona. (Fussilet, 41:15)**

Krenaria e tillë para Allahut është shkallë më të lartë e çoroditjes; ku ata morën guxim aq të madh si askush tjetër. Ata kishin një mendim aq të lartë për fuqinë e tyre sa që edhe zgjuarsia e tyre dukej e shëmtuar, sepse nuk arritën dot të



kuptojnë edhe argumentet më të qarta. Me fuqinë e dhënë nga Allahu, dhe duke pasur mundësi që Ai mund ta merrte përsëri kur të donte, ata kundërshtonin Allahun dhe të dërguarin e Tij. Si 'kompensim' do të jenë të mallkuar si në këtë botë ashtu dhe në ditën e gjykimit:

**E ata ishin Adët, që mohuan argumentet e Zotit të tyre, kundërshtuan të dërguarin e Tij, shkuan pas urdhërit të çdo tirani kryelartë. Ata u përcollën me mallkim si në këtë botë, ashtu edhe në ditën e gjykimit. Le të dihet, Adët mohuan Zotin e tyre. Qoftë i shkatërruar Adi, populli i Hudit! (Hud, 11: 59-60)**

## **Themudi**

Allahu dërgoi Salihun tek populli i Themudit si të dërguarin e Tij. Si të gjithë të dërguarit tjerë, edhe profeti Salih e thirri popullin e tij në të vërtetën, dhe ua përkujtonte atyre faktin se ishin të krijuar, ashtu që ta mernin vesh të vërtetën. Megjithatë, populli i tij i mbeti besnik zakoneve të vjetra. Kjo tregohet në Kuran:

**Themudi përgënjeshtroi të dërguarit. E thamë: "A të shkojmë pas një të vetmit njeri që doli nga mesi ynë, po Ne atëherë do të jemi të humbur në një marrëzi!" A, atij nga mesi jonë iu dha shpallja? Jo, por ai është një gënjeshtar mendjemadh. (Kamer, 54: 23-25)**

Me sa duket, paraqitja e profetit si njeri ishte një nga arsyetimet për mos udhëzimin e tyre. Persiatja e mangët e tyre bënte që duhej të i nënshtrohen vetëm një qenie mbinatyrore, një engjëlli për shembull, apo dikujt që mund të bënte mrekullira. Arroganca tepër e madhe që i kishte pushtuar, i

pengonte për të iu bindur dhe dëgjuar ndonjë qenie njerëzore. Për këtë shkak ata flisnin keq për të dërguarit, dhe i akuzuan si gënjeshtarë.

## **Beni israilët**

Nga një lexim më i kujdesshëm i Kuranit zbulohet se beni izrailët, duke mos qenë mirënjohës për begatitë dhe bekimet që Allahu shpesh përmend në librin e Tij, kanë qenë të mbajtur mend si njerëzit më të pacipë në histori. Duke marrë parasysh se kishin jetuar në një periudhë të veçantë të historisë, është e habitshme se sa kryelartë dhe kokëfortë u bënë, pavarësisht mëshirës dhe faljes që iu dha Allahu.

Siç dihet, Allahu u dha besni israilëve, shumë begati, dhe i bëri më superior ndaj popujve tjerë. E ata, përkundër kësaj, Ai vetëm u kërkoi që “të përmbushej zotimi i Tij.” Megjithatë, në vend se të tregohet besnikëri e sinqertë dhe nënshtrim ndaj Allahut, ata nuk iu nënshtruan urdhrave të Zotit të tyre, duke dëmtuar veten me tejkalimin e kufijtëve e Allahut:

**... E kjo që t’u zbrit ty nga Zoti yt do të shtojë te shumica prej tyre rezistencë e mohim... (Maide, 5:68)**

**... Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi dhe urrejtje që do t’u vazhdojë deri në ditën e kijametit. Sa herë që ndezën zjarr për luftë, Allahu e shuajti atë, e ata përpiqen për shkatërrime në tokë. Allahu nuk i do ngatërrestarët. (Maide, 5:64)**

Allahu zbulon në Kuran se Ai sprovoi këta njerëz shumë herë, si me begati ashtu edhe me vështirësi. Siç dihet, beni israilët ishin në robëri. Për shkak të sundimit tiranik të faraonit, ky popull ishte dënuar me robëri për shekuj të tërë. Sistemi qeverisës i faraonit ishte jashtëzakonisht

shtypës. Beni izrailët ishin në kupën e dëshpërimit nën regjimin e Faraonit, i cili, sipas Kuranit, “lente gratë e tyre të jetojnë dhe mbyste bijtë e tyre.” Si rezultat i këtyre vështirësive të tmerrshme, Allahu dërgoi tek ky popull profetin Musa, i cili u prezantoi një mrekulli të madhe “ndarjen e detit,” dhe i shpëtoi nga pushteti mizor i faraonit:

**O bijtë e israilit, përkujtone dhuntinë Time, të cilën ua dhurova, dhe Unë ju pata (të parët tuaj) dalluar ndaj njerëzve të tjerë (të asaj kohe).Përkujtoni edhe kur u shpëtuam prej popullit të faraonit, që nga ai shijuat dënimin më të idhët, duke ua therrur bijtë tuaj, e duke ua lënë gjallë gratë tuaja. Në këtë torturë përjetuat një sprovim të madh nga Zoti juaj. Dhe kur për ju e ndamë detin, e ju shpëtuam, ndërsa ithtarët e faraonit i fundosëm, e ju i shihnit (me sytë tuaj). (Bekare,2: 47, 49, 50)**

Kjo mrekulli, prej së cilës çdokujt që nuk e ka zemrën e ngurtësuar do t'i nënshtrohej Allahut, nuk i bëri ata të kanë frikën Allahut dhe të bëhen të përrulur. Në vend që të forcojnë besimin e tyre, ata shkelën kufijtë e Allahut, kur Musa (as) i kishte lënë për një kohë të shkurtër. Ata madje shkuan deri në atë masë sa që bënë idhull një viç, dhe kështu, treguan prapësi të jashtëzakonshme:

**Juve u pat ardhur Musai me argumente, por pas tij ju e adhuruat viçin, pra ju ishit mizorë. (Përkujtoni) Kur morëm premtimin tuaj dhe mbi ju ngritëm kodrën Tur, (u thamë) merrni këtë që u dhamë seriozisht dhe dëgjoni (respektoni). Ata thanë: “Dëgjuam (me vesh) e kundërshtuam”. E për shkak të mosbesimit të tyre, adhurimi ndaj viçit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre.**

**Thuaj: “Nëse jeni besimtarë, besimi juaj është duke u udhëzuar keq”. (Bekare, 2:92-93)**

Devijimi dhe arroganca që i bëri këta njerëz fajtorë, të treguar në Kuran është mësim për njerëzit, dhe nuk kufizohen vetëm për këtë ngjarje. Ky popull, i cili nuk mundi të jetë mirënjohës për mirësitë e Allahut, janë fajtorë edhe për shumë shembuj të tjerë për pacipësi.

Për shembull, Allahu dhuroi begati popullit të Izraelit ashtu që të jenë mirënjohës. Si mirënjohje për këto begati, Ai vetëm donte që ata të hyjnë në qytet me dhurata dhe të përkulen në shenjë nënshtrimi. Por, ata i bënë vetes padrejtë, dhe kundërshtuan Allahun:

**Dhe Ne bëmë që retë t’u bëjnë juve hije, ju furnizuar me rrëshirë (të ëmbël) dhe me shkurtëza. (Ju thamë) Hani nga të mirat që ju furnizuar! (ata nuk qenë mirënjohës). Po Neve ata nuk na bënë kurrfarë dëmi, por ata dëmtuan vetveten. E kur ju thamë: “Hyni në këtë fshat (vendbanim), dhe hani në të lirisht ku të dëshironi, e hyni në derën (e fshatit) përlurur dhe thuani: “Hittatun” - ndjesë, Ne ua falim mëkatet tuaja, e bamirësve ua shtojmë shpërblimin. E ata që ishin mizorë atë që u ishte thënë e ndryshuan me një fjalë tjetër, e Ne për shkak se ata kundërshtuan, lëshuam nga qielli një dënim kundër atyre që ishin mizorë. (Bekare,2:57-59)**

Një shembull tjetër për ta është dhënë në Kuran duke thënë se nuk mund të durojnë vetëm një lloj të ushqimit, kur atyre u është thënë të hanë dhe pinë nga furnizimi i Allahut. Nuk pajtoheshin me atë që Allahu u kishte dhënë për mrekulli, kërkonin lloje tjera të ushqimit, tregon dëshmi të qartë se ata ishin larg nga të kuptuarit e fesë me të cilëm Allahu është i

kënaqur. Mungesa e mirënjohjes, dhe se si ishin të 'kompensuar' në këtë botë për keqbërjet e tyre, të gjitha tregohen në Kuran:

**Madje kur ju thatë: "O Musa, ne nuk mund të durojmë (hamë) vetëm një ushqim (të njëjtë), lute pra Zotin tënd për ne të na furnizojë me çka mbinë toka prej perimeve të saj, prej trangujve, prej hudhrave, prej thjerrëze (groshë) dhe prej qepëve të saj"! (Musai) Tha: "A kërkonti ta ndërroni të mirën për atë që është me e thjeshtë"? Zdirgjuni pra në qytet, se aty do të keni atë që kërkonti! E mbi ta rëndoi poshtrimi dhe skamja, e ata kundër vetes shkaktuan hidhërimin e Allahut. Kjo ndodhi ngase ata mohonin argumentet e Allahut, mbytnin pejgamberët pa kurrfarë të drejte, dhe për shkak se kundërshtuan dhe i kalonin kufijtë në të keqe. (Bekare, 2:61)**

Formë tjetër e sjelljes jomirënjohëse e beni israilëve ishte kur iu përgjigjen të dërguarit kur iu shpjegoi urdhërat e Allahut. Përgjigjet që dhanë zbuluan krenarinë dhe paciptësinë e tyre:

**(Përkutjoni) Edhe kur Musai popullit të vet i tha: "Allahu ju urdhëron ta therrni një lopë! Ata thanë: "A bën tallje me ne?" Ai tha: "Allahut i mbështetem të më ruaj e të mos bëhem nga injorantët!" (Bekare, 2:67)**

**O popull imi, hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu ua premtoi, dhe mos u ktheni mbrapa, pse atëherë ktheheni të dëshpruar. (Maide, 5:21)**

**Ata thanë: "O Musa, ne kurrë nuk hyjmë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu!" (Maide, 5:24)**

Deklaratat e tilla të guximshme, thënë kundër urdhrit të Allahut, janë mësim për besimtarët. Vërtet, 'kompensimi' për sjelljen e popullit të Musait (as) do të jetë e ashpër botën tjetër. Në Kuran, Allahu na informon për dënimin që do ta marrin, si shpërblim për sjelljen e tyre të mbrapshtë që i shpuri në blasfemi të rëndë:

**E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën vetvetën. Atë që e shpalli Allahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se Allahu nga mirësia e Tij t'i shpallë atij që dëshiron nga robtë e vet. Andaj merituan zemërim mbi zemërim (gazep mbi gazep). Mosbesimtarët kanë dënim që i poshtëron. (Bekare, 2:90)**

Siç e bëjnë të qartë ajetet, arsyeja kryesore e vetme ishte arroganca. Nga xhelozia, kishin mëri profetët, dhe ngurrnin të pranojnë kompetencat e tyre. Shkurtimisht, arsyeja e kryeneçësisë, rezistencës dhe mosmirënjohjes së tyre, ishte arroganca e tyre. Prandaj, do të mbahet mend në histori si popull që vazhdimisht kundërshtonin hapur dhe bezdisnin profetët e tyre. Pa dyshim, kjo sjellje nuk mbetet pa reagim; dhe për shkak se janë shmangur nga rruga e drejtë, janë dënuar me vuajtje të përgjeshme:

Dhe, (rikujto) kur Musai popullit të vet i tha: "O popull imi, pse më shqetësoni kur e dini se me të vërtetë unë jam i dërguar i Allahut te ju!" E kur ata u shmangën (nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre, pse Allahu nuk e vë në rrugë të drejtë popullin e prishur. (Saff, 61:5)

Bijtë e Izraelit nuk u treguan kryelartë vetëm kundër profetit Musa, por për të gjithë të dërguarit e Allahut që u ishin dërguar. Në të vërtetë, ka pasur raste kur arroganca e tyre ka bërë që edhe t'i vrasin të dërguarit e tyre:

... E sa herë që u erdhi ndonjë i dërguar me çka nuk u pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i mbytët? (Bekare, 2:87)

Duke u treguar tepër krenarë dhe të padisiplinuar, beni israilët kundërshtuan gjithashtu edhe Talutin (Saulin), një mbret i emruar si udhëheqës, pak para profetit Davud:

**Pejgamberi i tyre u tha: "Allahu caktoi sundues tuajin Talutin". Ata thanë: "Si mund të jetë ai sundues yni, kur ne kemi më shumë meritë se ai për sundim, madje ai edhe nuk është i pasur? Ai tha: "Allahu e zgjodhi atë sundues tuajin dhe e pajisi me dituri të gjerë e me fuqi trupore!" Allahu ia jep sundimin e vet atij që do, Allahu është dhurues i madh, i dijshtëm. (Bekare, 2:247)**

Vetëm njëra nga mrekullitë që kanë përjetuar beni israilët, do të ishte e mjaftueshme për dikë që të udhëzohet dhe ta ketë frikë Allahun. Megjithatë, edhe pse Allahu ua fali beni israilëve dhe u tregua i Mëshirëshëm disa herë, sillen vrazhdë dhe nxisin çrregullime të mëdha në tokë. Kjo e bën të qartë se Allahu i ka çveshur nga të kuptuarit këtë popull, u ka verbuar sytë dhe shurdhuar veshët, për shkak të keqbërjeve të tyre. Dënimii beni israilëtëve, që do të mbahen mend si populli më i panënshtuar, është theksuar përsëri në Kuran. Ky popull është një mësim për gjithë arrogantët, për shkak të begative që u është dhënë, dhe kërkojnë të shkaktojnë çrregullime në tokë.

## **Populli i të dërguarit Muhammed (saws)**

I dërguari Muhammedi (saws) gjithashtu u ka treguar popullit të tij se ishte i dërguari i Allahut, dhe se duhet ta dëgjojnë:

**Thuaj (Muhammed):** “O ju njerëz! Unë jam i dërgari i Allahut te të gjithë ju. Allahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s’ka të adhuruar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, pasoni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën. (A’rafë, 7:158)

I dërguari Muhammed (saws) thirri popullin e tij në rrugën e Allahut. Megjithatë, reagimi i tyre ishte kësisoji:

**Ata madje thanë:** “(për Kuranin) Ëndërra të përziera, madje thanë se ai (Muhammedi) vet e trilloi, ai është poet! Le të na e sjellë një mrekulli ashtu si u dërguan të mëparëshmit (me mrekulli)!” (Enbija, 21:5)

Ai nuk i dha përgjigje popullit të tij, sepse nuk ishin në gjendje ta kuptojnë mesazhin që e sillte i dërguari. Ishte, në të vërtetë, shenjë e pacipësisë së tyre. Si popujt para tyre, edhe ata mohuan të dërguarin për shkak të krenarisë dhe arrogancës së tyre. Allahu tregon sjelljen e jobesimtarëve në Kuran kështu:

**Për arsye se kur u thuhej atyre:** “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, ata e mbanin veten lart. Dhe thoshin: “A do t’i braktisim ne zotat tanë për një poet të çmendur?” (Saffat, 37: 35-36)

Sikur popujt nga e kaluara, edhe idhujtarët e Mekës gjithashtu nuk e pranuan Muhammedin (saas) si të dërguar, nga mendjemadhësia dhe dëshira për të qenë më superiorë. Ata thonin se i dërguari ishte poet, edhe pse as vetë nuk e besonin. Bile, pretendonin se ai vetë i kishte trilluar gjitha gjërat që i thonte, dhe në këtë mënyrë, e akuzonin për gënjeshtër.



Ngjashmërinë e këtyre shpifjeve me ato të popujve të mëhershëm, tregon se është pjesë e ligjit të pandryshueshëm të Allahut. Por, ekziston edhe një ligj tjetër i pandryshueshëm i Allahut: sipas të cilit, si në këtë botë ashtu edhe në atë të përtejshmën, Allahu poshtëron dhe jep dënim mbi ata që mohojnë dhe bëhen arrogantë ndaj të dërguarëve e Tij...

Ngjashmëria e fjalëve të përdorura nga gjithë popujt gjatë përbaljes me të dërguarit e tyre është jashtëzakonisht e madhe. Një ndryshim kohe prej qindra vjetësh, bile edhe me dallimet kulturore dhe gjeografike, janë të parëndësishme. Jobsimtarët, e të gjitha epokave, të cilët nuk shohin ose injorojnë të vërtetën për shkak të arrogancës së tyre, kanë një tipar karakteristik të përbashkët. Ata ndjekin të njëjtin model dhe aplikojnë taktika shumë të ngjashme. S'ka dyshim se, përfundimi i tyre korrespondon me sjelljen e tyre, dhe përfundimish, do të shpërblehen me dënim nënçmues. Kurani na informon për shumë popuj që kanë ekzistuar, që kanë përjetuar vuajtje edhe para vuajtjes së amshuar në Xhehennem. Populli i Thiketit, Medjenit, Hixhrit, Lutit, dhe As-habi Kehfit janë vetëm disa nga këta popujt. Dhe, shumë popuj tjerë, që kanë ekzistuar në kohë dhe vende të ndryshme, u shkatërruan mu për këtë arsye:

**E sa fshatra që ishin zullumqarë i shkatërruam Ne, e ato janë të rrënuara mbi kulmet e tyre dhe sa bunarë kanë mbetur shkretë e sa pallate të larta! (Haxhxxh, 22:45)**

# MODESTIA E BESIMTARËVE



**S** iç kuptojmë edhe nga ajeti, “Argumentet tona, i besojnë, në të vërtetë, ata që kur këshillohen me to, bien në fytyra (bëjnë sexhde), që madhërojnë Zotin e tyre në shenjë falënderimi dhe ata nuk bëjnë kryelartësi “(Sexhde, 32:15), njëra ndër kushtet më të rëndësishme të besimit është modestia. Prandaj, siç shpjegon ky ajet, besimtarët janë gjithmonë modest, duke qenë të vetëdijshëm se “...Allahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet (Nisa, 4: 36):

**E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: “Paqë!” (Furkan, 25: 63)**

Parimet morale islamike kërkojnë nënshtrim ndaj Allahut, dhe nënshtrimi kërkon njohjen e dobësisë së dikujt. Besimtarët, të cilët pranojnë se çdo gjë i takon Allahut, dhe duke ditur se edhe vetë janë të dobët dhe kanë nevojë për Të, sillen me modesti ndaj robërve tjerë të Allahut. Arroganca është në kundërshtim me besimin, saqë edhe i dërguari i Allahut (savs) u thotë besimtarëve të jenë të përlulur dhe të trajtohen me njëri tjetrin si vëllezër në një hadith:

*Mos ia keni zili njëri-tjetrit, mos fryni çmimet njëri-tjetrit, mos urreni njëri tjetrin, mos u largoni nga njëri-tjetri, dhe mos dëmtoni njëri-tjetrin. O robër të Allahut, o vëllezër. Një musliman është vëlla i një muslimani: ai as nuk e shtyp atë e as mos e le në baltë, ai as nuk qendron tek ai as nuk mbajnë atë në përbufje. Devotshmëria është mu këtu-dhe Pejgamberi (saas) tregoi në gjoks tri herë. Është gjë e keqe për dikë që ta nënçmojë vëllai i tij musliman. (Muslimi)*

Arroganca dhe modestia posaçërisht manifestohen gjatë marrëdhënieve ndërnjerëzore. Sjellja e Iblisit, siç tregohen në Kuran, më së miri e ilustron këtë gjë. Iblisi refuzoi të i bëjë sexhde Ademit (as). Duke qenë i vetëdijshëm për fuqinë e pakufishme të Allahut, ishte e palogjikshme që të pretendoj haptazi superioritet ndaj Allahut. Por, ishte krenaria e tij që ishte lënduar. Ishte Ademi (as) ndaj të cilit tregoi arrogancë, duke shfaqur qëllimin e tij që të mos i bindet Allahut.

Si rrjedhojë, arroganca, që në të vërtetë është, mëkat ndaj Allahut, dhe që manifestohet gjatë marrëdhënieve mes njerëzve.

Gjithashtu, edhe modestia manifestohet në të njëjtat rrethana. Besimtarët shfaqin nënshtrim ndaj Allahut duke u sjellur me modesti ndaj besimtarëve tjerë. Të vetëdijshëm për faktin se nuk janë përgjegjës për krijimin e cilësive të tyre, janë mirënjohës ndaj Allahut, dhe kurrë nuk harrojmë se Allahu mund t'ia u marrë prapë ato në çdo kohë. Duke u frikësuar nga dënimi i Krijuesit të tyre, i Cili është Zotëruesi i fuqisë së pafund, kërkojnë mbështetje vetëm tek Ai. Ky nënshtrim i besimtarëve, dhe frika ndaj Allahut, tregohet në këtë ajet:

**Thuaj: “Është e vërtetë se mua nuk më mbron askush**

**prej (dënimit) të Allahut dhe përveç Tij, unë nuk gjej mbështetje". (Xhinn, 72: 22)**

Për këto arsye, gjendje shpirtërore, sjellja dhe cilësitë fizike të besimtarëve, janë krejtësisht tjera krahasuar me arrogantët. Virtytet e besimtarëve mund të përshkruhen kështu:

### **Të vetëdijshëm se janë të dobët para Allahut**

Arroganti që dëshiron që bukuria, rinia dhe prestigj të mbeten të përjetshme, nuk mund të kuptojnë se vetëm cilësitë e Allahut të Plotfuqishëm janë të përjetshme. Për këtë arsye, marrin guxim që të ngrenë krye ndaj shenjave të qarta Allahut . Besimtarët, në anën tjetër, bëjnë përpjekje serioze që të kenë konsideratë të duhur për madhësinë e Allahut. Është kështu për shkak të kësaj përpjekje, si dhe për shkak dështimeve dhe të metave të qenieve tjera, se ata janë të vetëdijshëm për kufizimet e tyre. Ndryshe nga mosnënshtrimi këmbëngulës i jobesimtarëve, kanë një frikë Allahun, të fshehtës, çdoherë kanë në konsideratë dobësinë e tyre para Zotit:

**Thuaj: "Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do Allahu. Sikur ta dija të fshehtën, do të shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe... (A'rafë, 7:188)**

### **Ata i nuk përshkruajnë Allahut shok**

E nga njerëzit ka asish që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) Allahun, po dashuria e atyre që besuan

**Allahun është shumë më e fortë. E sikur që dinin ata që bënë mizori se kur do ta shohin dënimin (në botën tjetër), do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm Allahut (e jo idhujve) dhe se Allahu është ndëshkues i rreptë. (Bekare, 2: 165)**

Egoja e ulët, tekat, dëshirat, pasuria, pamja apo pasuria e dikujt, janë gjëra që i ngrisin lart më lart se Allahu, njësoj si idhujtarët. Këta njerëz nuk mund të kuptojnë se Allahu është Pronari i çdo gjëje. Arsyeja kryesore për këtë moskuptim është arroganca e tyre.

Besimtarët, në anën tjetër, besojnë “me siguri të plotë” se nuk ka Zot tjetër pos Allahut. Janë të vetëdijshëm se vetëm Allahu mund të japë atyre çdogjë, nëse e kërkojnë. Prandaj, Allahu është kujdestari dhe përkrahësi i vetëm i tyre. Si kundërpërgjigje për mirësitë e panumërta që marrin, me gjithë zemër i nënshtrohen Allahut, shfaqin nënshttrim të plotë ndaj Tij. Besimtarët jetojnë jetën vetëm për hir të Allahut, dhe janë të vetëdijshëm se kjo është mënyra e vetme për ta plotësuar besimin, ashtu siç është trasnmetuar në një hadith të të dërguarit Muhammed (saas):

*Çdokush që do për Allahun, urren për Allahun, jep për Allahun dhe ndalon për Allahun, atëherë ai ka plotësuar besimin e tij. (Ebu Davudi)*

Ky qëndrim i të qenit i nënshtroar i besimtarëve është tërësisht në kundërshtim me atë që pretendohet nga ata që tregojnë “arrogancë faraoni.” Në të vërtetë, arrogantët nuk mund të i kuptojnë kufizimin e tyre. Megjithatë, besimtarët që besojnë në këtë ajet: **“O ju njerëz, ja një shembull veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuronin në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të**

gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi.” (Haxh, 22:73), kurrë nuk mendojnë se cilësitë që kanë janë ekskluzivisht të tyre, dhe kanë parasysh se është Allahu është Ai që ka pushtet mbi çdo gjë.

## I binden të dërguarit të Allahut

**Dhe ata i bëmë shembëlltjërë që udhëzonin sipas urdhërit Tonë, i orientuam në punë të mira, në falljen e namazit, në dhënien e zeqatit, dhe ata ishin adhures Tanë të sinqertë.. (Enbija, 21:73)**

Ashtu si Allahu krijoi njerëzit që t'i ftojnë për në zjarr, Ai gjithashtu krijoi edhe udhëzuesit për në të vërtetën. Tek ata popuj, ku Allahu dërgoi profetët e Tij, Ai urdhëroi që t'i dëgjojnë këta udhëzues, që ftonin në rrugën e drejtë. Megjithatë, siç ishte rasti me popujt e mëhershëm, ashtu siç tregohet në Kuran, shumica prej tyre, dhe sidomos “prijësit” e tyre, kundërshtonin të dërguarit për shkak të arrogancës.

Besimtarët, në anën tjetër, kanë parasysh ajetin, **“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me urdhërin e Allahut t'i bëhet respekt (nga njerëzit) atij...” (Nisa, 4: 64)** dhe t'i dëgjojnë të dërguarit si urdhër i Allahut. Kjo është arsyeja pse dëgjueshmëria ndaj të dërguarëve është manifestim i rëndësishëm i modestisë së dikujt dhe nënshtrim ndaj Allahut. Siç thuhet në ajetin e 9-të të sures Fet'h, besimtarët nderojnë dhe respektojnë të dërguarit, gjatë gjithë jetës së tyre.

## Nuk këmbëngulin në pikëpamje të gabuara

Të vetëdijshëm për dobësitë e tyre para Allahut, dhe të metat që u janë të dhënë qëllimisht në këtë botë, besimtarët nuk i frikësohen nëse bëjnë gabime. Pasja e të metave dhe ceneve nuk ndikojnë fort në ata, pasi që nuk pretendojnë të jenë më të përsosur se të tjerët. Është kështu, për shkak se nuk e kanë qëllimin për të “pasur dhe ruajtur prestigjin e tyre”, por qëllimi i tyre i vetëm është që të jenë robër të Allahut dhe ta fitojnë kënaqësinë e Tij.

Pas bërjes së gabimit, menjëherë pendohen, i kthehen Allahut, dhe shfaqin nënshtrim të sinqertë. Në Kuran, Allahu këshillon besimtarët që të bëjnë dua si mëposhtë:

**... “Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë!  
Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i  
ngarkove ata para nesh! Dhe Zoti ynë, mos na ngarko me  
atë për të cilën nuk kemi fuqi! Na shlyej mëkatet, na i  
mbulo të këqiat, na mëshiro. Ti je Mbrojtësi ynë, na  
ndihmo kundër popullit pabesimtar!. (Bekare, 2: 286)**

Thamë më heret se arrogantët shqetësohen nëse gabojnë ose kanë të meta. Jo vetëm kritika i zemëron, por zakonisht as nuk kanë prirje për t’i pranuar. Megjithatë, besimtarët janë të gatshëm të pranojnë kritika apo nëse kanë bërë gabim, dhe i kthehen Allahut për falje. Dhe kështu, kurrë nuk bëhen mendjemëdhenj, por janë të gatshëm që menjëherë ta pranojnë dështimin e tyre:

**Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar  
ose i bëjnë zullum vetës së tyre, e përmendin Allahun  
dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kushi i falë**

**mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). (Ali Imran, 3:135)**

Ndryshe nga mendjemëdhenjtë, besimtarët ia vëjnë veshin vërejtjeve, sidomos kur shkelin parimet e vëna nga Allahu. Kjo gatishmëri përshkruhet në suren Sexhde, si shenjë e besimit në parimet e Allahut:

**Argumentet tona, i besojnë, në të vërtetë, ata që kur këshillohen me to, bien në fytyra (bëjnë sexhde), që madhërojnë Zotin e tyre në shenjë falënderimi dhe ata nuk bëjnë kryelartësi (Sexhde,32:15)**

### **Nuk ngazëllohen tepër në begatitë e tyre**

Ajo që i largon arrogantët nga rruga e drejtë janë begatitë që Allahu u ka dhënë atyre. Për këtë ata ngazëllohen tepër dhe bëhen padrejtësisht mendjemëdhenj. Megjithatë, besimtarët përpiqen të kenë parime të larta morale, pavarësisht nga rrethanat. Në varfëri apo kamje, nuk largohen nga modestia dhe sjellja e mirë. Allahu i paraqet besimtarët në Kuran si vijon:

**(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. Allahut i takon përfundimi i çështjeve. (Haxh, 22:41)**

Sjellja e Jusufi (as) është shembulli më i mirë besimtarëve me një natyrë të ekuilibruar pavarësisht kushteve. Allahu i dha Jusufit (as) pozitë, përparim dhe dituri, por, i vetëdijshëm se këto i ishin dhënë atij nga vullneti i Allahut, i ishte nënshtruar vetëm Allahut. Lutja e tij qartë tregon modestinë dhe nënshtrimin e tij:



**Zoti im, Ti më ke dhënë mua pushtet, më mësove mua komentimin e ëndërrave; o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestar imi në dynja e në Ahiret, më bën të vdes musliman dhe më bashko me të mirë!” (Jusuf, 12:101)**

## **Nuk lakmojnë këtë botë më shumë, por botën tjetër**

Arrogantët janë lidhur shpirtërisht për këtë botë, thuase nuk do të mbaroj kurrë jeta e tyre. Atyre nuk ua merr mendja se duhet pasur parasysh Allahun dhe Ditën e Gjykimit. Mirëqenia, dukja e mirë, si dhe cilësitë tjera që i gëzojnë, i bëjnë çdo herë e më shumë arrogantë. Megjithatë, besimtarët të vetëdijshëm për natyrën e përkohshme të kësaj bote, më shumë lakmojnë botën e përtejme. Në Kuran, besimtarët e sinqertë janë të përshkruar si më poshtë:

**...ne i pajisëm ata me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës tjetër. (Sad, 38:46)**

Përveç kësaj, besimtarët e kuptojnë edhe arsyen pse ekzistojnë në këtë botë. Janë të vetëdijshëm se janë vënë në sprovë dhe se duhet të angazhohen në kryerjen e sa më shumë veprave të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut. Me shprehje kuranore, ata mund të përshkruhen si **“ata që e japin jetën e kësaj bote për botën tjetër. (Nisa, 4:74)** Me gjithë mirëqenien e dhuruar, dëshirojnë të bëhen robër të devotshëm të Zotit. Siç Pejgamberi (saas) i ka informuar, besimtarët e dinë se Allahu do të ia u zëvendësojë me diçka më të mirë se ajo që lënë pas për hir të Allahut:

*Çdokush që lë diçka për hir të Allahut, atëherë Allahu, i Gjithfuqishmi, do të ia zëvendësojë atë me diçka më të mirë se ajo. (Ahmedi)*

Në suren Teube, besimtarët janë përshkruar si ata që shesin veten dhe pasurinë e tyre për t'u kompensuar më vonë me xhennet:

**Allahu bleu prej besimtarëve shpirtërat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. (Allahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kuran. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzonju tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. (Teube, 9:111)**

### **Askënd nuk e përqeshin**

Përqeshja e të tjerëve është nga ato tiparet e përbashkëta të arrogantëve e që është gjë e qortuar. Megjithatë, besimtarët asnjëherë nuk lëshohem në një gjë të tillë e të ligë. Superioriteti nuk matet me vlerat e kësaj bote, si dukja apo pasuria, por sipas devotshmërisë ndaj Allahut. Dhe, vetëm Allahu i njeh ata që janë më të devotshëm dhe ata që i drejtohen Atij. Madje, në Kuran, Allahu ka thënë se e përçmon talljen, dhe ndalon besimtarët të tallen me të tjerët:

**O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin ...(Huxhurat, 49:11)**

### **Nuk pasojnë hapat e shejtanit**

Në Kuran, Allahu njofton besimtarët për armikun e tyre më të madh, si më poshtë:

**O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e**

**lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji.. (Bekare, 2: 168)**

**O ju të cilët besuat, mos shkoni gjurmëve të djallit, pse kush ndjek gjurmët e djallit ai urdhëron për të shëmtuara e të irituara, ... (Nur, 24: 21)**

Ata që i dëgjojnë joshjen e shejtanit kënaqen në mosnënshtrim ndaj urdhrave Allahut, për shkak të mospërfilljes së tyre dhe ndjenjës së rremë të superioritetit. Përpjekja kryesore e shejtanit është që t'i paraqesë të gjitha adhurimet ndaj Allahut si të vështira dhe të perealizueshme, dhe në këtë mënyrë, të mashtrojë njerëzit në mosnënshtrim si dhe me sjellje dhe qëndrime me të cilat nuk është i kënaqur Allahu. Kjo është metoda primare e shejtanit, edhe pse arrin të joshë vetëm arrogantët dhe ata që dëshirojnë të jenë të veçantë dhe superiorë.

Besimtarët të cilët janë të nënshtruar dhe të vetëpërmbajtur, nga ana tjetër, gjithmonë zbatojnë urdhërat e Allahut. Duke u bazuar në zotimin e dhënë Atij, besimtarët janë grupi i vetëm i njerëzve tek të cilët dredhitë mashtruese nuk mund të ushtrojnë asnjë ndikim. Ata nuk mashtrohen me pretime boshe të shejtanit, por i qendrojnë besnik Kuranit. Sa herë që ndikohen nga ndonjë cytje të shejtanit, ata menjëherë kërkojnë strehim tek Zoti i tyre, mësojnë të vërtetën, dhe kuptojnë se intriga e shejtanit është e kotë. Është kështu, pasi që qëllimi i tyre i vetëm në jetë është për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe botën tjetër. Angazhohen për në rrugë të drejtë, pasi që janë të vetëdijshëm se po të devijonin nga rruga për interesa të kësaj bote vetëm se do ta dëmtonin vetveten.

## **Nuk iu përulen arrogantëve**

Siç thamë në faqet e më larta, shumica e popullit në Egjipt nuk kishin guxim të mjaftueshme për ta pasuar Musa (as), dhe largoheshin nga frika që kishin ndaj faraonit. Vetëm një grup i vogël pasoi Musain (as), dhe kishin vënë në rrezik jetën e tyre, pasi që faraoni urdhëroi që të gjithë mashkujt e posalindur të tyre duhej vvarë. Madje, aq tiran ishte Faraoni sa që, kur magjistarët e tij dëgjuan Musain (as) dhe fituan besimin në Allahun, ai i kërcënoi me prerje të gjymtyrëve dhe pastaj edhe kryqëzim. Besimtarët e vërtetë, megjithatë, pa marrë parasysh të gjitha vështirësitë, nuk mohuan, madje as për një moment, duke pasuar Musain(as):

**Duke pasur frikë nga faraoni dhe nga rrethi i tij se do t'i turturojnë, Musait nuk i besoi kush pos një pjese të pasardhësve të popullit të tij. Vërtet, faraoni ishte mbizotërues në tokë dhe ai ishte prej shkatërrimtarëve. (Junus, 10:83)**

Siç u diskutua, mosbesimi i të tjerëve nuk ka asnjë ndikim tek besimtarët. Përndryshe, ai bile rrit perkushtimin e tyre, për shkak se, Allahu Kuran na informon paraprakisht se vetëm pak njerëz do të besojnë. Përveç kësaj, edhe Kurani e bën të qartë se besimtarët do të sprovohen përmes jobesimtarëve. Pasi është kështu, sado të vështira të jenë metodat rënda të presionit fizik dhe shpirtëror të shkaktuara nga paria e jobesimtarëve, besimtarët kurrë nuk e kanë humbur rrugën e drejtë. Siç thuhet në ajetin në vijim, ata nuk u përulen synimeve tyre të qëllimkëqija:

**E sa pejgamberë pati që së bashku me të luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e**

**Allahut, ata nuk u dobësuan dhe nuk u pëkulën. Allahu i do durimtarët. (Ali Imran, 3:146)**

## **Besimtarët kanë parasysh xhennetin**

Derisa jobesimtarët gëzohen shumë për begatitë e dhënë atyre nga Allahu, besimtarët kanë parasysh se pacipësia dhe mendjemadhësia nuk pëlqehen nga Allahu. Përmes modestisë dhe nënshtrimit të tyre, dëshirojnë ta fitojnë kënaqësinë e Allahut. Për këtë qëllim, sjellen mirë në çdo moment që mundën. Përveç kësaj, nuk bëjnë dallim mes njerëzve, por sillen mirë me të gjithë. Nëse gjenden në një situatë të kundërt, ose në një rrethanë të papëlqyeshme, kjo nuk ndryshon fare këtë qasje, sepse, për besimtarin, kënaqësia e Allahut është ajo që synohet mbi çdo gjë. Të vetëdijshëm se Allahu sheh çdo gjë gjatë gjithë kohës, janë tepër të vëmendshëm. Si shpërblim, u është premtuar xhenneti:

**Ndërsa besimtarëve të ruajtur Xhenneti u afrohet krejt afër. Kjo është ajo që i premtohet për secilin që pendohet dhe që e ruan besën e dhënë. Për secilin që i është frikësuar Zotit pa e parë dhe ka qenë i kthyer te Ai me zemër të sinqertë. (U thuhet) Hyni në te, të shpëtuar, se kjo është dita e përjetshme. (Kaf, 50:31-34)**

## **Fshehtësia e modestisë**

Këto tipare të shumta që gjenden në karakterin e besimtarit, siç përmendet në Kuran, e bëjnë të qartë se modestia është një cilësi që rrjedh nga besimi në Allahun. Ashtu siç i dërguari i Allahut theksoi, modestia është një nga pikëpamjet themelore të Islamit:

*Çdo fe ka virtyt të veçantë, dhe virtyt dallues i Islamit është modestia. (Malik)*

Në fakt, kur Kurani përshkruan modestinë e besimtarëve, përmendet vetëm si pjesë e natyrës së zakonshme të tyre. Me fjalë të tjera, besimtarëve nuk iu nevojitet ndonjë përpjekje e madhe për tu sjellur në mënyrë modeste, pasi që janë modestë natyrshëm dhe pikëpamja e tyre bazohet në të vërtetën e Kuranit.

Ajeti në vazhdim e shpjegon këtë gjë:

**E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqë!" (Furkan, 25:63)**

Ajeti i ardhshëm shpjegon arsyen e kësaj modestie:

**Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen). (Furkan, 25:64)**

Me fjalë të tjera, modestia e besimtarëve është rezultat i nënshtrimit të tyre ndaj Allahut. Fakti që ata kanë kuptuar të fshehtë e kësaj bote, dmth., të kuptuarit e ekzistencës dhe fuqisë së Allahut, tregon për modestinë e tyre.

Si rrjedhojë, modestia e vërtetë që po e diskutojmë në këtë libër mund të arrihet vetëm me anë të besimit. Është e pamundur që të arrihet modestia e vërtetë me mjet tjetër pos besimit. Sepse, në një shoqëri jobesimtare, ata që konsiderohen "modestë" janë, zakonisht, ata që konsiderohen si iu mungon "besimi." Sepse aq shumë i japim rëndësi gjërave të kësaj bote, dhe ata që kanë sukses në arritjen e tyre bëhen mendjemëdhenj, ndërsa ata që nuk mund të arrijnë kesi sukses konsiderohen të dobët dhe të pasigurtë. Prandaj, të pasurit kanë tendencë të jenë kryelartë,

kurse të varfërit konsiderohen të pasigurtë. Megjithatë, duhet të theksojmë se mungesa e “vetëbesimit” është parim që nuk ka të bëjë fare me natyrën e modestisë së vërtetë, që është formë e sjelljes fisnike dhe dinjitoze.

Tregimi i Karunit, siç rrëfëhet në Kuran, është shembull i mirë i asaj që diskutuam më sipër. Përveç Karunin, i cili ishte tepër mendjemadh për pasurinë dhe kamjen e tij, Kurani na informon edhe për ata që dëshironin atë që ai posedonte. Përveç këtyre, një grup tjetër ishin besimtarët e vërtetë që kishin kapur të fshehtë e besimit:

**Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: “Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!”**

**E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: “Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç durimtarëve!”**

**Po Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç Allahut nuk pati që ta mbrojtë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet.**

**E ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, filluan të thonë: “A nuk shihni se Allahu me të vërtetë i jep begati e komoditet atij që do nga robërit e vet, e edhe ia mungon atë atij që do, e sikur Allahu të mos bënte mëshirë ndaj nesh, do të na sharronte në tokë edhe neve; sa habi, se si jobesimtarët nuk gjejnë shpëtim!”**

**Atë, vend të përjetshëm (Xhennetin) u kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në**

**tokë, e përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut. (Kasas, 28:79-83)**

Mund të ishte se ata që lakmonin pasurinë e Karunit nuk ishin aq krenarë edhe sa ai; ose që kanë pasë mungesë “vetëbesimi”. Megjithatë, në qoftë se do të kishin qenë nën lëkurën e tij, edhe ata, me siguri, do të kishin qenë arrogantë si Karuni. Për shkak se, njëjtë si Karuni, nuk mundën të kuptojnë se pronari i vërtetë i çdo gjëje është Allahu. Këtë e kuptuan vetëm kur ishin dëshmitarë të përfundimit të keq të Karunit.

Njerëzit e vërtetë modestë ishin besimtarët që “i u ishte dhënë dituri”, dmth, ata që kishin kuptuar të fshehtë e kësaj jete. Të vetëdijshëm se ajo që kishte Karuni ishte pasuri e përkohshme, dhe në këtë mënyrë, pasuri e parëndësishme, nuk lakmonin pasurinë e tij. Për çdo rast, pasja e një pasurie si e Karunit nuk do ta ndryshonte dinjitetin apo përrultësinë e tyre.

Këta “njerëz të dijshtëm”, siç përmenden në tregimin e Karunit, janë shembuj krahasimi për gjithë muslimanët. Ata tregojnë se modestia e vërtetë mund të arrihet vetëm duke qenë rob i Allahut, dhe se Allahu begaton vetëm robërit e Tij fisnikë. Për shkak se, ata janë “të cilët nuk e lartësojnë veten e tyre ose shkaktojnë trazira në tokë.” Nuk bëhen arrogantë, por ndjehen mirënjohës për të mirat e dhënë atyre”.



# A MUNDET NJË ARROGANT TË JETOJË ENDE SIPAS PARIMEVE FETARE?



**Ë**shtë e qartë që njeriu nuk mund të zhytet në arrogancë dhe në të njëjtën kohë, të pasojë vlerat morale që urdhërohen në Kuran. Për shkak se, parimi më themelor i fesë së Allahut është që të pranoj Allahun zot të vetëm dhe ta ketë në konsideratë fuqinë e Allahut. Arroganti, megjithatë, e konsideron veten si qenie ndaraz dhe të pavarur nga Allahu, dhe kërkon për të kënaqur teket dhe dëshirat e tij. Nëse dështon të kuptojnë se është vetëm rob i Allahut, atëherë madhëron vetveten me atë që Allahu i ka dhënë dhe bëhet arrogant. Me fjalë të tjera, lartëson dhe adhuron veten.

Për këtë shkak arroganca pengon njeriun nga të jetuarit sipas parimeve fetare dhe e shpie kryerjen e një forme të idhujtarisë.

Duke lartësuar dhe adhuruar veten, arrogant i është në kundërshtim me parimin themelor fetar, që nuk ka zot përpos Allahut. Si rrjedhim, pikëpamja e tillë e pengon

arrogantin të jetoj sipas parimeve morale të fesë. Nuk është e habitshme, që arroganti zakonisht nuk ka ndërmend të jetoj jetën sipas parimeve fetare, me përjashtim të një grupi të caktuar të njerëzve, të cilët do të përshkruhen në faqet në vijim. Shumë ajete në Kuran përshkruajnë rezistencën dhe refuzimin që tregon arroganti ndaj parimeve morale fetare:

**Për arsye se kur u thuhej atyre: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, ata e mbanin veten lart. Dhe thoshin: “A do t’i braktisim ne zotat tanë për një poet të çmendur?” (Saffat, 37: 35-36)**

Siç përmend ajeti i mësipërm, dëshira e tyre për të qenë superiorë i pengon për të pranuar Allahut dhe të dërguarit e Tij. Në të vërtetë, arroganca e jobesimtarëve mund të arrijë në atë shkallë sa që edhe marrin guxim për të shfaqur armiqësi të hapur ndaj Allahut. Kurani na informon për mentalitetin e tyre që kanë këta njerëz, kur ftohen për ta përkujtuar Allahun:

**... E kur e përmend ti në Kuran Zotin tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen. (Isra, 17:46)**

Urdhrat e fesë janë të bëra ashtu që të rrënjosen parimet morale tek njeriu që i mundëson të jetë mirënjohës ndaj Zotit të tij, për ta afëruar më afër Tij, dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. E konsideruar kështu, arroganca, është një tipar që është në kundërshtim me thelbin e fesë islame. Është cilësi që nuk e do Allahu:

**Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. (Lukman, 31:18)**

**Është e vërtetë se Allahu e di atë që e fshehin dhe atë që e shfaqin haptazi dhe se Ai nuk i do arrogantët. (Nahl, 16:23)**

Prandaj, të jetohet jeta sipas vlerave morale fetare që është qëllimi kryesor për të fituar kënaqësinë e Allahut, ndërsa kërkimi për të bërë kompromis me arrogancë do të ishte e pamundur dhe një kontradiktë e dukshme. Parimet morale fetare bëjnë thirrje për modesti dhe nënshtrim ndaj Allahut. Arrogantit, megjithatë, i mungon virtyti i një besimtari, dhe në këtë mënyrë, nuk arrin të futet në thellësinë e besimit.

Një shenjë e rëndësishme e modestisë së njeriut është nënshtrimi ndaj Allahut dhe pasimi i të dërguarit të Tij. Fakti që arrogantit nuk mund të tregojnë nënshtrim dhe pasim të sinqertë, edhe një herë, tregon se feja dhe arroganca janë në papajtueshmëri njëra me tjetrën. Arrogantit, nuk do të lejon askë të ushtrojnë pushtet mbi të. Sipas tyre, ata janë më të aftit dhe më të mirët për të marrë vendime. Për shkak se janë aq të sigurt në vetvete, nuk e konsiderojnë mundësinë e ekzistimit të dikujt tjetër që mund të dijë më mirë. Siç dihet, arroganca e fshehur e shejtanit përfundimisht u shfaq ai ishte urdhëruar për të treguar nënshtrim dhe dëgjim. Për shkak të arrogancës së tij, ai nuk u bind urdhërit dhe u bë një nga jobesimtarët. Në Kuran Allahu vë theks të veçantë në nënshtrim dhe dëgjueshmëri dhe përshkruan hollësisht dhe cilën duhet besimtar që ta pranojë. Allahu e definon në Kuran, se dëgjueshmëria është çështje shumë e rëndësishme që fton për nënshtrim me gjithë zemër dhe pajtueshmëri. Pajtueshmëria nga pamja e jashtme me të dërguarin duhet të shoqërohet edhe me nënshtrim të plotë dhe të sinqertë:

**Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht. (Nisa, 4:65)**

Siç u tha më parë, shenjë e rëndësishme e arrogantit është refuzimi i të dërguarve të Allahut. Ata luftuan kundër tyre, pasi që mendonin se dëgjueshmëria e një personi që është i virtytshëm vetëm me parime morale, urtësi dhe besim, i cili është dërguar si udhëheqës për çdo anëtar e asaj shoqërie, lëndonte krenarinë e tyre. Megjithatë, mosbindja ndaj të dërguarëve është mosnënshtrim ndaj Allahut. Dhe, mosnënshtrimi ndaj Allahut, përfundimisht, sjell rënie në fe tek një shoqëri. Në shumë ajete tregohet se bindja ndaj një të dërguari është, në fakt, nënshtrim ndaj Allahut. Në një lexon si vijon:

**Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut, e kush e refuzon, Ne nuk të dërguam roje kundër tyre (Nisa, 4:80)**

Siç shihet qartë në këtë dhe ajete të ngjashme, bindja është e ngjashme me një kala që le jashtë arrogantin nga feja. Vetëm modestia, nënshtrimi dhe përulja mund të i hapë portat e kësaj kështjelle.

Madje, arroganca është sëmundje që njeriut ia topitë të gjitha vlerat morale dhe ia ngurtëson zemrën. Do të thotë se, pavarësisht nga të pasurit e tipareve të papëlqyera, edhe vetitë tjera të karakterit që rrjedhin nga arroganca tërësisht janë në kundërshtim me përsosmërinë morale që porositet në Kuran. Besimtari është bujar, vetëmohues, i durueshëm, i mëshirshëm, i devotshmën, besnik dhe tolerant. Arroganti,

megjithatë, kurrë nuk mund të ketë këto cilësi morale në kuptimin e tyre të vërtetë. Ai është koprrac, egoist, i padurueshëm, i pakujdesur dhe i padrejtë. Sigurisht, karakterin e tij e pengon përmbushja e urdhrave fetare. Në të vërtetë, qëllimi kryesor i parimeve morale është që të ndihmojë njeriun për të arritur parime të shkëlqyeshme morale me të cilat Allahu është i kënaqur.

Çfarë ndodh nëse arrogani pohon se jeton me parimet morale fetare?

Përgjatë këtij libri, kemi theksuar se arrogantit nuk mund të jetë i sinqertë për atë se është duke jetuar me parimet fetare, dhe se karakteri i arrogantit është tërësisht i papajtuësishëm me shembullin e besimit të përshkruar në Kuran. Megjithatë, ka disa që thonë ndryshe, dmth., ka disa “hipokritë”, që kanë të mbjellur arrogancë të madhe në ta, edhe pse pohojnë se jetojnë sipas parimeve morale të Islamit. Ky pohim nuk ka qenë i pazakontë në historinë e Islamit. Në Kuran, Allahu informon se njerëz të tillë kanë ekzistuar gjatë tërë historisë, duke përfshirë edhe periudhën kur ka jetuar i dërguari Muhammed (saas). Kurani jep përshkrim të hollësishëm të tipareve kryesore të karakterit të hipokritëve, duke bërë të njohur fytyrën e vërtetë të këtyre njerëzve, dhe në këtë mënyrë, mbron besimtarët nga dredhitë e tyre. Në Kuran, Allahu tregon për një grup njerëzish në mesin e besimtarëve të cilët pohuan se besonin, edhe pse, në fakt, nuk besonin. Ata kishin të gjitha të gjitha tiparet karakteristike të arrogantit, si mosnënshtrimi dhe jobesnikëria. Këta njerëz ishin hipokritë. Për arsye të tyre personale, hipokritët mbeten në mesin e besimtarëve, por fshehnin mosbesimin e tyre. Megjithatë, mund lehtë të dallohen nga qëndrimi dhe sjelljet

e tyre që në masë të madhe ndryshon nga ato të besimtarëve. Kurani përshkruan qëndrimin, sjelljen, dhe gjuhën tipike të hipokritëve. Në këtë mënyrë, bëhet mjaft lehtë për besimtarët për të dalluar se kush janë hipokritët.

Arsyeja kryesore pse duhet të i kemi hipokritët në konsideratë është se ky grup, dallohen nga arroganca dhe të mendjemadhësia e tyre, japin shembull se arrogantët nuk janë në gjendje as shtiren se janë duke jetuar me parimet fetare. Në të vërtetë, hipokritët nuk mund të i nënshtrohen shumë urdhrave të shpallur në Kuran, ku urdhrat kryesorë janë dëgjueshmëria dhe respekti i të dërguarit. Nga jashtë, kryejnë shumë akte të adhurimit, por, i kryejnë pa vullnet, duke zbuluar qëllimet e tyre të brendshme.

Në faqet në vijim, në dritën e vargjeve të Kuranit, do të shqyrtojmë arsyet pse arrogantët nuk mund të jetojnë me parimet fetare, dhe çfarë mospërputhjesh ndoshin shfaqet kur ata edhe përpiqen për këtë gjë.

### **Arrogantët nuk mund ta vlerësojnë madhësinë që Allahu e ka**

Në kapitujt e mëparshëm, kemi theksuar se arroganca është tipar i veçantë i karakterit të shejtanit. Satani, që në fakt, është qenie mjaft i aftë për të kuptuar fuqinë e pafund të Allahut, ka braktisur plotësisht veprimin e arsyeshëm, dhe në këtë mënyrë, ka përvetësuar një linjë arsyetimi plotësisht të pabazë. Për këtë arsye, mori guximin të ngre krye kundër Allahut. Në të njëjtën mënyrë, arrogantit i mungon të kuptuarit e arsyeshëm. Profeti Muhammed (saas) e përshkruan këtë gjendje të pavëmendshme të njeriut arrogant kështu:

*Ai është një njeri i keq, që bëhet ballëllartë dhe e harron më të Madhin dhe më Madhështorin. (Tirmidhiu)*

Ky gabim është më i qartë tek hipokritët, sepse, edhe janë të njohur veçanërisht për arrogancën e tyre. Ky tipar manifestohet për shkak të dështimit të tyre për të vlerësuar Allahun ashtu siç duhet. Allahu e tregon këtë në ajetin si vijon:

**E kur zbret ndonjë kaptinë (që turpësinë e tyre) ata shikojnë njëri-tjetrin (e thonë mes vete): a ju pa ndokush ju e pastaj largohen. Allahu prapësoi zemrat e tyre ngase ishin popull që nuk kuptonte. (Teube, 9: 127)**

Ashtu siç e bën të qartë ajeti, hipokritët, të njohur për arrogancën e tyre, nuk arrijnë të kuptojnë se Allahu i sheh, i dëgjon dhe është dëshmitar për çdo gjë. Në të vërtetë, ata mundohen dhe të mendojnë se mund ta mashtrojnë Allahun (natyrisht se Allahu është larg kësaj) tregon madhësinë e marrëzisë së tyre. Ajeti në vazhdim thekson këtë gjë:

**Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. (Bekare, 2: 8-9)**

## **Hipokritët nuk mund të jetë të nënshtruar e as respektues**

Modestia kërkon respekt, ndërsa arroganca kërkon përqeshje. Arrogantët nuk mund që të tregojnë respekt për të tjerët. Kjo bëhet edhe më e vështirë për ta në rast se duhet që të iu binden ndonjë të dërguari. Ata ndejnë kënaqësi vetëm

në tallje, në paturpësi dhe arrogancë. Pasi që arrogantët besojnë se mendimet e tyre janë më të mira se sa të tjerëve, nuk mund të gjejnë mirësinë në mësimet e të dërguarve apo për t'iu nënshtruar vullnetarisht. Sido qoftë, Allahu parapëlqen bindjes me gjithë zemër, si një nga kushtet më të domosdoshme në Islam, dhe këtë mungesë të dukshme të nënshtrimit të hipokritëve, e tregon në librin e Tij:

**E kur thirrën që ndërmjet tyre të gjykojë Allahu dhe i dërguari i tij, një grup prej tyre nuk i përgjigjen asaj. Po nëse është që e drejta u takon atyre (në atë gjykim), ata i shkojnë atij të bindur e me respekt. A thua janë të sëmurë në zemrat e tyre apo mos dyshojnë (në të dërguarin) ose mos frikësohen se Allahu dhe i dërguari i Tij do të gjykojë padrejt kundër tyre? Por jo, ata vet janë zullumqarë. (Nur, 24: 48-50)**

## **Hipokritët nuk e përkujtojnë shpesh Allahun**

Një nga tiparet më të dukshme të dikuj që sillet me arrogancë është mos përkujtimi i shpeshtë i Allahut, për shkak se duke madhëruar dhe lavdëruar Allahun, dhe duke njohur fuqinë e Tij, bën njeriu ta ndej veten të dobët dhe sheh pozitën e tij si rob para Allahut. Megjithatë, kjo është ajo që më së shumti lëndon krenarinë e arrogantit. Ata me qëllim mundohen ta shmangun përmendjen e Allahut, që i bën ata të ndieshëm ndaj cytjeve të shejtanit:

**Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka qitur në harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri e djallit, e dinë se ithtarët e djallit janë më të dëshpruarit. (Muxhadele, 58:19)**



## **Hipokritët nuk mund të dëgjojnë Kuranin**

Këta njerëz, të infektuar me arrogancën e faraonit, gjithashtu, nuk ia ka ëndja të dëgjojnë Librin e Allahut. Çdo ajet në Kuran është paralajmërim dhe këshillë i cili përkujton atyre vartësinë dhe dobësinë e tyre. Megjithatë, për shkak të arrogancës, nuk mund të durojnë për të dëgjuar për dobësitë e tyre, e as nuk mund të pranojnë këshillë:

**Atyre që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin (fjallët e Allahut). (Kehf, 18: 101)**

## **Hipokritët nuk mund të jetë besnikë**

Feja kërkon besnikëri dhe devotshmëri. Megjithatë, për shkak hipokritët pasojnë vetëm dëshirat e tyre personale dhe kërkojnë prestigj, ndjekin urdhrat e interesit të tyre. Është e pakuptimtë të presim besnikëri dhe përkushtim nga arroganti, pasi është vetëm besnik i vetvetes:

**... dhe një fjalë e mirë (do të ishte më e mirë për ta). E kur çështja të jetë vendosur, do të ishte mirë për ata të jenë besnik ndaj Allahut. (Muhammed, 47:21)**

## **Ata nuk përmbahen kur gjenden në vështirësi**

Urdhrat e fesë janë shumë të lehta për të përmbushur, madje edhe të këndshme, për ata që i nënshtrohen vetëm Allahut, mbështeten vetëm tek Ai, dhe preferojnë jetën e pastajme më shumë se jetën e kësaj bote. Megjithatë, disa detyra që kërkohen nga feja nuk janë në përputhje me

interesat e hipokritëve, të cilët kërkojnë vetëm përfitime të kësaj bote prej tyre. Prandaj, duke përdorur forma të ndryshme të mashtrimit, tentojnë të shmangen në përmbyshjen e urdhërave të Kuranit që kërkojnë përmbyajtje, flijim dhe vendosmëri:

**Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata (hipokritët) do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen në Allahun: “Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju”. E shkatërrojnë veten e tyre; Allahu e di se ata janë rrenacakë. (Teube, 9:42)**

### **Hipokritët nuk shpenzojnë vullnetarisht në rrugën e Allahut**

Shpenzimi i pasurisë në rrugën e Allahut, duke mos pritur shpagim në këtë botë, është edhe një gjë nuk mund ta duroj arroganti. Megjithatë, ashtu që mos ta tërheqin vëmendjen e besimtarëve, e bëjnë këtë vetëm me gjysmë zemre:

Mospranimin e dhënieve të tyre nuk e pengoi tjetër gjë vetëm pse ata mohuan Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe namazin e falin vetëm me përtaci, e lëmshën nuk e japin ndryshe pos duke urrejtur. (Teube, 9:54)

Ajeti i njëjtë e bën të qartë se ata gjithashtu edhe falen me përtaci.

Në këtë kapitull, kemi shpjeguar se është e vështirë, madje edhe e pamundur, për arrogantët që të jetojnë me parimet e fesë. Thamë se arrogantët dhe ata që të ndjehen krenarë nuk mund të imitojnë personin e devotshëm. Madje edhe ata që janë të talentuar mund të jenë në gjendje të

imitojnë tipare të një besimtari për një kohë të caktuar kohe, por karakterin e tyre të vërtetë do të tregojnë atëherë, kur shohin se interesat e tyre janë në rrezik.

Modestia dhe përulja e sinqertë e një personi është shenjë e devotshmërisë së tij. Ngjashëm është edhe me arrogancën e një personi që pretendon se është besimtar tregon hipokrizinë e tij, ose të paktën prirjen për hipokrizi.

Në fund, arroganti kurrë nuk mund të jetojnë sipas parimeve të fesë në kuptimin e plotë të saj. Edhe nëse mëson përmendësh tërë librin e Allahut, nuk do t'i merret parasysh. Bile, do të ketë edhe më shumë përgjegjësi pasi nuk i kishte praktikuar urdhrat për të cilat kishte njohuri. Përfundimisht, nënçmohet duke jetuar si hipokrit në fe. Për të qenë musliman i sinqertë, duhet së pari ta lë adhurimin e epshit të vet, dhe të braktis krenarinë dhe arrogancën. Pra, duhet të bëhet i vetëdijshtë për dobësitë dhe statusin e tij si shërbëtor i Allahut. Pikëpamja e pastër fetare mund të ndërtohet vetëm mbi kësi lloj themeli.

# VENDI I ARROGANTËVE NË BOTËN E PËRTEJME



**P**ërveç definimit të arrogantëve, Allahu gjithashtu na informon për përfundimin e atyre që posedojnë arrogancë si të faraonit, që do ta kenë në botën e pastajme. Kjo tregohet në këtë ajet:

**Dhe kur i thuet atij: “Kij frikë Allahun!”, atë e kap eufori për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (Xhehennemi). (Bekare, 2: 206)**

Siç kuptojmë nga Kurani, shpërblimi i atyre që bëheshin krenarë aq të mëdhenj sa nuk adhuronin Allahun, të Plotfuqishmin, është Xhehennemi. Ajetet që tregojnë këtë janë:

**... e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem”. (Gafir, 40:60)**

**Këtë (dënim) e keni për shkak se gëzoheshit padrejtë në dynja (duke bërë mëkate etj.) dhe për shkak krenoheshi (me mendjemadhësi). Hyni në dyert e Xhehennemit**

**(nëpër shtatë dyer); aty do të jeni përgjithmonë. E, sa vend i shëmtuar është ai i kryeneçëve!(Gafir, 40: 75-76)**

Se zjarri i Xhehenemit është është vendbanimi i arrogantëve është përmendur edhe tek një hadith i Profetit Muhammed (savs):

*... Zjarri i Xhehennemit tha: Në mua gjenden njerëzit e pamëshirshëm dhe arrogantët ... (Muslimi)*

Njerëzit bëhen arrogantë për shkak të asaj që posedojnë në këtë botë, dhe bëhen padrejtësisht arrogantë, duke bërë gabim të rëndë. Kurrë nuk ua merr mendja se çfarë do të jetë përfundimi i tyre në botën tjetër. Për këtë arsye, as për një moment nuk mund ta parashikojnë, se do të gjenden të rrethuar nga vuajtjet e Xhehennemit. Si kundërshtpërblim për dështimin e tyre për të kuptuar se ata do të thirren për të dhënë llogari për veprat e tyre në Ditën e Gjykimit, dhe se do të dërgohen në Xhehennem. Ky është vendbanimi i fundit ku do të kalojnë pjesën tjetër të ekzistencës së tyre. Fati i këtyre njerëzve, të cilët harrojnë Allahun dhe në Ditën e Gjykimit, është tregohen në ajetin e mëposhtëm:

**E u thuhet: “Sot po u lëmë të harruar, ashtu sikurse ju e harruat takimin e kësaj dite, vendi juaj është zjarri, për ju nuk ka ndihmëtarë”. Këtë (dënim) për shkak se ju u tallët me ajetet e Allahut, juve u mashtroi jeta e dynjasë. Sot, pra, nuk do të nxirreni prej tij (zjarrit), e as nuk kërkohet që ata t’i kthehen pendimit të Allahut. (Xhathije, 45:34-35)**

Arsyeja kryesore për poshtërimin e këtyre njerëzve, të cilët do të hedhen në Xhehennem, sepse talleshin me ajetet e Allahut, dhe ishin habitur pas jetës së kësaj bote dhe duke

harruar botën e pastajme, ishte arroganca. Arroganca është ajo që solli ata në këtë gjendje të vështirë. Në të vërtetë, nuk janë njerëz të cilët kurrë nuk kanë për jetën e botës tjetër, gjatë jetës së tyre në këtë botë, bile Allahu i ka njoftuar paraprakisht sa e sa herë me të dërguarit dhe librat e Tij. Megjithatë, duke u bërë arrogantë, injoronin çdo njoftim duke mos ia varur veshin. Do të ndëshkohen sepse do ta meritojnë:

**Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, e ti i përgënjeshtrove ato, u bërë kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besuan. (Zumer, 39:59)**

Kurani jep përshtkrim të hollësishëm të situatës së arrogantëve në Ditën e Gjykimit, banimit të përhershëm në Xhehennem, dhe dënimin që do ta vuajnë. Në këtë seksion, do të shqyrtojmë fatin e tyre në botën e pastajme, ashtu që mund të shërbejë si këshillë për ata që bëhen arrogantë ndaj Allahut, ose për ata që kanë prirje për të pasur ndjenja të tilla mosbindjeje.

### **Ata do të degradohen në Xhehennem**

Ata që bëhen arrogantë në këtë botë do të ndëshkohen në Xhehennem me një dënim nënçmues. Atje, përveç dhimbjes së mundimshme fizike, do të kenë edhe një përfundim që do t'i përul shpirtërisht. Si shpëtim për atë që kanë qenë me padrejtësi mendjemëdhenj në tokë, do të degradohen përjetësisht në Xhehennem:

**E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): Ju i shfryëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe i përjetuat ato, e sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se**

**nuk respektoat urdhërat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënçmues. (Ahkaf, 46:20)**

Në Xhehennem, Allahu do t'i nënshtroj në shume gjendje që do shkaktojnë vuajtje të thellë emocionale. Hedhja në zjarr është me torturë e vërtetë, por për arrogantët, më e keqe është se do të tubohen në kope si kafshët, dhe do të hedhen aty:

**Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, Për shkak se e ndien veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zoti yt. A më tregon atë që pengon, një rob kur ai falet? (Alek, 96:6-10)**

**Jo, Jo! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për flokësh mbi ballin. Floku rrenacak, mëkatar. (Alek, 96: 15-16)**

Në ajetet e mësipërme, njeriu ku ndihet i vetëkënaqur, arroganca, është cilësuar si arsyeja kryesore që ai të ngazëlleshet. Përveç kësaj, ashtu siç ajeti thotë, faktor i rëndësishëm i këtij ngazëllimi është edhe përpjekja për të penguar besimtarët. Në një ajet tjetër, kuptojmë se arrogantët në këtë botë do të kenë një gjendje krejtësisht tjetër:

**Ashtu si vlon uji i valë. (U thuhet engjëjve për mëkatarin) Rrëmbene e grahne në mes të Xhehennemit. Dhe hudhni mbi kokën e tij ujin e valë e shtonja mundimin. (I thuhet): Shijoje! se ti je ai i forti, i autoritetshmi. (Duhan, 44:46-49)**

Ky është përfundimi i arrogantit i cili padrejtësisht ngazëlleshet me vetveten. Qëllimet e kësaj bote që ndiqnin ishin të përkohshme. Edhe nëse do të kishin tërë botën, do të zhdukej pas një kohe të caktuar, si dhe çdo gjë tjetër që ka dëshiruar në këtë botë thjesht, do të zhduket. Sido qoftë, jeta e botës tjetër do të zgjasë deri në amshim. Përveç kësaj,

Allahu është pronar i çdo gjëje; Ai iu ka dhënë njerëzve të gjitha në jetën e kësaj bote vetëm për të i sprovuar. Ai i sprovon ata për të parë nëse do të kërkojnë kënaqësinë e Tij dhe të jenë mirënjohës ndaj Tij apo jo. Shpërblimi i atyre që kanë prirje për arrogancë është vuajtja, diçka krejt tjetër me atë që ata presin.

### **Ata do të jenë të shëmtuar**

Bukuria dhe cilësitë tjera fizike janë ndër tiparet kryesore me të cilat mburren arrogantët. Për këtë arsye, ata të cilët krenohem me bukurinë e tyre në këtë botë do të kenë atë që më së shumti frikësohen, do të duken të shëmtuar. Në Xhehennem, fytyrat e tyre do të bëhen të nxira:

**E ata që bënë gënjeshtër ndaj Allahut, do t'i shohësh në ditën e kijametit, fytyrat e tyre të nxira. A nuk është në Xhehennem vendi i kryelartëve? (Zumer, 39: 60)**

**Edhe në këtë botë i kemi përcjellë ata me mallkim, kurse në ditën e kijametit ata janë të përbuzur. (Kasas, 28:42)**

### **Ata do të ngelin përgjithmonë në Xhehennem**

Ajetet e bëjnë të qartë se ata që ngrenë kokë ndaj Allahut do të mbesin në Xhehennem përgjithmonë. Dhe, arsyeja pse dërgohen në Xhehennem është pikërisht arroganca e tyre. Allahu do t'i shpërblejë me zjarrin e përjetshëm të Xhehennemit:

**Nuk ka dyshim se ata që përgënjeshtroan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në**



**Xhennet deri të përbirojë devja nëpër vrimën e gjilpërës.**

**Ja, kështu i shpërblejmë kriminelët. (A'raf, 7:40)**

**Hyni në dyert e Xhehennemit (nëpër shtatë dyer); aty do të jeni përgjithmonë. E, sa vend i shëmtuar është ai i kryeneçëve! (Gafir, 40:76)**

**Andaj, hyni në dyert e Xhehennemit, aty do të jeni përjetë: sa vend i keq është ai i kryelartëve!" (Nahl, 16:29)**

Me të vërtetë e pamundur të përfytyrohet të qenit përgjithmonë në vuajtjet e Xhehennemit -vend të cilin askush nuk do të mund ta duronte vetëm duke e parë -për miliona apo miliarda vjet, e prapëseprapë duke ditur se kurrë nuk do të përfundojë. Nuk ekziston asnjë dënim më i madh se sa dënimi i tillë. Bile, ky është asi dënimi e me aq intensitet sa që i dënuari do ta kishte vetëm një dëshirë të vetme, që ky dënim të mbarojë.

## **Në Ditën e Gjykimit, pasuria dhe fëmijët e tyre nuk do tu sjellin dobi**

Është e qartë se arroganti mburret me pasuritë dhe fëmijët e vet dhe harrojnë se Allahu është Ai i Cili posedon çdo gjë. Çfarëdo që dikush posedon, është vetëm kënaqësi e përkohshme e jetës së kësaj bote. Kriteri i vetëm që është me të vërtetë i qëndrueshëm, dhe ka vlerë para Allahut, është "takvallëku", që do të thotë frikë-respekti ose frika ndaj Allahut, që bën që njeriu të ruhet dhe mos të gabojë dhe të lakmojë në gjëra që e kënaqin Atë. Një ajet kuranor thotë: "... **s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat)..." (Huxhurat, 49:13)** Sidoqoftë, ata që garojnë në kryelartësi ndaj Allahut, e jo në

frikën ndaj Tij, do të kuptojnë se sa kanë dështuar në Ditën e Gjykimit, sepse asnjëra nga vlerat që kanë pasur në këtë botë nuk do të kenë ndonjë dobi në Ditën e Gjykimit:

**Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi)  
Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.E  
Xhenneti u afrohet atyre që ishin të devotshëm. Ndërsa  
Xhehennem u dëftohet atyre që ishin të humbur.  
(Shuara, 26:88-91)**

Një nga gjërat me të cilat arrogantët mburren janë fëmijët dhe familja e tyre. Në Kuran, Allahu na tregon se ata që harrojnë se edhe djemtë edhe familjet e tyre janë krijuar nga Allahu, të cilët do të ikin prej tyre në Ditën e Gjykimit:

**E kur të vijë ushtria (krisma e kijametit); Atë ditë njeriu  
ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet,  
prej gruas dhe prej fëmijëve të vet, atë ditë secilit njeri i  
mjafton çështja e vet. ('Abese, 80:33-37)**

Siç kemi kuptuar nga ajetet kuranore, lidhjet familjare do të zhduken në Ditën e Gjykimit, dhe ata që tani krenohen me familjet e tyre nuk do të kenë asnjë ndihmë prej tyre:

**E kur i fryhet surit (herën e dytë), atëherë, në atë ditë  
nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të  
pyes kush për njëri-tjetrin. (Mu'minun, 23:101)  
Në ditën e kijametit Allahu gjykon mes jush, e nuk do  
t'ju bëjnë dobi as të afërmit tuaj e as fëmijët tuaj.  
Allahu sheh atë që punoni. (Mumtehinet, 60:3)**

Allahu gjithashtu na njofton në ajetin e mëposhtëm se grumbullimi i pasurisë në jetën e kësaj bote nuk do të ketë asnjë dobi në botën e pastajme për arrogantin:

**Ata të Arafit i thërrasin do burra që i njohin me shenjat e tyre dhe u thonë: “Çka ju vlejti ai grumbullimi juaj (në pasuri e numër) dhe ajo që bënit kryelartësi?” (e tash jeni në Xhennenem). (A’raf, 7:48)**

Këta njerëz, edhe pse ata e konsideronin veten e tyre të fuqishëm, sepse nuk arrijnë të kuptojnë se Allahu posedon çdo gjë, do ta shohin të vërtetën në jetën e pastajme. Gjithashtu, do të kuptojnë se as pasuria e as pushteti i tyre nuk do t’iu mjaftojë për të i shpëtuar nga dënimi i frikshëm i Xhehennemit:

**Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm. Jo, të mos medojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame. E çka din ti se ç’është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që depërton deri në loçkë të zemrës. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. (Humeze, 104:2-8)**

# FATI I TË DEVIJUARVE TË UDHËHEQUR NGA ARROGANTËT



**N**jë tipar të veçantë në karakterin e arrogantit është që përveç vetes, të humbasin rrugën edhe tjerëve. Nga një ajet kuranor, njoftohemi se këtë e bëjnë “duke humbur rrugën prej mendjemadhësisë”:

**E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së Allahut, duke mos pasur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm. Ai që shtrëmbron qafën (në shenjë mendjemadhësie), e përpiqet t’i humbë njerëzit nga rruga e Allahut. Atij do t’i takojë poshtrimi në këtë jetë, ndërsa në ditën e kijametit atij do t’ia veshim dënimin e djegies (të zjarrit). (Haxh, 22:8-9)**

Ndërsa arrogantit dërgohet në xhehenem, edhe ata që i lakmonin, duke i pasuar këta të paturpshëm, do të hidhet në zjarr të Xhehennemit. Këta janë ata të cilët i dëgjuan arrogantët, sepse ua kishin lakmi vetitë e tyre të kësaj bote.

Edhe pse jo aq arrogant sa ata të cilët kishin “arrogancë faraoni”, ata që i pasuan u mungonte karakteri dhe vullneti. Tjetër tipar i tyre është mos vënja e besimit të tyre në Allahun, duke qenë të udhëhequr vetëm nga motivet personale. Kurani përmend popullin e faraonit që mbetën fajtorë vetëm për veset e tilla:

**Ndërsa, faraoni thirri popullin e vet e tha: “O popull imi, a nuk është imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?” (Zuhruf, 43:51)**

**Dhe ashtu ai e frikësoi popullin e vet, e ata e respektuan, por ata ishin vërtet popull i shkatërruar. (Zuhruf, 43:54)**

Njerëzit e tillë, që mbyllin sytë para gjitha format e dhunës dhe padrejtësisë, nuk e vrasin mendjen dhe të kërkojnë strehim tek Zoti i tyre dhe të bëhen shërbëtorët e Tij. Në Ditën e Gjykimit, do të kuptojnë për gabimet e tyre, por do të jetë tepër vonë. Kur të dalin para Allahut, së bashku për të dhënë llogari për veprat e tyre, arrogantët dhe ata që i pasuan do të grinden me njëri-tjetrin:

**Dhe ata që nuk besuan thanë: “Ne nuk i besojmë këtij Kurani, e as atij që ishte para tij, (librave të tjerë)?!” E sikur t’i shihje zullumçarët kur të dalin para Zotit të tyre të ndalen, kthejnë fjalën (fyese) njëri-tjerit, atyre që ishin pari, u thonë: “Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë!”**

**E ata që ishin pari, atyre që kishin qenë të dobët u thonë: “A ne ju penguan prej udhëzimit të drejtë pasi që u pat ardhur juve? Jo, por ju vetë ishit kriminelë!”**

E ata që kishin qenë të shtypur, atyre që ishin krerë u thonin: “Jo, por dredhia juaj natë e ditë (na largoi prej besimit), kur ju na thërrisnit të mos e besojmë Allahun dhe t’i bëjmë Atij shokë. E kur e shohim dënimin, e fshehin dëshpërimin e vet dhe Ne u vëmë prangat në qafat e atyre që nuk besuan. Ata nuk dënohen për tjetër pos për atë që punuan. (Sebe’, 34:31-33)

Siç tregojnë këto ajet, arrogantët dhe ata që tregohen “të dobët”, do të akuzojnë njëri-tjetrin, por nuk do të ketë dobi. Në një ajet tjetër, gjendja e tyre tregohet si vijon:

**Ata i nënshtroi zjarrit mëngjes e mbrëmje, ditën e kijametit (u thuhet engjëjve): “Ithtarët e faraonit futni në dënimin më të rëndë!” Dhe (përkujto) kur duke qenë në zjarr, ata grinden në mes vete, e të dobëtit u thonë atyre të mëdhenjve: “Ne kemi qenë ithtarë tuaj (në dynja), a mund të na largoni ndonjë pjesë të dënimit me zjarr?” (Gafir, 40:46-47)**

# PËRFUNDIM



**S** iç theksuam gjatë librit, vetia themelore në karakterin e arrogantit është mos aftësia për të kuptuar se ai është vetëm një qenie e dobët dhe e vdekshme para Allahut. Çfarëdo që të jenë kushtet dhe rrethanat, ai gjen prapë arsyezim për t'u bërë kryelartë me mburrje. Ky arsyezim mund të jetë ndonjë shtëpi e bukur, mobilje të shtrenjta, makinë sportive, veshje, stil flokësh, ngjyra e syve të tij, bukuria fizike, statusi, fama, emër prestigjioz i familjes ...

Sido që të jetë, ai kurrë nuk e vran mendjen se sa i rëndësishëm është ajeti, **“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen” (Ali Imran, 3:185)** dhe se do të vdes dhe të shndërrohet në pluhur. Çdo gjë që ai e ka dashur një herë do të ketë përfundim të njëjtë; si trupi i tij, për të cilin i ishte dhënë me aq dashuri, në fillim do të kalbet e pastaj të mbesin vetëm eshtrat. Makina e tij e re do të bëhet një grumbull metali vetëm pas disa dekada. Sipas të gjitha gjasave, pas vetëm disa vitesh, askujt nuk do t'i bie ndër mend fama apo statusi i tij e për t'i pasur zili. Madje, pas më së njëqind vjetësh e më shumë, asnjë njeri nuk do të mbetet në tokë që e ka njohur.

Mos mundësia e tij të paramendoj këto fakte, madje edhe refuzimi i tij për të vrarë mendjen për këto gjëra, është në fakt shenjë e qartë se i takon atyre njerëzve që nuk e përdorin siç duhet mendjen e tij.

Sidoqoftë, dështimi për të përdorur mendjen siç duhet nuk është arsye për shfajësim. Kjo është për shkak se Allahu krijoi çdo njeriu dhe i është sqaruar se ka dy rrugë, dy qëllime; ose njeriu të i dorëzohet plotësisht Zotit të tij dhe të kalojnë tërë jetën e tij për të fituar Xhennetin, apo të i pasoj tekat dhe dëshirat e tij dhe të bëhet arrogant ndaj Tij. Allahu i jep dituri dikujt nëse ai pason rrugën e parë, ndërsa rruga tjetër, e privon nga urtësia. Siç ndodhi me Iblisin, ashtu edhe ata që bëhen arrogantë zgjedhin çdoherë rrugën e dytë. Bile, çdo vërejtje që marrin, thjesht dëshmohet të jetë një arsye më shumë për këmbënguljen në mohimin e tyre. Në ajetin e mëposhtëm thuhet:

**E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka shurdhim të rëndë, pra, ti përgëzoje atë më një dënim të dhëmbshëm. (Lukman, 31:7)**

Këta njerëz, të cilët bëhen arrogantë ndaj Allahut, dhe nuk i kthehen Atij për shkak të arrogancës, do të dënohen si në këtë botë ashtu edhe në atë të përtejmen. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga ky qëndrim i qortuar. Bile, ajo do të jetë shkak që do të hedhen në Xhehennem:

**Thuaju atyre që nuk besuan: “Do të jeni të mposhtur (në këtë jetë) dhe do të hidheni në Xhehennem. Sa i shëmtuar është ai djep (shtrat). (Ali Imran, 3:12)**

**Ata do të tubohen, do të jenë të përmbysur me fytyrat e tyre në Xhehennem, të tillëve u përket vendi më i keq,**



**ndaj ata janë më të humburit në rrugën e tyre. (Furkan, 25:34)**

Besimtarët, në anën tjetër, i përmbahen rrugës së parë. Ata janë falenderues dhe të nënshtruar ndaj Zotit të tyre. Ata sillen me modesti ndaj besimtarëve tjerë, pasiqë e dijnë se sa të dobët dhe të vegjël janë para fuqisë së pafundme të Allahut, si dhe e dijnë se *“Modestia është pjesë e besimit dhe besimi është në xhennet”* (Ahmedi, Tirmidhiu), ashtu siç ka thënë edhe vetë i Dërguari (saas). Gjithashtu, të vetëdijsëm se pasuria dhe veçanëritë e tyre u janë dhënë vetëm si sprovë në këtë botë, dhe asesi nuk është dashur të guxojnë që këtë ta shohin si bazë për të supozuar superioritetin ndaj të tjerëve. Njerëzit modestë janë të vetëdijsëm për të metat, dobësitë dhe ndjeshmërinë e tyre edhe ndaj një mikrobi i cili është i padukshëm për syrin e njeriut, si dhe e dinë se do të vdesin. Ata gjithashtu e dijnë faktin se, sikurse ata, edhe të tjerët janë gjithashtu të varur nga Allahu. E dinë se para Allahut, vetëm frika ndaj Allahut është kriter për epërsi, dhe nuk pranojnë asnjë kriter tjetër.

Ata janë *“njerëz të mendjes,”* ashtu siç referohen në Kuran. Allahu i ka udhëzuar, dhe kjo tregohet në këtë ajet: **“O ju që besuat, nëse keni frikë Allahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju”** (Enfal, 8:29) dhe në këtë mënyrë, ata kanë kuptuar se kjo botë është e përkohshme, dhe se duhet të përgatiten për mundësi për të fituar xhennetin. Për këtë qëllim, ata e pastrojnë egon e vet nga të gjitha format e arrogancës.

Kjo, në të vërtetë, është rruga e vetme për shpëtim.

# MASHTRIMI I EVOLUCIONIT



**D**arvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

## **Dështimi shkencor i Darwinizmit**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj kryesorë:

1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.

2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

### **Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyreshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie,

materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### **“Jeta rrjedh nga jeta”**

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besojnë në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin *Origjina e Llojeve*, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

*Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gurtëmelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr*

*veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”<sup>1</sup>*

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

## **Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet**

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

*Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>2</sup>*

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërмор në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm

në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>3</sup>

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>4</sup>

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?<sup>5</sup>*

## **Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në  $10^{950}$  (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet

më të vogla se 10<sup>50</sup> konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

*Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.<sup>6</sup>*

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u "krijua" në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.



## Mekanizmat imagjinare të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.<sup>7</sup>*

## Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>8</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

## Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si

rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.<sup>9</sup>*

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në

të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

### **Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk-gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë

kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojlojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”<sup>10</sup>*

## Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.<sup>11</sup>*

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

*Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.<sup>12</sup>*

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

## **Përralla e evolucionit të njeriut**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë

jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.<sup>13</sup>

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”<sup>14</sup>

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>15</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.<sup>16</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.<sup>17</sup>*

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse



evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkencat e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkencat biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.<sup>18</sup>*

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

## **Formula e Darvinit!**

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

*Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehetësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop*

*elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.*

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshe nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijsëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

## **Teknologjia e syrit dhe veshit**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet

“qendra e shikimit”. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s’ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon

këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme

për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

### **Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka

përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

### **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.<sup>19</sup>*

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshe krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”



Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

### **Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e

pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

**Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)**

**... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të

pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, “magjia” është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

**“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)**

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion,

magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.<sup>20</sup>*

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

.....

***Ata thanë: “I pa të meta je Ti!***

***Ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na e mësove Ti.***

***Vërtetë Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!”***

***(Sure el-Bekare: 32)***

## SHĒNIME

1. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, Ę.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
2. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, NeĕYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
3. "Neĕ Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
4. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
5. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
6. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
7. Charles Darĕin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, Neĕ York, p. 127.
8. Charles Darĕin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
9. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
10. Charles Darĕin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
11. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
12. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, Neĕ York, 1983. p. 197.
13. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toĕer*, Toplinger Publications, Neĕ York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
14. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansĕers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
15. Alan Ęalker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Antropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neĕ York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
16. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ęith Modern Humans", *Time*, 23 December 1996.
17. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
18. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Toĕer*, p. 19.
19. Richard Leĕontin, "The Demon-Haunted Ęorld," *The Neĕ York Revieĕ of Books*, January 9, 1997, p. 28.
20. Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.